

Instrument për sigurimin e cilësisë së
edukimit për qytetari demokratike në
shkollë

Instrument për sigurimin e cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkollë

Autorë:

Cezar BIRZEA
Mikela ÇEKINI
Kamerun HARRISON
Janez KREK
Vedrana SPAJIÇ-VERKASH

2005
Viti Europian
i Qytetarisë përmes
Edukimit

Idetë dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e UNESCO dhe të Këshillit të Europës.

Materialet dhe skicat e përdorura në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e UNESCO dhe e Këshillit të Europës, lidhur me statusin ligjor të çdo vendi, territory, qyteti ose zone dhe të autoriteteve të tij ose lidhur me shtrirjen e kufijve ose hapësirave të tyre.

Botuar në vitin 2005

Nga Organizatat Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve

Përmbledhje

Kreu I

Përse shërben ky instrument dhe si mund të përdoret?

1. Si lindi ky instrument?
2. Cila është struktura e tij dhe përse shërben
3. Si duhet të përdoret ky instrument?

Kreu II

Edukimi për qytetari demokratike dhe shkolla

1. Hyrje
2. Ç'është edukimi për qytetari demokratike
3. Ku dhe si realizohet edukimi për qytetari demokratike në shkollë?
4. Proceset e krijimit të kapaciteteve për edukimin për qytetari demokratike në shkollë

Kreu III

Çfarë është sigurimi i cilësisë dhe cila është rëndësia e tij?

1. Përmirësimi i edukimit
2. Kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë
3. Karakteristikat e sistemit të sigurimit të cilësisë në shkollë
4. Proceset e sigurimit të cilësisë
5. Përgjegjshmëria
6. Sigurimi i cilësisë si një system forcash dinamike

Kreu IV

Çfarë do të thotë planifikim i zhvillimit të shkollës dhe si mund të realizohet ai?

1. Çfarë është Planifikimi i zhvillimit të shkollës
2. Vlerësimi si themeli i Planifikimit të zhvillimit të shkollës
3. Cila është pamja e planifikimit të zhvillimit të shkollës

4. Çështje dhe sfida

Kreu V

Kuadri i vlerësimit të edukimit për qytetari demokratike

1. Hyrje
2. Treguesit e cilësisë për edukimin për qytetari demokratike

Kreu VI

Planifikimi i zhvillimit të shkollës për edukimin për qytetari demokratike

1. Hyrje
2. Udhëzime të përgjithshme për vetvlerësimin e shkollës
3. Përdorimi i treguesve të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike
4. Analiza, përfundimet dhe raportimi
5. Planifikimi i zhvillimit të edukimit për qytetari demokratike

Kreu VII

Drejt një sistemi të sigurimit të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike

1. Hyrje
2. Elementët e sigurimit të cilësisë nën këndvështrimin e edukimit për qytetari demokratike
3. Sigurimi i cilësisë së edukimit për qytetari demokratike
4. Marrja e masave për sigurimin e cilësisë së edukimit për qytetari demokratike

Shtojca 1: Lista e autorëve dhe kontributorëve

Shtojca 2: Metoda e mbledhjes së të dhënave

Shtojca 3: Zhvillimi hap pas hapi

Shtojca 4: Udhëzime për planifikimin e veprimeve

Shtojca 5: Instrumentet e kërkimit për rishikimin e Sigurimit të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike

Përmbledhje

Ky instrument për Sigurimin e Cilësisë së Edukimit për Qytetari Demokratike (EQD) në shkollë është rrjedhojë e nevojës për të mbushur hendekun që ekziston ndrmjet politikave dhe praktikave të edukimit për qytetari demokratike në vende të ndryshme. Ndonëse politikat e EQD vlerësohen të zhvilluara në shkallën e duhur, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për zbatimin e tyre në shkollë. Përvbeç qëllimit të sipërpërmedur, ky instrument është edhe rrjedhojë e interesit aktual për sigurimin e cilësisë në shkollë.

Sigurimi i Cilësisë (SC) është një instrument i rëndësishëm për të përmirësuar efektshmërinë e edukimit. Si parim themelor ai ka idenë se aktorët kryesorë që qëndrojnë në ballë të edukimit si mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe aktorë të tjerë në nivel shkolle (nxënësit, prindërit, administrata e shkollës dhe personeli mësues, anëtarët e organizmave të tjerë të shkollë dhe të bashkësisë) janë përgjegjës për përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe të rezultateve të tij. Për këtë arsye, vetvlerësimi i shkollës dhe proceset e planifikimit të zhvillimit të saj qëndrojnë në themel të sigurimit të cilësisë.

Megjithatë, vetëm këto procese nuk janë të mjaftueshme për sigurimin e përmirësimit të kërkuar. Ato duhet të jenë pjesë e një sistemi tërësor të sigurimit të cilësisë që mbështetet në rolin e rëndësishëm të autoriteve arsimore në nivel kombëtar të cilat krijojnë kushtet dhe sigurojnë mbështetjet e duhura për përmirësimet e kërkuara në nivel shkolle.

Ky instrument është hartuar si një pikë referimi. Ai përqendrohet në edukimin për qytetari demokratike dhe zbaton parimet dhe proceset e sigurimit të cilësisë në fushën e EQD.

Kreu I na njeh me këtë instrument. Ai:

- (a) na njeh me kuadrin e përgjithshëm, objektivat dhe grupet të cilave u drejtohet ky instrument;
- (b) na njeh me konceptet dhe parimet themelore të këtij instrumenti, veçanërisht me ato që lidhen me EQD, sigurimin e cilësisë (SC) dhe sigurimin e cilësisë së edukimit për qytetari demokratike (SC-EQD);

(c) shpjegon mënyrën e përdorimit të instrumentit.

Kreu II siguron kuadrin konceptual të edukimit për qytetari demokratike në të cilin do të përdoret ky instrument. Ai:

- (a) ofron një përcaktim të EQD
- (b) ofron ide për mënyrën e realizimit të EQD në shkollë
- (c) diskuton çështjet e ngritjes së kapaciteteve për EQD në shkollë

Në këtë mënyrë parimet e EQD ofrojnë themelet për sigurimin e cilësisë së EQD të cilave do t'u referohemi shpesh herë në krerët në vijim.

Kreu III ofron një pamje të përgjithshme të sigurimit të cilësisë në arsim, fillesat dhe përbërësit e tij kryesorë. Ky kre shpjegon dallimin ndërmjet sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë, cilat janë proceset e sigurimit të cilësisë dhe pse sigurimi i cilësisë është një sistem.

Kreu IV paraqet karakteristikat kryesore të planifikimit të zhvillimit të shkollës, që është një përbërës themelor i sigurimit të cilësisë në fushën e edukimit. Ai përshkruan vetvlerësimin e shkollës si element bazë në kuadrin e planifikimit të zhvillimit të shkollës. Në mënyrë të veçantë, ai shqyrton parimet, fazat dhe sfidat e planifikimit të zhvillimit të shkollës.

Kreu V na njuh me kuadrin në cilin do të zhvillohet vlerëimi i EQD. Së pari ai shpjegon karakteristikat kryesore të treguesve të vlerësimit dhe ofron treguesit e cilësisë së EQD të cilët janë zhvilluar për këtë instrument, duke u mbështetur në parimet e EQD të përshkruara në Kreun e II.

Kreu VI përmban elementet kryesorë të domosdoshëm për përgatitjen dhe realizimin e planifikimit të zhvillimit të EQD. Ai përqendrohet kryesisht në proceset e vetvlerësimit që qendrojnë në themel të planifikimit të EQD të përfshirë në kreun V, për këtë qëllim. Kreu VI ndjek hapat e ndryshëm të vetvlerësimit dhe të planifikimit të zhvillimit; ofron informacion bazë, udhëzime dhe mjete; përmban shembuj nga shkollat dhe modele nga vende të ndryshme.

Kreu VII shqyrton nevojat dhe zbatimet e sigurimit të cilësisë së EQD në nivel sistemi në dy vija paralele:

- (a) ai rishikon sistemi e sigurimit të cilësisë dhe përbërësit e tij kryesorë nën këndvështrimin e EQD
- (b) ai shqyrton kërkesat për një sistem të veçantë të sigurimit të cilësisë për EQD. Në këtë kuadër ai ofron një listë të masave politike që janë të domosdoshme për ngritjen e një sistemi për sigurimin e cilësisë së EQD

EQD dhe sigurimi i cilësisë ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Në varësi të situatës në çdo vend ose të pikënisjes (nëse si pikënisje do të jetë EQD apo sigurimi i cilësisë, apo të dyja), ky instrument mund të përdoret në mënyra të ndryshme:

1. Për rritjen e vetëdijes për EQD dhe për sigurimin e cilësisë
2. Si pikënisje për ngritjen e një sistemi për sigurimin e cilësisë
3. Për integrimin e EQD në sistemet ekzistuese të sigurimit të cilësisë

Në të gjitha rastet dhe qëllimet instrumenti i sigurimit të cilësisë së EQD duhet t'i përshtatet kushteve të çdo vendi.

Përse shërben ky instrument dhe si mund të përdoret ai?

***Kreu I** na njuh me instrumentin e sigurimit të cilësisë në përgjithësi. Ai:*

- *na njuh me kuadrin e përgjithshëm, objektivat dhe grupet të cilave u drejtohet ky instrument;*
- *na njuh me konceptet dh parimet themelore të këtij instrumenti, veçanërisht me ato që lidhen me EQD, sigurimin e cilësisë (SC) dhe sigurimin e cilësisë së edukimit për qytetari demokratike (SC-EQD);*
- *shpjegon mënyrën e përdorimit të instrumentit.*

1. Si lindi ky instrument?

Ky instrument i ka fillesat e tij në kërkimet e kryera në fushën e EQD në Evropën Juglindore. Ai është pjesë e të njëjtit projekt që synon të zhvillojë sigurimin e cilësisë së EQD në të njëjtin rajon dhe është një përgjigje për vëmendjen aktuale ndaj sigurimit të cilësisë në fushën e edukimit në nivel botëror.

Kuadri në të cilin është zhvilluar ky instrument

Në vitin 2001, Këshilli i Evropës bashkërendoi një studim për “Politikat për EQD dhe manaxhimin e diversitetit¹ në Evropën Juglindore

Rezultatet e këtij studimi të ndërmarrë nga një ekip kërkuesish nga vendet e interesuara, në bashkëpunim me një numër ekspertësh të Evropës Perëndimore, janë të shpallura nga raportin rajonal të këtij projekti². Më të rëndësishmet prej tyre janë:

- ◆ Shumica e vendeve të rajonit e kanë shpallur qartë dhe mirë synimet e tyre politike për EQD. Përmbajtja e këtyre deklaratave politike përgjithësisht duket pozitive dhe e arsyeshme;
- ◆ Ajo që vihet re, megjithëse me disa ndryshime nga vendi në vend është mungesa e praktikave të efektshme të EQD në shkolla: mungesa e (a) e planeve të plota për zbatimin e politikave, e përcaktimit të detyrave dhe të përgjegjësive; (b) e politikave tërësore të trajtnimit të mësuesve në fushën e EQD; (c) e mbikqyrjes së vazhdueshme të progresit ose të sigurimit të cilësisë.

Këto fakte dëshmojnë për hendekun në fushën e EQD, d.m.th. ndërmjet politikave dhe praktikave të efektshme, ndërmjet asaj që deklarohet dhe asaj që ndodh realisht në shkollë.

Kërkimet e para të kryera në Evropën Jug-Lindore u pasua me studimin Mbarë Evropian për Politikat e EQD, të botuar nga KE në vitin 2003, i cili arrin në përfundime të ngjashme në të gjithë Evropën.³

Në këtë mënyrë, ky instrument është një nga përgjigjet ndaj këtij hendeku në fushën e EQD. Në të njëjtën kohë ai është pjesë e vëmendjes që i kushtohet sot nga politikëbërësit në të gjithë otën,

¹ Ky studim u krye në kuadrin e Task Force “Edukimi dhe Rinia (Procesi i Zgjeruar i Gracit) të Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore dhe Grupit të saj të Punës për Edukimin për qytetari demokratike dhe manaxhimin e diversitetit. Shih: eeë.see-educoop.net

² Studimi për Politikat e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe Manaxhimin e Diversitetit: Analiza rajonale nga Kamerun Harrison dhe Bernd Baumgart, 2001. Shih faqen e internetit të Këshillit të Evropës: www.coe.int/EDC >publication > policies.

³ Studimi Mbarë-Evroian për Politikat e Edukimit për Qytetari Demokratike. ISBN: 92-871-5608-5, Botim i Këshillit të Evropës, 2004

sigurimit të cilësisë në fushën e arsimit, si një rrugë për të përmirësuar si qeverisjen në arsim ashtu edhe praktikatat e të nxënies dhe të mësimdhënies.

Në nivel ndërkombëtar, ky instrument ndihmon në zbatimin e Qëllimit Nr. 6 të Kornizës së Dakarit për Arsimit për të Gjithë: duke përmirësuar të gjitha aspektet e cilësisë së arsimit dhe duke siguruar kushtet për arritjen nga të gjithë të objektivave të njohura dhe të matshme të të nxënies, veçanërisht ato që lidhen me leximin, numërimin dhe aftësitë bazë për jetën.

Po kështu, Instrumenti është në përputhje me Programin Botëror për Edukimin e të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleje e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor të vitit 1994, dhe veçanërisht me Planin e Veprimit për fazën e parë të tij (2005-2007), që e vë theksin në sistemin shkollor të arsimit të fillor dhe të mesëm.

Përgatitja e Instrumentit për sigurimin e cilësisë së EQD në shkollë

Instrumenti për Sigurimin e Cilësisë së EQD në Shkollë ishte hapi i parë që vijoi studimin për EDQ për Evropën Jug-Lindore. Ai u hartua nga një grup ekspertësh nga vende të rajonit, të koordinuar nga Qendra për Studime të Politikave Arsimore në Universitetin e Ljubjanës, Sloveni dhe të mbështetur nga ekspertë të Evropës Perëndimore⁴. Hartimi i Instrumentit është pjesë e një projekti të përgjithshëm që synon të përfshijë sigurimin e cilësisë në fushën e EQD në Evropën Jug-Lindore. Ky projekti nisi në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, dhe është mbështetur nga UNESCO dhe KE.⁵

Instrumenti bazohet në praktikatat ekzistuese në Evropë. Zhvillimi i tij përfshin:

- ◆ Kryerjen e studimit dhe diskutimin e ekspertëve për sigurimin e cilësisë në arsim dhe të EQD në Evropën Jug-Lindore;

⁴ Shih Shtojcën 1

⁵ Për t'u njohur më gjërësisht me projektin Edukimi për Qytetari Demokratike: nga Politikatat në praktika të efektshme përmes sigurimit të cilësisë, shih faqen e internetit: www.see-educoop.net/portal/edcqa.htm

- ◆ Rishikimin e modeleve dhe të instrumenteve të sigurimit të cilësisë në fushën e edukimit dhe të EQD, veçanërisht në Suedi, në Belgjikë, Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar (me burime të veçanta nga Anglia, Uells, Skocia dhe Irlanda e Veriut);⁶
- ◆ Përgatitjen e drafteve të Instrumentit dhe diskutimin e tyre në katër takime të grupit të punës;
- ◆ Vlerësimi i draftit të Instrumentit dhe dorëzimi i tij tek ekspertë dhe prakticienë në Evropën Jug-Lindore (Rumani, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi) dhe më gjerë;
- ◆ Diskutimi i Instrumentit në një seminar në të cilin morën pjesë përfaqësues të ministrive të arsimit, drejtues shkollash, mësues, inspektorë, OJQ (veçanërisht nga Evropa Jug-Lindore)

Në këtë mënyrë ky Instrument i Ka rrënjët e tij në përvojën arsimore dhe në sfidat e mprehta të vendeve të Evropës Jug-Lindore. Megjithatë, ai është hartuar në mënyrë të tillë që mund t'u shërbejë të gjitha vendeve të Evropës dhe më gjerë. Në fakt, ky Instrument është i përgjithshëm dhe në themel të strategjisë së përdorimit të tij, qendron idea se një nga fazat e para të përdorimit të tij në kontekste të reja është ajo e përshtatjes së tij në kushtet e veçanta në të cilat ai është planifikuar të përdoret (lokale, kombëtare, Evropiane ose botërore). Në këtë mënyrë, ai vjen si të thuash si pikënisje dhe mbështetje për çdo vend ose grup që dëshiron të fuqizojë politikën dhe praktikën e EQD.

Instrumenti për Sigurimin e Cilësisë së EQD përfshihet në paketën e përgatitur nga KE, në kuadrin e Vitit Evropian të Qytetarisë përmes Edukimit 2005, dhe plotëson instrumentet e tjera të kësaj pakete.⁷ Në të njëjtën kohë ai shërben edhe si mjet burimor për fazën e parë të sipërpërmendur (2005-2007) të Programit Botëror për Edukimin e të Drejtave të Njeriut.

⁶ Lista e plotë e burimeve mund të gjendet në faqen e internetit të projektit Sigurimi i Cilësisë së EQD: ee.see-educoop.net/portal/edcqa.htm

⁷ Instrumenti 1: Çështje themelore për Politikën e EQD, Instrumenti 2: Qeverisja Demokratike në Arsim, Instrumenti 3: Trainimi i mësuesve në fushën e EQD dhe të Drejtave të Njeriut,

2. Cila është struktura e Instrumentit dhe përse shërben ai?

Objektivat

Objektivi i këtij Instrumenti është t'u ofrojë, atyre që janë përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e EQD në arsimin formal, parime, mjete, metodologji dhe variante të vlefshme për të përcaktuar qëllimet, për të vlerësuar arritjet dhe për të përmirësuar praktikatat e EQD në shkollë dhe në kuadrin e sistemeve arsimore.

Struktura

Struktura e Instrumentit është e ndërtuar si më poshtëvijon:

- ◆ Meqë Instrumenti përqendrohet në EQD, në Kreun 2, ai fillon me çështjen “EQD dhe shkolla”- në të cilin paraqiten parimet dhe karakteristikat themelore të EQD.
- ◆ Së dyti, në Kreun 3 dhe 4, ai trajton çështjen e sigurimit të cilësisë në arsim, në përgjithësi:
 - ◆ Kreu 3, i përgjigjet pyetjes “Çështje sigurimi i cilësisë dhe cila është rëndësia e tij?”. Ai ofron përcaktime, përbërësit kryesorë dhe shpjegon proceset e sigurimit të cilësisë;
 - ◆ Kreu 4 i përgjigjet pyetjes “Çështje planifikimi i zhvillimit të shkollës dhe si realizohet ai?” dhe paraqet në hollësi tiparet dhe fazat kryesore të planifikimit të zhvillimit të shkollës si përbërësi kryesor i sigurimit të cilësisë.
- ◆ Së treti, Kreu 5, 6, 7 harmonizojnë metodat e sigurimit të cilësisë dhe të EQD:
 - ◆ Kreu 5, “Kuatriri i vlerësimit të EQD” përban një instrument vlerësimi me treguesit e cilësisë, veçanërisht për EQD;

- ♦ Kreu 6, “Planifikimi i zhvillimit të shkollës për EQD” shpjegon se si mund të zhvillohet një plan vetvlerësimi dhe zhvillimi i EQD në shkolla;
- ♦ Kreu 7, i titulluar “Drejt një Sistemi për Sigurimin e Cilësisë së EQD”, e hedh vështrimin në përbërësit kryesorë të sigurimit të cilësisë së EQD në nivel sistemi.

Struktura e Instrumentit paraqitet grafikisht në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Instrumentit

Kujt i shërben Instrumenti?

Grupet kryesore për të cilët shërben ky instrument janë hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit që janë aktivë në fushën e EQD dhe të sigurimit të cilësisë në nivel sistemi, administratorët e arsimit në nivel ministrie dhe pushteti lokal dhe inspektorët e shkollave. Në nivel shkolle, Instrumenti u shërben drejtuesve të shkollave, mësuesve, nxënësve dhe prindërve.

Ky instrument mund t'u shërbejë të gjithë atyre që janë aktivë ose jë anë të interesuar për EQD, si dhe atyre që mund ta bëjnë atë të efektshëm, përfshirë këtu edhe OJQ.

Idetë themelore të Instrumentit

Metoda

Instrumenti ka karakter tregues dhe ofron praktika të mira, për shembull në fushën e EQD, të sigurimit të cilësisë, të punës në grup, të stilit të udhëheqjes etj. Meqë Instrumenti përfshin vizionin dhe parimet themelore të EQD dhe të sigurimit të cilësisë, ai nuk është i neutral ose i çliruar nga vlerat. Megjithatë, ai nuk pretendon se të gjithë përbërësit e paraqitur ekzistojnë tashmë në sistemet arsimore. Po kështu ai nuk pretendon se ka vetëm një zgjidhje për çështjet e trajtuara. Instrumenti përcakton objektivat e mundshëm për t'u arritur nga proceset e të nxënësve dhe risitë.

Instrumenti ofron përcaktime dhe koncepte themelore të Sigurimit të Cilësisë së EQD. Në të njëjtën kohë ai ofron disa pikënisje për realizimin e Sigurimit të Cilësisë së EQD. Megjithatë, nuk duhet krijuar ideja se ky Instrument është një manual. Ai është vetëm një mjet për të rritur shkallën e vetëdijes, për të nxitur reflektimin dhe veprimet në këtë fushë. Si i tillë ai është dhe një pikë referimi.

Edukimi për Qytetari Demokratike (EQD)

Metoda e EQD e përdorur në këtë Instrument, harmonizon disa elementë që përmenden në Kreun 2. Ajo është në përputhje me konsensusin që ka nisur të shfaqet në Evropë dhe që bazohet

veçanërisht në punën e KE në këtë fushë. Kjo metodë përfshin të gjithë shkollën gjë që nënkupton se:

- ♦ Shkollat kanë politika të qarta për EQD;
- ♦ Shkollat transmetojnë vlera të EQD (roli formues i shkollës), të harmonizuara me njohuritë dhe aftësitë
- ♦ EQD përshkon të gjitha lëndët e kurrikulit shkollor si dhe jetën e shkollës. Me fjalë të tjera, EQD është më tepër se një lëndë e veçantë kurrikulare. Ajo nënkupton shkriren e vlerave të EQD, përfshin të gjithë aktorët e shkollës dhe për këtë arsye kërkon bashkëpunimin e tyre në të gjithë bashkësinë shkollore.

Aktualisht, kjo metodë mund të mos mbështetet hapur dhe mund të mos zbatohet sistematikisht në çdo vend. Megjithatë, ajo ofron udhëzime për praktika të mira të EQD si dhe për përshtatjen e saj në kontekstin kombëtar dhe shkollor. Këto udhëzime marrin më shumë vlerë, në kushtet kur EQD dhe sigurimi i cilësisë po bëhen politika parësore në shumë vende të Evropës dhe më gjerë.

Sigurimi i cilësisë

Në një kohë që po pranohet, gjithnjë e më shumë, si një metodë e fuqishme për të siguruar përmirësimin e arsimit dhe arritjen e objektivave arsimorë me efektivitet, ⁸sigurimi i cilësisë në arsim po zhvillohet në mënyra të ndryshme në Evropë, sipas parimeve dhe përparësive të sistemeve të ndryshme arsimore.

Parimet themelore, metodat dhe përbërësit e sigurimit të cilësisë në arsim, përshkruhen me hollësi në Kreun e tretë. Ky Instrument propozon që një sistem i efektshëm arsimor është ai, në të cilin të gjithë përbërësit janë të lidhur dhe mbështetin njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër, ai vlerëson që sigurimi i cilësisë të vendoset në të dy nivelet, në atë shkollor, përmes vetvlerësimit të shkollës dhe planifikimit të zhvillimit dhe në nivel sistemi, veçanërisht përmes përgjegjshmërisë dhe masave mbështetëse.

⁸ Forumi i Pragws, 2003, "Cilësi në arsim dhe programi demokratik", KE, CD-ED(2003)9. Konferenca e Ministrave të Arsimit të Evropës, Sesioni 21, Athinw (Greqi), Nwntor 2003.

EQD dhe sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë dhe EQD janë të ndërlidhur. Parimet e EQD janë përbërës thelbësorë të cilësisë së arsimit. Në të njëjtën kohë ata janë pjesë e brendshme e proceseve të Sigurimit të cilësisë, pasi këto nënkuptojnë ndarjen e përgjegjësisë, transparencën dhe përgjegjshmërinë, fuqizimin për ndryshim, decentralizimin dhe vendimmarrjen. Qartësimi i parimeve të EQD në kuadrin e përbërësve të sigurimit të cilësisë do të rrisë demokracinë e qeverisjes së arsimit. Kapitulli 7 trajton me hollësi lidhjet ndërmjet përbërësve kryesorë të një sistemi të sigurimit të cilësisë dhe të EQD.

Objektiv kryesor i këtij Instrumenti është përdorimi i metodës së sigurimit të cilësisë, për rritjen e efektshmërisë së praktikave të EQD. Për këtë arsye, ai përqendrohet në sigurimin e cilësisë së EQD në shkolla dhe në atë që nevojitet në nivel sistemi për të zbatuar dhe për të mbështetur Sigurimin e Cilësisë së EQD.

Megjithatë një proces i veçantë i sigurimit të cilësisë së EQD, nuk mund të ekzistojë më vetë, si i tillë. Ai duhet të mishërohet në sistemin e përgjithshëm kombëtar të sigurimit të cilësisë në arsim. Vendosija e sigurimit të cilësisë së EQD, kërkon edhe ekzistencën e një sistemi të efektshëm të sigurimit të cilësisë brenda sistemit arsimor.

3. Si duhet të përdoret ky Instrument?

Sistemet arsimore, EQD dhe sigurimi i cilësisë ndryshojnë nga njëri vend Evropian në tjetrin. Ky Instrument mund të përdoret në mënyra të ndryshme, në varësi të situatës kombëtare ose të faktit që si pikënisje është EQD, sigurimi i cilësisë, apo të dyja së bashku. Ai mund të përdoret për rritjen e vetëdijes për EQD dhe sigurimin e cilësisë, si pikënisje për ngritjen e një sistemi për sigurimin e cilësisë, për integrimin e EQD në sistemet ekzisduese të sigurimit të cilësisë.

Në këndvështrimin e EQD, Instrumenti shërben për të trajtuar problemin e vështirë, që ndeshet në të gjithë Evropën, atë të mishërimit të EQD në praktikën e shkollës dhe të zbatimit me efektivitet të EQD në sistemin shkollor:

- ◆ Ky Instrument, në mënyrë të veçantë Kreu 2 dhe 5, mund të përdoren si materiale shtesë në drejtim të nxitjes së shkallës së të kuptuarit dhe të rritjes së vetëdijes për konceptet dhe praktikrat e EQ;
- ◆ Realizimi i Sigurimit të cilësisë së EQD, përmes përdorimit të Kreut 5, 6 dhe 7, do të ndihmojë në identifikimin e situatës së EQD në nivel shkolle dhe vendi, për shembull, cilët elementë të EQD ekzistojnë në praktikën shkollore dhe cilët prej tyre mungojnë. Kjo do të ndihmonte në përcaktimin e një strategjie për përmirësimin e situatës;
- ◆ Për vendet në të cilët sistemi i sigurimit të cilësisë funksionon mirë, vlera e shtuar e këtij Instrumenti, qëndron në sigurimin prej këtij të fundit të mjeteve dhe udhëzimeve të veçanta që lidhen me EQD, që jepen veçanërisht në Kreun 5, 6 dhe 7 dhe që duhet të përshtaten dhe të integrohen në proceset ekzistuese të sigurimit të cilësisë.

Në këndvështrimin e sigurimit të cilësisë së arsimit në përgjithësi, Sigurimi i cilësisë së EQD shërben si një nxitës, për vendosjen ose përmirësimin e përbërësve kryesorë të një sistemi të sigurimit të cilësisë, të shpallur veçanërisht në Kreun 3 dhe 4:

- ◆ EQD mund të shndërrohet në një fushë të rëndësishme pilotimi për zhvillimin e sigurimit të cilësisë. Reflektimi dhe mbajtja e një debati të hapur publik për cilësinë e EQD dhe të mekanizmave të sigurimit të cilësisë që lidhen me të, do të çonte në shqyrtimin dhe diskutimin e sistemit arsimor në përgjithësi;
- ◆ Nisja e proceseve për përmirësimin e arsimit ose për rritjen e efektshmërisë së tij, do të kishte ndikime pozitive në politikrat dhe praktikrat e EQD.

Në të gjitha rastet dhe për çfarëdo lloj qëllimi që të përdoret, Instrumenti për Sigurimin e Cilësisë së EQD duhet të përshtatet në kushtet e veçanta të çdo vendi. Kjo nënkupton:

- ◆ Rishikimin e politikave dhe të praktikave të EQD dhe të Sigurimit të cilësisë, përmes përdorimit të mjeteve të ndryshme të zhvilluara në nivel kombëtar dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe ato të paketës së EQD të KE;

- ◆ Vlerësimin e arritjeve ekzistuese dhe të hendeqeve ndërmjet udhëzimeve të këtij Instrumenti dhe realitetit të çdo vendi;
- ◆ Identifikimi, si rrjedhojë, i përparësive dhe i nevojave dhe zhvillimi i një strategjid të përgjithshme për Sigurimin e Cilësisë së EQD;
- ◆ Përkthimin e Instrumentit, rimodelimin dhe vendosjen e thekseve në përputhje me përparësitë dhe nevojat e identifikuara;
- ◆ Bashkimin e elementëve ose e nismave të veçuara të EQD dhe të sigurimit të cilësisë;
- ◆ Mishërimin e Instrumentit dhe të përdorimit të tij në politikat dhe praktikat ekzistuese të EQD dhe të sigurimit të cilësisë;
- ◆ Trajnimin për përdorimin e Instrumentit dhe pilotimin e tij në një numër të vogël shkollash;
- ◆ Shqyrtimin e politikave të nevojshme të zhvillimit për sigurimin e efektshmërisë së sigurimit të cilësisë së EQD.

Çka thamë më sipër, kërkon ngritjen e një grupi kombëtar të sigurimit të cilësisë së EQD, që do të kishte si objektiv përfshirjen e të gjithë vendimmarrësve dhe të aktorëve që veprojnë në fushën e arsimit, për të përcaktuar strategjinë më të përshatshme në këtë drejtim

Edukimi për qytetari demokratike dhe shkolla

Ky kre ofron kuadrin konceptual të edukimit për qytetari demokratike për të gjithë Instrumentin. Ai:

- ofron një përcaktim të EQD;
- shqyrton se ku dhe si EQD realizohet në shkollë;
- trajton aspektet kryesore të rritjes së kapaciteteve për EQD në shkolla.

Të përcaktuara në këtë mënyrë, parimet e EQD përbëjnë dhe bazën për sigurimin e cilësisë, dhe për këtë arsye do t'u referohemi vazhdimisht, veçanërisht në kreun 5, 6 dhe 7.

1. Hyrje

Për të dhënë një përkufizim të EQD në Evropë dhe më gjerë janë përdorur dhe përdoren koncepte dhe terma të larmishëm. Ndër to përmendim konceptet, qytetari aktive, edukimi civik, edukim politik, edukim shoqëror, edukim të të drejtave të njeriut etj.

Kjo larmi shprehet edhe në drejtimit e mëposhtme:

- ◆ Cili është vendi i EQD në kuadrin e politikave arsimore, për shembull, ekziston si politikë e veçantë apo si pjesë përbërëse e politikave arsimore në përgjithësi?

-
- ◆ Cili është përcaktimi dhe trajtimi i tij në lidhje me shkollën dhe kurrikulën - cila është koha që i është lënë në shkollë, si lëndë lëndë më vete apo si çështje kroskurrikulare, është pjesë e kurrikulës së detyruar apo asaj me zgjedhje.

Nga njëra anë, EQD ekziston gjithmonë në kuadrin e një konteksti të caktuar, d.m.th. ai zhvillohet dhe zbatohet në kiushte lokale, duke marrë parasysh nevojat dhe përparësitë e veçanta si dhe veçoritë kulturore dhe sociale. Nga ana tjetër, EQD, duke u bazuar në parimet dhe metodat e mëposhtme, po shndërrohet gjithnjë e më shumë, në një pikë të përbashkët referimi në Evropë.

2. Çfarë është EQD?

EQD përbëhet nga një numër praktikash dhe veprimtarish që synojnë të pajisin të rinjtë dhe të rriturit me aftësi për të marrë pjesë aktivisht në jetën demokratike, duke mbajtur parasysh dhe duke ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë në shoqëri. Më fjalë të tjera, EQD nënkupton të nxënit si të bëhesh një qytetar dhe si të jetosh në një shoqëri demokratike.

Ky është një përcaktim pune që sugjeron se EQD përfshin karakteristikat e mëposhtme: (a) ai është një përvojë të të nxënit gjatë gjithë jetës; (b) qëllimi i tij i kryesor është të përgatisë individët dhe bashkësitë për pjesëmarrje qytetare dhe politike; (c) ai nënkupton respektimin e të drejtave dhe pranimin e përgjegjësive; (d) ai vlerëson diversitetin kulturor dhe atë shoqëror. Këto katër karakteristika nënvizojnë faktin që EQD, para së gjithash është një ndër synimet kryesore të politikave arsimore. Në këtë mënyrë ai shkon përtej praktikave arsimore, përmbajtjeve dhe metodave të ndryshme që i kushtohen të nxënit demokratik dhe dallimit të tij prej lëndëve të veçanta kurrikulare (civics ose edukim civic). Si një qëllim edukativ, EQD është i drejtuar nga vlerat, në kuptimin që ai nxit dhe zhvillon parimet dhe vlerat demokratike dhe ato të të drejtave të njeriut (të tilla si dinjiteti njerëzor, barazia, solidariteti, mosdiskriminimi, pluralizmi dhe shteti i së drejtës) në të gjithë sistemin arsimor.

EQD si përparësi e politikave dhe e praktikave arsimore

EQD luan një rol qendror në reformat arsimore që po kryhen në shumë vende të Evropës. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të mbahet mend që EQD:

- ◆ Duhet të jetë në themel të reformave dhe të zbatimit të politikave arsimore;
- ◆ Është një faktor i rëndësishëm për risitë në fushën e organizimit dhe të manazhimit të sistemeve arsimore, si dhe të kurrikulës dhe të metodave të mësimdhënies.

Burimi: Rekomandimi Rec (2002) 12 i komitetit të Ministrave të KE drejtuar shteteve anëtare, për EQD

Parimet e EQD

Edukimi për qytetari demokratike:

- ◆ Bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe të shtetit të së drejtës.
- ◆ Lidhet, veçanërisht me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, dhe respektin për larmishmërinë.
- ◆ Përfshin të gjitha grupet moshore dhe sektorët e shoqërisë.
- ◆ Ka për qëllim përgatitjen e të rinjve dhe të rriturve për të marrë pjesë në shoqërinë demokratike, gjë që do të forcojë edhe kulturën demokratike.
- ◆ Është mjet i rëndësishëm në luftën kundër dhunës, ksenofobisë, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancën.
- ◆ Ndihmon në kohezionin shoqëror, në drejtësinë shoqërore dhe në të mirën e përbashkët.
- ◆ Fuqizon shoqërinë civile përmes punës për t'i bërë qytetarët e saj të mirëinformuar për çështjet e shoqërisë dhe për t'i pajisur ata me shprehitë demokratike.
- ◆ Duhet të jetë i larmishëm, në varësi të konteksteve historike, kombëtare, shoqërore dhe kulturore.

Burimi: Draft i Udhëzime të përgjithshme për EQD, të miratuara në Sesionin e 20th të Konferencës së Ministrave të Arsimit të KE, Krakov, Poloni, Tetor (2000)⁹

⁹ Shtesë e Rezolucionit për rezultatet dhe përfundimet e Projektit të përfunduar në Programin afatmesëm 1997-2000

3. Ku dhe si zhvillohet EQD në shkollë?

EQD do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës, në të gjitha rrethanat dhe në çdo formë të veprimtarisë njerëzore. Ai është të mësuar gjatë gjithë jetës, gjë që do të thotë jo vetëm që ai ndodh gjatë gjithë viteve të jetës, por në të njëjtën kohë përfshin një numër mjedisesh të të nxënimit si në kuadrin e institucioneve shtetërore ashtu edhe jashtë veprimtarisë së tyre (për shembull, në të nxënimit joformal dhe informal, në familje, në bashkësi etj.).

Megjithatë shkolla mbetet vendi kryesor i EQD, sepse ajo: (a) krijon kushtet për fitimin e njohurive që lidhen me qytetarinë në mënyrë vazhdueshme dhe të qendrueshme; (b) lehtëson ushtrimin të hershëm të jetës demokratike (si, pjesëmarrja, dilogimi kolektiv, përfaqësimi etj.); (c) është një institucion që gjithmonë i intereson publikut dhe si i tillë është objekt i përgjegjshmërisë dhe i kontrollit të tij; (d) është vendi ku aktorët kryesorë të fushës së arsimit punojnë dhe jetojnë së bashku; (e) është një organizatë vetqeverisëse dhe vetzhvilluese .

EQD është në përputhje me objektivat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënimit. Ajo është një formë e të nxënimit që përmes zhvillimit të njohurive, të mendimit kritik dhe të gjykimeve të pavarura të kontekstit lokal, kombëtar, Evropian dhe botëro, synon të ndihmojë nxënësin të kuptojë atë që ndodh në jetën publike, të ndriçojë e kthjellojë mendjen e tij. EQD është një proces të nxënimit shoqëror, të nxënimit në shoqëri, rreth shoqërinë dhe për shoqërinë. Aftësitë dhe kompetencat e EQD, i kushtojnë rëndësi të duhur si njohurive ashtu edhe vlerave dhe qendrimeve si dhe aftësisë njerëzore për veprim dhe pjesëmarrje në një shoqëri demokratike dhe shumëkulturëshe. Fitimi i aftësive dhe kompetencave të EQD, kërkon metoda që bazohen si në njohuri ashtu edhe në praktikë; që përqendrohen te nxënësi, te vlerat, kushtet dhe përvojat e tij dhe që edukojnë pavarësinë dhe përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënimit në shkollë dhe në shoqëri. EQD realizohet përmes metodave të shumëfishta dhe ndërlydhura të të nxënimit, të tilla si edukimi qytetar, edukimi për të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi për zhvillim të qendrueshëm, edukimi global, edukimi i medias etj.

Roli kryesor i mësuesit të EQD, ashtu si edhe në fusha të tjera të edukimit është të mundësojë fitimin e njohurive dhe të shërbejë si pikë referimi për të nxënëit rreth përmbajtjes së EQD, si dhe rreth vlerave, qendrimeve dhe ndërveprimeve. Mësuesi mishëron, bart parimet dhe rregullat dhe për këtë arsye shërben si model për hedhjen e bazave të demokracisë. Së fundi, mësuesi, përmes qendrimeve dhe sjelljeve të tij transmeton te nxënësit edhe parimet e EQD.

EQD është një metodë tërësore në të cilën përfshihet e gjithë shkolla. Konteksti shkollor, në vetvete përbën një radhë mjedisesh dhe situatash të nxëni të EQD dhe si i tillë ai nënkupton edhe një larmi situatash të të nxënëit:

- ◆ Udhëheqja dhe manaxhimi: rregullat politike, vendimmarrjet e brendshme, shpërndarja e pushtetit, qeverisja, ndarja e përgjegjësi, përgjegjshmëria dhe transparenca ndaj publikut, skemat e vetzhvillimit, planifikimi, vlerësimi dhe monitorimi institucional, komunikimi, shpërndarja e burimeve, përkatësia dhe fuqizimi.
- ◆ Ethosi i shkollës, ose veprimtaritë e përditshme të bashkësisë shkollore: veprimtari në grup, simbolet sunduese, përfaqësimi i autoritetit, klima e shkollës, udhëheqja informale, marrëdhëniet ndëretnike.
- ◆ Pjesëmarrja e nxënësve në bordet dhe këshillat shkollorë, në parlamentet e nxënësve, në grupet e interesit dhe të presionit, në veprimtaritë vullnetare, në punën e rinisë, në jetën e bashkësisë, në median studentore.
- ◆ Marrëdhëniet: të nxënëit nga njëri-tjetri, mediacioni, kurrikula e fshehtë (të nxënëit informal dhe ndërpersonal), bashkësitë “online”, marrëdhëniet nxënës-nxënës, drejtor-mësues, lidhjet shkollë-bashkësi.
- ◆ Veprimtaritë e klasës: materiale metodike dhe mbështetëse, vlerësimi, dhe vënia e notave, stilet e mësimdhënies, disiplina e klasës, atmosfera, rolet, puna në grup, veprimtaritë joformale dhe ekstrakurrikulare, rezultatet e të nxënëit.

4. Proceset për krijimin e kapaciteteve për EQD në shkollë

Shkolla është institucioni që ofron dhënien sistematike dhe profesionale të njohurive të veçanta dhe fitimin që në moshën e hershme të aftësive shoqërore, kulturore dhe për jetën në kuadrin e një mjedisi kompleks të nxëni. Shkolla, për të qenë e suksesshme, duhet të mishërojë të njëjtat parime kurrikulare si ato të EQD. Mësimdhënia dhe të nxënit, si dhe mjedisi i të nxënit, duhet të jenë në koherencë të plotë. Kjo kërkon sigurimin e një procesi për ngritjen e kapaciteteve që do të përshkojë të tërë jetën e shkollës dhe që synon arritjen e kompetencave qeverisëse dhe manaxhuese, të përbëra nga njohuri, aftësi, vlera dhe prirje. Ky proces i krijimit të kapaciteteve duhet të ketë si qëllim rritjen e pjesëmarrjes, të të drejtave dhe përgjegjësive dhe të larmisë, të cilat janë faktorë themelore për procesin e të nxënit të qytetarisë dhe të demokracisë.

Më poshtë vijojnë disa shembuj që shprehin këndvështrimin e drejtuesve të shkollave, të mësuesve dhe të organizmave qeveritarë për rolin e shkollës sipas fushave kryesore të kompetencave:

Pjesëmarrja

Njohuritë dhe të kuptuarit

- kupton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrjes dhe arritjen e qëllimeve individuale dhe organizative;
- përshkruan rrugët, rregullat dhe ligjet përmes të cilëve vendimarrësit mund të ndikojnë dhe të marrin pjesë proceset vendimmarrëse;
- shpjegon pse njohuritë dhe qeverisjen demokratike dhe vlerat dhe parimet themelore që qëndrojnë në themel të saj, janë të rëndësishme për sigurimin e cilësisë.

Aftësi

-
- zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet mësuesve, ndërmjet mësuesve dhe partnerëve të shkollës, ndërmjet shkollës dhe bashkësisë etj.;
 - rrit ndienjën e përgjegjësisë dhe barazinë e rolit të vendimmarrësve;
 - mbështet manaxhimin dhe qeverisjen e shkollës në qëllime të përbashkëta, në planifikime të kujdesshme, në monitorim të përgjegjshëm, në vetvlerësim dhe transparencë;
 - mbështet dhe bashkëvepron me strukturat pjesëmarrëse në shkollë (këshillat e shkollës, parlamentet e shkollës etj).

Vlerat dhe prirjet

- është i aftë të përballet dhe të shpjegojë dilemat morale që shfaqen në proceset e vendimmarrjes në shkollë;
- zhvillon ndjenjën e besimit të ndërsjellë dhe të jetesës së përbashkët;
- vlerëson shpirtin e iniciativës, krijues dhe vullnetin për t' përfshirë.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Njohuritë dhe të kuptuarit

- ka njohuri për kategoritë kryesore të të drejtave të njeriut, të instrumenteve ndërkombëtarë dhe të mbështetjeve së tyre ligjore;
- ka njohuri për rregullat që qeverisin institucionet publike dhe jetën shoqërore;
- shpjegon faktin që në një organizatë vetqeverisëse, respektimi i të drejtave dhe pranimi i përgjegjësive janë faktorë që plotësojnë njëri-tjetrin.

Aftësi

- pranon të drejtën e trajtimit të barabartë të të gjithë aktoëeve të shkollës dhe i nxit ata të trajtojnë të tjerët në të njëjtën mënyrë;
- nxit respektin për ligjin në të gjitha rrethanat;
- vlerëson mësuesit dhe nxënësit si subjekte të të drejtave;
- zhvillon projekte shkollë në bazë të të drejtave dhe të përgjegjësive të pranuar nga të gjithë;
- është e aftë të shqyrtojë këndvështrimet alternative dhe faktet.

Vlerat dhe prirjet

- vlerëson veten dhe të tjerët-zhvillon vetbesimin, respektin ndaj vetes dhe vetdisiplinën;
- lufton njëanshmëritë, paragjykimet, stereotipat dhe diskriminimin;
- nxit shqetësimin aktiv për të drejtat e njeriut.

Vlerësimi i larmisë

Njohuritë dhe të kuptuarit

- kupton se si kultura dhe etika ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe të veprimtarisë së njerëzve;
- identifikon burimet e larmisë në jetën shkollore (larmia etnike, fetare, gjinore, klasore, gjuhësore);
- kupton vlerat e larmisë për qeverisjen dhe manaxhimin e shkollës (larmia e zjgjedhjeve, larmia e prejardhjeve dhe e ndihmesave, pasurimi i ndrsjellë kulturor).

Aftësi

- siguron shanse të larmishme të nxëni, në përputhje me nevojat, interesat, aftësitë dhe prejardhjet e ndryshme kulturore;
- nxit barazinë e shanseve;
- nxit dhe zhvillon qartësimin e vlerave, empatinë dhe të nxënit ndërkulturor;
- ofron shanse për të trajtuar këndvështrimet e ndryshme (në bordin e shkollës, në këshillin e nxënësve ose në dëgjimin e të rinjve);
- di si të parandalojë dhe të manaxhojë konfliktet që kanë në themel larminë;
- përfshin prindërit që bëjnë pjesë në pakicat, në veprimtaritë shkollore dhe në vendimmarrjet kolektive (për shembull, si anëtarë të barabartë të bordeve të shkollës, si burime vullnetare për veprimtaritë jashtëshkollore, si të ftuar ose si persona burimorë).

Vlera dhe prirje

- nxit parimet e pluralizmit, të mosdiskriminimit dhe të drejtësisë shoqërore;

-
- vlerëson larminë si pasuri;
 - nxit dialogun dhe bashkëpunimin.

Formimi i kapaciteteve për EQD është një proces i gjatë i zhvillimit profesional. Mësuesit dhe drejtuesit e shkollave i fitojnë këto aftësi hap pas hapi gjatë në kuadrin e karrierës së tyre. Dhe në këtë proces ata kanë nevojë për mbështetje dhe trajnim.

Sigurimi i cilësisë së EQD në shkollë është mjet për rritjen e kapaciteteve dhe për zhvillimin profesional në fushën e EQD, sepse ai ndihmon në identifikimin e nevojave dhe në planifikimin e veprimtarive për trajnim¹⁰ dhe mbështetje në këtë fushë.

Përpara se të paraqesin mënyrën e funksionimit të sigurimit të cilësisë së EQD, Kreu 3 dhe 4 shpjegojnë përmbajtjen e sigurimit të cilësisë në shkollë në përgjithësi.

¹⁰ Kompetencat e mësuesve dhe metodat e trajnimit në fushën e EQD dhe të Edukimit për të drejtat e njeriut (EDNJ) për shkruhen, për shembull, në botimin e Kombeve të Bashkuara “Trajnimi i të drejtave të njeriut-Manual për metodologjinë e trajnimit të të DNJ” dhe në boimin me titull “Instrument për trajnimin e mësuesve në fushën e EQD dhe të EDNJ” që është pjesë e paketës për së KE për EQD.

Cila është përmbajtja dhe rëndësia e sigurimit të cilësisë?

Ky kre ofron një pamje të përgjithshme të sigurimit të cilësisë në arsim, të fillesave dhe të përbërësve kryesorë të saj. Ky kre shpjegon:

- Ndryshimin ndërmjet sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë;
- Proceset e sigurimit të cilësisë;
- Sigurimin e cilësisë si një sistem

Këto aspekte të sigurimit të cilësisë në arsimi do të zbatohen fushën e EQD, në kreun 5, 6, dhe 7

1. Përmirësimi i arsimit

Misioni i sistemit arsimi publik është t'u ofrojë të rinjve të cilëve u shërben, arsimin më të mirë të mundshëm. Disa nga vlerat themelore njerëzore qëndrojnë të pandryshuara. Kjo bën që disa aspekte të jetës shkollore dhe të të nxënies ruhen dhe kalojnë nga njëri brez në tjetrin. Nga ana tjetër, bota në të cilën rriten të rinjtë ndryshon në mënyrë të vazhdueshme dhe përpjekjet e brezave të rinj për ta sunduar dhe për ta modeluar atë ndeshen në sfida të mëdha. Kjo bën që aspektet të tilla si

kultura shkollore dhe praktika e në klasë, të jenë gjithnjë objekt i ndryshimit dhe i zhvillimit si rrjedhojë e sfidave në rritje.

Brezave të mësuesve dhe të edukatorëve në përgjithësi u bie barra, që nga njëra anë, të ruajnë vlerat pozitive të së kaluarës dhe nga ana tjetër të zhvillohen për të qenë të aftë të përballojnë sfidat e reja. Kjo është detyrë tepër e vështirë për t'u realizuar nga një mësues i vetëm, madje është një sfidë e vërtetë edhe për një sistem shkollor. Populli paguan për një sistem arsimor të mirë dhe të efektshëm dhe është e drejta e të rinjve të shprehin për një sistem të tillë. Edhe politikanët, përveç të tjerave, zgjidhen për të krijuar dhe për të organizuar një sistem arsimor publik, të mirë dhe të efektshëm.

Në të gjithë botën, përpjekjet për të krijuar dhe për të vënë në jetë politika arsimore të efektshme kanë ndeshur në vështirësi të mëdha. Në këto përpjekje përmendim zhvillimet kurrikulare, zhvillimin e vazhdueshëm të mësuesve, fuqizimin e shkollës si faktor vetzhvillimi. Megjithatë deri kohët e fundit detyra për të arritur përmirësime reale në sistemet arsimore ka qenë e pallogaritshme dhe me kosto të lartë. Që në fillimin e viteve 90', filloi të zhvillohej një metodë më koherente që kishte në themel bashkërendimin e të gjithë elementeve të sipërmendur me forma të reja të fuqizimit dhe të përgjegjëshmërisë. Kjo metodë që ofron më shumë se një metodologji ose përshkrim të praktikave më të mira, është në të njëjtën kohë një proces dimamik, me konceptet dhe teoritë që e bazojnë, me rolet dhe përgjegjësitë, me veprimtaritë dhe ndërveprimet dhe që kohët e fundit njihet me emrin "sigurimi i cilësisë". Ajo i ka shtuar vlerat zbatimit të politikës dhe po e provon veten të efektshme për zhvillimin e praktikës së klasës dhe të shkollës.

Nga pikëpamja e qeverisjes demokratike, ajo është një rrugë e efektshme për të ngushtuar hendekun që ekziston ndërmjet politikës dhe praktikës. Nga pikëpamja e shkollës dhe e mësuesve ajo është një rrugë praktike në drejtim të cilësisë së drejtimit dhe të mbështetjes së nevojshme për arritjen e përmirësive reale në fushën e edukimit të të rinjve. Nga pikëpamja e të rinjve, duket se kjo metodë shfaqet e sukseshme në rrugën e arritjes së një edukimi më të mirë dhe më të përshatshëm dhe përmirësimit të standardeve në fushat parësore.

2. Kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë

Në përgjithësi, shprehjet “kontroll i cilësisë” dhe “sigurimi i cilësisë” shpesh përdoren si sinonime, megjithëse nga përmbajtja e tyre konceptuale ato janë të ndryshme. Kontrolli i cilësisë përfaqëson përpjekjen për të imponuar kontrollin në një sistem. Në thelb, metoda e kontrollit të cilësisë thotë “ Ne që tani kemi përgjegjësinë e dimë më mirë – jo vetëm se çfarë të bëjmë, por edhe si ta bëjmë. Ju – “punëtorët” duhet të bëni vetëm atë që ne ju kërkojmë të bëni. Ju do të ngrini një “forcë policie” – departamentin e kontrollit të cilësisë – që do të kontrollojë dhe të sigurohet që ju po bëni pikërisht atë që pritet nga ju”

Nga ana tjetër, metoda e sigurimit të cilësisë, thotë, “ Le të merremi vesh për atë që duhet të bëjmë. Më pas ne – ata që kanë përgjegjësinë demokratike, ata në pushtet – pranojnë që kjo është një detyrë komplekse dhe e vështirë dhe ju – “punëtorët”- e dini më mirë se ne se ç’duhet bërë që kjo punë të jetë e efektshme. Pra, në këtë mënyrë, ne do të krijojmë kushtet që do t’ju mundësojnë të përdorni gjykimin tuaj për çka duhet bërë. Ne do t’ju sigurojmë mbështetjen për zbatimin e strategjive dhe, në frymën e bashkëpunimit, do të mbikëqyrim ecurinë me qëllimin për të patur më të mirën nga veprimi ynë”.

3. Karakteristikat e sistemeve të sigurimit të cilësisë në edukimin shkollor

Shumë vende, për të rritur efektshmërinë e edukimit shkollor, kanë ngritur sisteme të sigurimit të cilësisë. Përvoja e tyre ofron edhe disa modele të sistemeve të tillë. Sistemet e sigurimit të cilësisë që duket se janë më të efektshmet, përmbajnë elementet në vijim. Kjo do të thotë se kur flasim për sisteme të sigurimit të cilësisë, do të kuptojmë në të njëjtën kohë edhe këtë elemente që jo veëm janë të pranishëm në ta por

edhe funksionojnë në mënyrë të efektshme, janë koherentë dhe të ndërlikur. Një sistem i sigurimit të cilësisë:

- ◆ Bën rregullime që synojnë të bëjnë shkollën një agjent kryesor për sigurimin e cilësisë së rregullave dhe të zhvillimeve progresive drejt realizimit të qëllimeve të saj.
- ◆ Fuqizon shkollën në marrjen e vendimeve që lidhen me planifikimin e zhvillimit të saj dhe i mbështet ato gjatë procesit të vënies në jetë të tij.
- ◆ Zhvillon, në bashkëveprim me shkollat, synimet kombëtare të arsimit dhe të kurrikulës kombëtare, duke u bazuar në trajtimin e çështjes së cilësisë dhe nxit zhvillimin e planifikimit shkollor dhe vlerësimin e atyre strategjive që ndihmojnë në lindjen e ideve të reja.
- ◆ Zhvillon instrumente të thjeshtë dhe të përdorshëm vlerësimi dhe mbështet zbatimin e tyre të efektshëm. Këto instrumente mund të përdoren si pjesë e një procesi vetvlerësimi, që i përgjigjet pyetjes “Në çfarë shkalle ne po e arrijmë cilësinë e kërkuar?”, me qëllim që të ofrojnë përgjigje praktike për pyetjen “Çfarë duhet të bëjmë për të përmirësuar punën tonë?”
- ◆ Rishikon sistemet lokale dhe kombëtare të trajnimit të mësuesve në shërbim, për t’u siguruar që trajnimi i ofruar t’i përgjigjet si duhet nevojave të identifikuara dhe të jetë pjesë përbërëse e planifikimit të vetvlerësimit dhe të zhvillimit të shkollës.
- ◆ Ofron strategji vlerësimi që e ndihmojnë shkollën të arrijë standardet kombëtare dhe të krahasojë veten me standardet ndërkombëtare, duke përdorur agjensi kombëtare testimi, vlerësimi dhe certifikimi që gëzojnë besimin e publikut dhe atë profesional. Këto rregullime, e pajisin shkollën edhe me indikatorë cilësie të besueshëm dhe të vlefshëm.
- ◆ Krijon ose reformon një agjensi kombëtare që ka përgjegjësinë për të zhvilluar dhe zbatuar një sistem kombëtar të sigurimit të cilësisë. Shpesh herë, kjo agjensi merr formën e inspektoratit shkollor kombëtar, i ngritur pranë qeverisë, por pa qenë pjesë e saj dhe që ka pavarësinë e nevojshme për të qënë një burim i vërtetë dhe i pavarur për këshilla dhe vlerësime. Në disa raste, kur një organizën qeveritar ose i pavarur kryejnë të njëjtin rol, ato duhet të gëzojnë si

besimin e publikut ashtu edhe atë të profesionit. Është e rëndësishme të thuhet që kjo agjensi kombëtare duhet të ketë fuqinë të veprjë si një mbikëqyrës i pavarur i arritjeve në nivel shkollor, lokal dhe kombëtar. Gjykimet që ky institucion ofron për lësinë e arritjeve, përbëjnë edhe një standard të rëndësishëm që shërben si pikë referimi si dhe një burim informacioni dhe vlerësimi për sistemin në të gjitha nivelet.

- ◆ Së fundi, krijion procese të efektshme të përgjegjshmërisë që synojnë ta pajisin sistemin e sigurimit të cilësisë me dinamizmin e brendshëm për përmirësime të vazhdueshme.

Sigurimi i cilësisë në sistemet shkollore

Një sistem i mirë i sigurimit të cilësisë në shkollë:

- ◆ Shpreh qartë qëllimin dhe natyrën e asaj që ofron shkolla. Në varësi të kontekstit, çdo qeveri udhëheq ose mbështet përshtirjen e shkollave dhe të aktorëve kryesorë të saj në një dialog që synon arritjen e marrëveshjes për qëllime të qarta arsimore dhe kurrikulën e përshatshme për arritjen e tyre. Në qendër të dialogut qendron çështja e përmbajtjes së cilësisë dhe të mënyrës së matjes dhe të paraqitjes së saj.
- ◆ Rrit përgjegjësinë e mësuesve dhe të vetë shkollës për sigurimin e cilësisë në sistemin shkollor. Ai siguron që këtë faktorë kryesorë të kenë mbështetjen e duhur në procesin e sigurimit të të dhënave për cilësinë dhe për ndikimin e punës së tyre, së bashku me zhvillimin e përgjigjeve të duhura ndaj analizës së nevojave të kryer prej tyre.
- ◆ Ndhmon në krijimin e ndjenjës së përgjegjshmërisë për punën e përditshme në shkollë dhe në klasë dhe të angazhimit të përbashkët ndaj standardeve të larta.

4. Proceset e sigurimit të cilësisë

Sigurimi i cilësisë përbëhet nga një larmi procesesh. Pikënisje e tij është përcaktimi i cilësisë, i përmbajtjes së saj, gjë që rrjedh nga ajo që në një kohë të caktuar është më e vlerësuar dhe më e rëndësishmja në fushën e arsimit, dhe nga objektivat që synon të arrihen në këtë fushë.

Sigurimi i cilësisë propozon rrugë të ndryshme për të lidhur objektivat e arsimit me rezultatet. Sigurimi i cilësisë nënkupton edhe zhvillimin e arsimit dhe procesin e të nxëniet. Përbërësit e tij janë:

- ◆ Krahasimi i asaj që është me atë si duhet të jenë. Ky është edhe një proces vetvlerësimi, që me kalimin e kohës bëhet i rregullt dhe sistematik, duke u kthyer në një mënyrë reflektimi për praktikën.
- ◆ Marrja e masave për të ngushtuar hendekun ndërmjet dëshirave dhe praktikës, të lidhura me paraparësitë dhe objektivat e rënë dakord. Që këtë merr jetë procesi i planifikimit të zhvillimit.

Të dy pikat e mësipërme shpjegohet hollësisht në kreun 4.

Shkolla si dhe sistemi arsimor janë mjaft kompleks dhe përfshijnë aktorë të shumtë. Zhvillimi dhe përmirësimi i arsimit, si pjesë përbërëse e procesit të sigurimit të cilësisë, duhet të bëhen çështje e përbashkët e aktorëve të ndryshëm sipas roleve dhe përgjegjësi që ka secili lidhur me edukimin.

Sigurimi i cilësisë nënkupton delegimin e përgjegjësi dhe decentralizimin e përgjegjësi vendimmarrëse në nivel shkolle. Nga njëra anë ai nënkupton përfshirjen e aktorëve të arsimit në procesin e ndryshimit, duke qenë në të njëjtën kohë të përgjegjshëm për ndikimin dhe burimet e këtij ndryshimi. Pra, fuqizimi dhe autonomia e shkollës nënkupton përgjegjshmërinë e ndërsjellë të aktorëve të arsimit në nivel shkolle dhe në nivel sistemi arsimor. Për të lehtësuar këtë marrëdhënie, duhet të krijohet edhe kadri i politikës që mbështet shkollat në zhvillimin e tyre dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Një kusht i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë është rritja e vetëdijes dhe të motivimit të vendimmarrësve për ndryshim. Kjo ka vlerë, veçanërisht për mësuesit që janë mësuar të veprojnë në sisteme

tepër të centralizuara ose të bazuara tek kontrolli. Për këtë arsye, rritja e angazhimit dhe e besimit vlerësohen të rëndësishëm për t'u ndierë autorë të procesit të nxënit, të mësimdhënies dhe të përmirësimit në shkollë.

Së fundi, vetvlerësimi i shkollës dhe planifikimi i zhvillimit lidhen me një cikël të vazhdueshëm përmirësimi. Ato nuk janë një proces mekanik e linear, por një proces i vazhdueshëm reflektimi dhe përmirësimi i praktikës së përditshme shkollore.

5. Përgjegjshmëria

Qëllimi kryesor i sigurimit të cilësisë është përmirësimi i arsimit dhe rritja e efektshmërisë së tij. Ai nuk duhet të shihet si diçka që qendron jashtë shkollës dhe praktikës shkollore apo si diçka që u imponohet dhe që, për këtë arsye, duhet të kundërshtohet. Në të kundërtën, ai duhet të shihet si diçka që lind natyrshëm nga shqetësimi profesional për cilësi dhe standarde. Në fakt, mësuesit bëjnë përpjekje për të siguruar cilësinë në punën e tyre të përditshme, por ajo që është e re duket se është një rishikim më zyrtar i praktikës dhe vënia më shumë e theksit tek faktet. Sa më shumë që mësuesit të aftësohet në përdorimin e fakteve në praktikë të tyre mësimore, aq më shumë ata besojnë tek përgjegjshmëria e tyre tek puna e tyre.

Përgjegjshmëria shkon krah për krah me fuqizimin e shkollës. Delegimi i përgjegjësisë të çon në justifikimin e veprimeve ose të vendimeve. Përgjegjshmëri do të thotë që një person, një grup ose një organizatë është i aftë të shpjegojë dhe të justifikojë veprimet dhe vendimet e marra. Ajo nënkupton që::

- ◆ Vendimet dhe rezultatet t'u bëhen të ditura atyre që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe të efektshmërisë së shërbimit dhe lidhur me rezultatet që priten nga ai shërbim;
- ◆ Rezultatet të vlerësohen në bazë të kriterëve të cilësisë dhe objektivave të pranuar paraprakisht;
- ◆ Transparenca për punën e bërë lidhet ngushtë me të qenurit i hapur dhe në të njëjtën kohë ajo harmonizohet me pasojat që vijnë nga përfundimet e vlerësimit;

Ekzistojnë disa metoda që lidhen me përgjegjshmërinë:

- ◆ Metoda e konkurimit të tregut – në bazë të së cilës, shkollat konkurojnë për nxënës dhe burime dhe rezultatet përdoren për të krahasuar shkollat në bazë të një sistemi pikësh;
- ◆ Metoda e decentralizimit dhe delegimit të vendimarrjes – në bazë të të cilës udhëheqja e shkollës është përgjegjëse ndaj bashkësisë dhe ndoshta edhe prindërve, të cilët kanë rolin qendror në procesin e vendimarrjes;
- ◆ Metoda e manaxhimit të kontrollit profesional që përqendrohet në praktikat profesionale të mësuesve, të cilët nga ana e tyre janë përgjegjës dhe për pasojë edhe objekte të kontrolleve në rritje;
- ◆ Lëvizja e standardeve që përfshin përpjekjet sistematike për të krijuar shkolla që të jenë të prirura drejt synimeve, efektivitetit dhe efektshmërisë, përmes përdorimit të procedurave sistematike të manaxhimit¹¹. (skemat e dhënies së çmimeve janë rrjedhojë e kësaj metode sepse arritja e objektivit bëhet një nxitës për përmirësime të mëtejshme;
- ◆ Metoda bashkëpunuese, në të cilën shkollat punojnë bashkë si bashkësi të nxëni të lidhura në rrjet, të mbështetura nga agjencitë kombëtare dhe nga fryma e përgjegjshmërisë së ndësjellë.

6. Sigurimi i cilësisë si një sistem forcash dinamike

Karakteristikë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë të marrë si një sistem është se të gjithë përbërësit e saj, të përshkruar në paragrafin 3 më sipër, janë të ndërlidhur dhe ndikojnë njëri-tjetrin.

¹¹ Kenneth Leitwood, Karen Edge dhe Doris Jantzi, Përgjegjshmëria në arsim: Gjendja e arteve, Rrjeti ndërkombëtar për sisteme të reja shkollore (INIS) Guetersloh, Bertelsman Foundation Publishers, faqe. 49-50, 1999




Figura 2. Përbërësit e sistemit të sigurimit të cilësisë

Më poshtë vijojnë disa shembuj të marrëdhënieve dhe të ndërveprimit të përbërësve të mësipërm:

- ◆ Politikat dhe legjislacioni që përcaktojnë fuqizimin e shkollës (për shembull decentralizimi, autonomia e shkollës dhe e mësuesit) si dhe qëllimet mësimore janë akte qeveritare. Ata qëndrojnë në themel dhe ndikojnë të gjithë përbërësit e tjerë të sistemit të sigurimit të cilësisë.
- ◆ Instrumentet e vlerësimit dhe të dhënat e jashtme mund të përdoren edhe për vetvlerësimin dhe inspektimin e shkollës.
- ◆ Të dhënat e jashtme, si tabelat që përmbajnë renditjen e shkollave në bazë të arritjeve, mund të përdoren edhe si masa të përgjegjshmërisë ose të besueshmërisë.
- ◆ Po kështu, raporte të inspektimit në të njëjtën kohë përmbajnë të dhëna të jashtëme dhe shërbejnë si masa përgjegjshmërie.
- ◆ Raportet nga shkollat ose inspektimi mund të përdoren për qëllime të ndryshme. Ato mund të botohen dhe në këtë mënyrë shërbejnë si masa të përgjegjshmërisë.

-
- ◆ Vetvlerësimi në kuadrin e planifikimit të zhvillimit të shkollës, në vetvete është një metodë përgjegjshmërie pasi ai nënkupton që udhëheqja dhe manaxhimi – d.m.th. vendosja e qëllimeve, planifikimi dhe zbatimi i një strategjie që synon fuqizimin e shkollës – bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të përhapura.
 - ◆ Vetvlerësimi shoqërohet me rritjen e njohurive në shkollë rreth punës dhe arritjeve, gjë që ndihmon shkollën në krijimin e pozicionit dhe autonomisë së saj ndaj inspektimit, gjë që zvogëlon arsyet për perceptime të përgjithësime dhe justifikon gjykimet dhe vendimet.

Çfarë është planifikimi i zhvillimit të shkollës? Si realizohet ai?

Ky kre paraqet karakteristikat kryesore të planifikimit të zhvillimit të shkollës, si një ndërkombëtar themelor të sigurimit të cilësisë të arsimit. Ai përshkruan edhe vetvlerësimin e shkollës si qendror të planifikimit të zhvillimit të shkollës dhe të mësuesve të veçantë shqyrton parimet, fazat dhe sfidat që vijnë para këtij planifikimi. Kreu 6 përshkruan planifikimin e zhvillimit të EQD të shkollës.

1. Çfarë është planifikimi i zhvillimit të shkollës?

Planifikimi i zhvillimit të shkollës ka të bëjë me zhvillimin e shkollës, duke u përqendruar kryesisht në përmirësimin e saj. Një shkollë që përfshihet në planifikimin e zhvillimit të saj, është një shkollë që pranon përgjegjësinë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ajo i ofron nxënësve dhe bashkësisë së saj. Planifikimi i shkollës është një plan veprimesh që fillon me pyetjen “Sa mirë po veprojmë?” dhe vijon me përgjigjen e pyetjes “Si mund ta bëjmë më mirë”. Pasi të kemi përcaktuar disa përgjigje për pyetjen e fundit vjen rradha e punës për t’i vënë ato në jetë.

Ndonëse ky instrument përdor termin “planifikimi i zhvillimit të shkollës”, në këtë fushë janë përdorur edhe terma të tjerë si planifikimi i përmirësimit të shkollës etj.

Plani i zhvillimit të shkollës nuk është i ngjashëm me planin e punës së shkollës. Ky i fundit ka karakter përshkrues dhe faktikisht paraqet atë çfarë ndodh në shkollë të dhënë. Planifikimi i punës së shkollës nuk merret me çështjen e cilësisë; qëllimet e përshkruara nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të gjëndjes së shkollës dhe për këtë arsye nuk mund të quhen qëllime zhvillimore.

Karakteristikat dhe sfidat kryesore të planit të zhvillimit të shkollës në kuadrin e një sistemi të sigurimit të cilësisë jepen më poshtë.

Në vendet me sisteme të efektshme të sigurimit të cilësisë që punojnë në sektorin e arsimit publik, pranohet se shkolla, si njësi, qëndron në zemër të vetë këtij sistemi. Në këtë kuadër, pranohet se faktori që ndikon më fuqishëm arrijtjet e nxënësve është karakteri i shkollës; ndërkohë vetë puna dhe arrijtjet e shkollës si një e tërë përbëjnë burimin më të vlefshëm të informacionit që kërkohet për të funksionuar një sistem i sigurimit të cilësisë. Cilado qofshin risitë ose politikat e reja që mund të zbatohen në nivel kombëtar ose lokal, edukimi dhe të nxënësve ndodhin në shkollë (përfshi këtu edhe mësimdhënien) që është dhe faktori i vërtet më i rëndësishëm që ndikon në arrijtjet e nxënësve. Një sistem i mirë i sigurimit të cilësisë pranon se këto procese të rëndësishme nuk ndodhen në rrezikun e kontrollit nga lart dhe për këtë arsye përmirësimet duhet të kenë si autor dhe të ndërmerren nga aktorët kryesorë të sistemit arsimor – vetë mësuesit. Që këtë del se planifikimi i zhvillimit të shkollës është procesi që e kalon përgjegjësinë te mësuesit dhe që për këtë arsye i fuqizon dhe i aftëson ata për ndërmarrje të tilla.

Plani i zhvillimit të shkollës bazohet në përvojën e një shkolle që vetvlerësohet dhe vetzhvillohet. Megjithatë Planifikimi i zhvillimit të shkollës në kuadrin e një sistemi të sigurimit të cilësisë shkon përtej vetvlerësimit të shkollës.

Në kuadrin e sistemeve kombëtare të sigurimit të cilësisë, proceset e reflektimit në shkollë mbështeten më fuqimisht nga institucionet. Shembujt më të suksesshëm të programeve kombëtare të planit të zhvillimit të shkollës pranojnë nevojën e pajisjes së shkollës me

ndihmën e duhur – udhëzime dhe mbështetje me këshillime që mund të gjenden në nivel lokal; struktura dhe instrumente të përdorshëm dhe të dobishëm për vlerësim; trajnim dhe mbështetje gjatë procesit të zbatimit.

Vështirësitë e ndërmarrjes së hapave për ndryshime në strukturën, kulturën dhe të ardhmen e shkollës, si përbërës të nevojshëm për një plan zhvillimi të shkollës të suksesshëm, nuk merren seriozisht ose nënvlerësohen. Faktet tregojnë se pjesa më e madhe e shkollave duhet të ndihmohen të kuptojnë se si të realizojnë një plan të zhvillimit të shkollës, veçanërisht ato kanë nevojë për ndihmë në fushën e planifikimit, të zbatimit dhe të mbikëqyrjes. Njohuri dhe aftësi të tilla nuk gjenden në një shkollë tradicionale, ashtu sikurse ka pak të ngjarë që kultura sunduese organizative në shkollë të mund të lehtësojë zhvillime të tilla, nëse nuk mbështeten mirë si nga ana praktike ashtu edhe nga ajo procedurale nga agjenci të afta në këtë drejtim.

Së dyti, proceset e vetvlerësimit të shkollës drejtohen dhe mbështeten nga instrumente të siguruara në nivel kombëtar dhe nga të dhëna të siguruara nga burime jashtë shkollës.

Së treti, vetvlerësimi i shkollës duhet të jetë një proces dinamik, në të cilin zhvillimi të shihet si pjesë e shqetësimit për sigurimin e cilësisë dhe pranohet si shqetësim dhe përgjegjësi e të gjithëve. Ky përbën një parim themelor për të patur një sistem të sigurimit të cilësisë të efektshëm që synon të sigurojë që procesi i vetpërmirësimit në kuadrin e sistemit arsimor në tërësi, nuk është thjesht për një pakicë elitare për çdo për çdo shkollë dhe aktor të saj.

Së fundi, planet e zhvillimit të shkollës janë treguesi i rëndësisë së parë për autoritetet arsimore lidhur me përcaktimin e problemeve dhe të përparësive. Nëse dëshirojmë të arrijmë qëllimet kombëtare për zhvillimet dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, atëherë, duke ndjekur me kujdes (pa ndërhyrë) planet e zhvillimit të shkollës, sistemet arsimore mund të rishpërndajnë burimet kombëtare për të trajtuar problemet e identifikuara. Nga ana tjetër, kjo do të aftësojë shkollën të jetë vetë autore e proceseve të zhvillimit dhe të ndryshimit në shkollë.

Si shihet, Planifikimi i zhvillimit të shkollës është në shumë drejtime zemra e një sistemi kombëtar të sigurimit të cilësisë në shkollë. Duke vepruar në kuadrin e një sistemi të sigurimit të cilësisë,

Planifikimi i zhvillimit të shkollës, me anë të tri drejtimeve themelore të tij – qartësimi i përmbajtjes së cilësisë në arsim, përgjegjësia e deleguar në aktorët kryesorë (shkolla dhe mësuesi) dhe përgjegjshmëria e kërkuar në hapat kryesorë të arritjeve- ofron mekanizmat aktualë për përmirësimin e cilësisë në nivel shkollë,gjë që është dhe synimi i sistemit arsimor.

2. Vlerësimi si thelbi i planit të zhvillimit të shkollës

Ndonëse hollësitë e këtij procesi ndryshojnë në varësi të kontekstit, në të mund të vihen re disa praktika të përbashkëta.

Së pari, element i përbashkët dhe thelbësor i këtij procesi është fakti që ai mbështetet në një instrument të thjeshtë vlerësimi (që zakonisht ofrohet në nivel kombëtar) që i aftëson shkollat të formulojnë vlerësimet e duhura për arritjet e tyre. Si shembull i mirë në këtë drejtim mund të përmendet broshura “Sa e mirë është shkolla jonë”, i hartuar në një nga vendet e Evropës Perëndimore në fillim të viteve 90’ dhe i rishikuar vazhdimisht si rrjedhojë e vlerësimeve të marra nga shkollat.¹² Ky dokument identifikon 31 grupe karakteristikash të një shkollë të mirë dhe ofron tregues të arritjeve për çdo grup. Kjo strukturë vlerësimi së bashku me treguesit mund të përdoren nga shkolla për të përcaktuar shkallën e realizimit të objektivave të tyre dhe të identifikojnë fushat ku duhet më shumë vëmendje dhe përmirësim. Këto instrumente pasqyrojnë synimet kombëtare dhe përparësitë për zhvillimin e arsimit të pranuar në nivel kombëtar.

¹² *Sa e mirë është shkolla jonë?* Vetvlerësim që bazohet në tregues të cilësisë, Inspektorati i Arsimit, Skoci, 2002. Shih <http://www.hmle.gov.uk/dokuments/publication/HGIOS>. pdf

Pajisja e shkollës me instrumente të tillë vlerësimi ka rëndësi të paktën për dy arsye. Së pari, ajo ofron mbështetje për procesin e reflektimit: ajo aftëson të gjitha shkollat për gjëra, të cilat vetëm një numër i vogël prej tyre mund t'i bënin pa mbështetje. Së dyti, ekzistenca e një strukture ose kuadri vlerësimi u jep mundësi të gjitha shkollave që të shqyrtojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të punës së tyre dhe jo vetëm ato që kanë vëmendjen e çastit ose ato që vlerësohen më të përshtatshme për t'u trajtuar.

Teorikisht, është gjithnjë e mundshme që një shkollë të jetë e aftë të zhvillojë instrumentet e saj të vlerësimit. Megjithatë, kjo mund të kthehet në një sfidë të rëndësishme dhe madje edhe të padëshiruar edhe për shkolla me përvojë në fushën e planifikimit të zhvillimit të shkollës. Në sisteme të efektshme procesi i reflektimit/vlerësimit i kryer nga vetë shkolla nuk është i vetmi burim të dhënash. Në sistem të efektshme shkollat marrin të dhëna nga burime të jashtme për aspekte të rëndësishme të arritjeve të nxënësve nga sistemi kombëtar i provimeve ose nga testet e hartuara dhe të administruara në nivel kombëtar. Megjithatë edhe kjo kategori të dhënash, në të përmban rreziqet e saj. Ajo mund të shkaktojë deformime në arritjen e shkollave, sepse ajo i zhvendos përparësitë e zhvillimit drejt përmbushjes së kriterëve të jashtme. Këto matje të jashtme, me gjithë rëndësinë që kanë, nga vetë natyra e tyre lidhen me objektiva të përgjithshër armor.

Të gjitha të dhënat, cilësore dhe sasiore duhet të duhet të merren parasysh nëqoftëse planifikimi i zhvillimit të shkollës e udhëheq procesin në drejtimin e duhur.

3. Cila është pamja e planifikimit të zhvillimit të shkollës

Për të kuptuar funksionet kryesore të planifikimit të zhvillimit të shkollës, në vijim po paraqesim në mënyrë sistematike fazat e ciklit të planifikimit. Planifikimi i zhvillimit të shkollës është një proces i vazhdueshëm. Cikli i vlerësimit, krahasimi me qëllimet dhe politikat kombëtare, të kuptuarit, vetpërmirësimi, mbikëqyrja etj., të çon drejt

progresit, por asnjëherë nuk është i plotë. Kjo ilustron edhe në figurën 3 në fund të këtij kapitulli.

Faza 0: Përgatitja fillestare

Kur një shkollë vendos të nisë planin e zhvillimit të shkollës për herë të parë është mirë që ajo t'u jepte të gjithë stafit kohën e duhur për të kuptuar dhe strukturuar procesin dhe më pas, hap pas hapi dhe me kujdes të provojë këtë metodë. Kjo periudhë është e nevojshme jo vetëm për të kuptuar sigurimin e cilësisë dhe planin e zhvillimit të shkollës, por edhe për të përgatitur krijimin e kulturës bashkëveprimit, të kolegjalitetit dhe të punës në grup. Më tej kjo, mund të shtrihet me përfshirjen e aktorëve jashtë shkollës, veçanërisht bordet e shkollës, atje ku këto ekzistojnë, si dhe prindrit, nxënësit dhe bashkësinë. Megjithatë, përbërës thelbësor në këtë proces është hartimi i një programi zhvillimi profesional në të cilin të përfshihet i gjithë stafi.

Faza 1. Ku jemi

Kjo fazë ka të bëjë me trajtimin e çështjes “Ku jemi në raport me përparësitë kombëtare dhe lokale të cilat i kemi vlerësuar si tepër të rëndësishme?”

- Në fillim shkolla ka nevojë për një plan dhe për të ndërmarrë një proces reflektimi dhe vlerësimi, të drejtuar ndoshta nga drejtori i shkollës, por me pjesëmarrjen e të gjithë stafit të saj. Ky proces gjithëpërfshirës pasqyrohet edhe në nivel grupesh lëndore dhe mund të përfshijë edhe prindrit dhe nxënësit.
- I gjithë procesi modelohet, mbështetet dhe drejtohet nga një instrument vlerësimi i shkollës që është përgatitur në nivel kombëtar ose shkollor.
- Ky proces nuk mund të jetë tërësisht i brendshëm. Në të mund të përfshihen edhe burime të tjera të jashtme, për shembull, rezultate të testeve ose të provimeve kombëtare, të dhëna për shëndetin, për kriminalitetin, për braktisjen, për pikëpamjet e aktorëve të arsimit etj. E rëndësishme që në këtë proces është edhe përpjekja për të identifikuar vlefshmëria e jashtme e vlerësimit dhe e analizës së bërë nga vetë shkolla.

-
- Pjesa më e madhe e sistemeve kombëtare parashikon edhe inspektimet dhe vlerësimet e rastësishme të kryera ndoshta një herë në tri ose pesë vjet, nga ekupe specialistësh të jashtëm, të cilët duke përdorur të njëjtin kuadër konceptual si ai i instrumentit të vlerësimit në bazë shkollë, hartojnë një raport për cilësinë e funksionimit të shkollës. Ky raport mund të ofrojë informacion nga etosi i shkollës e deri te cilësia manaxhimit dhe e udhëheqjes dhe marrëdhëniet me prindërit. Megjithatë, vëmendja e tij kryesore është te çështjet e mësimdhënies dhe e të nxënies në shkollë. Në sisteme me përgatitje dhe kryerje të mirë të këtij procesi, raporte të tilla janë burim dhe pikë e rëndësishme referimi për funksionimin e shkollës. Madje, disa shkolla do të mund të punësojnë një konsulent të jashtëm për t'i ndihmuar në këtë proces të gjithanshëm.
 - Procesi i vetvlerësimit duhet të kufizohet në synimet e tij në mënyrë që shkolla jo vetëm realisht të përqendrohet në fushat e saj parësore, por edhe të jetë e efektshme brenda kohës së përcaktuar. Koha e këtij procesi është e rëndësishme, sepse nëse Planifikimi i zhvillimit të shkollës duhet për fillimin e vitit shkollor, atëherë është e qartë që ai duhet të jetë pothuajse i përfunduar në fund të vitit të shkuar shkollor-pra të jetë në kohë për vendimet që do të merren për stafin, për rishpërndarjen e burimeve sipas përparësive etj., për të reflektuar për përfundimet e procesit të vlerësimit dhe të vetvlerësimit. Çka thamë më sipër, ka vlerë si për qëllimet realiste për procesin në tërësi ashtu edhe për planifikimin e kujdesshëm të vlerësimit.

Faza 2: Si mund të përmirësohemi?

Detyra e hartimit të planit të zhvillimit të shkollës fillon pasi përfundimit të procesit të reflektimit. Fazat që shoqërojnë këtë proces janë si më poshtë:

- Përcaktimi i një modeli për pikat e forta dhe të dobëta.
- Përpunimi i strategjisë së zhvillimit, duke përfshirë këtu edhe vendimet për përparësitë e zhvillimit gjatë vitit në vijim, përcaktimi i objektivave të zhvillimit sipas aftësisë së shkollës, identifikimi i hapave që duhen të ndërmerren për të realizuar objektivat si dhe

-
- përgjegjësitë përkatëse (në këtë proces të fundit, ndonjëherë mund të përfshihen edhe autoritetet lokale ose inspektorati kombëtar)
- Identifikimi i nevojave të veçanta, ndonjëherë edhe individuale, të trajnimit që rrjedhin nga përparësitë e vendosura (Drejtuesi dhe stafi i shkollës), dhe zhvillimi i planit të trajnimit si pjesë e planit të përgjithshëm të zhvillimit.
 - Identifikimi i nevojave për mbështetje të mëtejshme (konsulencë, burime të reja të nxëni etj.) si dhe përcaktimi i burimeve për t'i siguruar ato.
 - Identifikimi i ndryshimeve të domosdoshme që duhet të bëhen në fushën e organizimit ose të manaxhimit për të përmbushur objektivat dhe për të shpërndarë burimet në funksion të zhvillimit të planifikuar.
 - Ngritja e instrumenteve për monitorimin e progresit drejt përparësive dhe objektivave të vendosur dhe marrja e masave për të ndërmarrë veprimet e duhura në rast se është e nevojshme.

Faza 3: Zbatimi

Pjesa më e madhe e vitit shkollor i kushtohet zbatimit i parimeve dhe përparësive të planit të zhvillimit të shkollës. Në këtë kuadër, parësore për vetë shkollën dhe mësuesit, është që ky proces të shoqërohet me rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit dhe me krijimin e një klime shkollore mbështetëse dhe nxitëse. Pra planifikimi i zhvillimit të shkollës të mbështesë konkretisht këto përparësi, pasi mund të ndodhë që shkolla fiksohet ndaj cilësisë së këtij planifikimi dhe të harrojë detyrat e saj kryesore. Një plan i mirë i zhvillimit të shkollës ka në zemër të tij një proces të mirë mësimdhënie dhe të nxëni dhe vetë procesi i planifikimit dhe i zbatimit duhet të mbështesë objektiva të tillë.

Faza 4. Ku jemi? Sa mirë vepruam?

Cikli i planit të zhvillimit të shkollës duhet të përfundojë, në një farë mënyrë atje ku filloi – me shqyrtimin nga aktorët kryesorë të procesit. A i përmbushi shkolla objektivat e saj në bashkëpunim me aktorë të tjerë? Rezultati i këtij reflektimi, së bashku me burime të jashtëme të dhënash ose vlerësimesh dhe me ide të reja për t'u përfshirë në përparësitë kombëtare ose lokale për zhvillim, do të përbëjnë inputin kryesor për

procesin e planifikimit për vitin e ri shkollor. Në këtë mënyrë, ky proces do të riciklohet në mënyrë të vazhdueshme, duke u bërë, nëse zhvillohet si duhet, gjithnjë e më i efektshëm dhe një burim gjithnjë e më i rëndësishëm informacioni.

4. Probleme dhe sfida

Zbatimi i planit të zhvillimit të shkollës shtron edhe disa çështje për t'u marrë parasysh:

- ◆ Planifikimi i zhvillimit të shkollës, jo domosdoshmërisht zhvillohet ashtu si e paraqitëm më lart. Të kuptuarit e planit të zhvillimit të shkollës dhe të sigurimit të cilësisë si dhe zhvillimi i një kulture të vlerësimit dhe të bashkëpunimit në shkollë janë kushte të domosdoshme, por ato mund të përfundojnë si rezultate të procesit të planit të zhvillimit të shkollës, përmes “një procesi të të nxënit duke bërë”. Kjo mund të jetë e vërtetë, veçanërisht në rastet kur shkolla e kryen këtë për herë të parë.
- ◆ Planifikimi i zhvillimit të shkollës është një proces i ngritjes së kapaciteteve. Vlerësimi të jep mundësinë që për një çast të ndalosh, të shqyrtosh arritjet, të rishikosh burimet, të identifikosh nevojat për mbështetje dhe trajnim me qëllim përmirësimi. Kjo do të krijojë mundësinë e lindjes së ideve dhe e aftësive të reja të cilat mund të përdoren për ciklin e ri të zhvillimit, ashtu siç ilustrohen në figurën 4.
- ◆ Për të patur një planifikim të mirë zhvillimi, shpesh herë një vit nuk është i mjaftueshëm. Për shumë shkolla, objektivat kryesorë të planifikimit të zhvillimit kërkojnë një periudhë tri – katër vjeçare dhe vetëm rishikime të vogla mund të bëhen në vitet ndërmjetës. Nëse duket qartë se zhvillimet nuk po i përmbushin objektivat, atëherë është i nevojshëm një rishikim i plotë i përparësive dhe i planeve.
- ◆ Në kushtet e mungesës së një sistemi të besueshëm të sigurimit të cilësisë, për shembull, përgjegjshmëria e kërkuar prej shkollave dhe mbështetja që atyre duhet t'u sigurohet për të arritur përmirësimet e

dëshiruara dhe fuqizimi e delegimi i përgjegjësive të shkollat nuk janë në nivelin e dëshiruar, shkollave lihen në një gjëndje të tillë ku duhet të manazhojnë çështje dhe probleme që dalin përtej përgjegjësive të tyre të çastit. Qeveritë duhet të paralajmërohen fuqimisht për të mos ndërmarrë hapa të tillë.

- ◆ Nga ana tjetër, nuk ka asnjë dyshim, që në kushtet e një sistemi të efektshëm të sigurimit të cilësisë, fuqizimi dhe delegimi i një pushteti vendimarrës real dhe të efektshëm të shkollat dhe mësuesit është një përbërës jetësor dhe i domosdoshëm i një zhvillimi të efektshëm. Planifikimi i zhvillimit të shkollës do të funksionojë vetëm nëse shkollat fuqizohen të ngrenë dhe të organiaojnë burimet e tyre për realizimin e objektivave të tyre në kohën e duhur.
- ◆ Faktor i rëndësishëm për t'iu shtuar fuqizimit është përgjegjshmëria e efektshme Mjetet për të patur rezultatet e duhura të bazuara në përgjegjshmërinë duhet të jenë të efektshme dhe të qëndrueshme. Koha kur faktori përgjegjshmëri hyn në veprim është fundi ciklit: nuk ka më vend për ndërhyrje dhe kontroll në mes të ciklit, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me çështje të ndërshëmërisë fiskale dhe ligjore.
- ◆ Natyra gjithëpërfshirëse e planifikimit të zhvillimit të shkollë, d.m.th. pranimi në vijim i përgjegjësive së funksionimit të të gjithë shkollës nga mësuesit dhe stafi i saj, vlerësohet nga shumica si një përvojë krejtësisht e re, ashtu siç është e tillë edhe pranimi nga drejtori i shkollës i një mënyre të re të drejtimit dhe të ushtrimit të autoritetit prej tij. Drejtuesit dhe mësuesit nuk duhen detyruar por duhen ndihmuar në këtë lloj tranzicioni në rolet e tyre.
- ◆ Planifikimi i zhvillimit të shkollës dhe nxitimi për ta përmirësuar atë, përmban rrezikun që ai të shtrihet në të gjitha çështjet që shqetësojnë shkollën dhe, për rrjedhojë, të anashkalohen problemet që lidhen me detyrën kryesore të shkollës, që është ajo e mësimdhënies dhe e të nxënit. Për këtë arsye duhet bërë kujdes që ky planifikim të përqendrohet vetën në çështje parësore, mundësisht në një ose dy fusha të rëndësishme dhe asnjëherë të mos bëhet qëllim në vetvete.

Fig. 3. Cikli i planifikimi i zhvillimit tw shkollws





Fig. 4 Dy rrrathët e vlerësimit¹³



¹³ Bazuar nw paraqitjen e Xhon MakBeth ne seminarin e Sigurimit tw cilswsisw sw EQD, Brdo/Kokra, 27-29 janar 2005



Korniza për të vlerësuar EQD

Ky instrument, duke filluar nga ky kre kalon në shqyrtimin e sigurimit të cilësisë në mënyrë të veçantë në fushën e EQD në shkollë, duke u bazuar në parimet e sigurimit të cilësisë në arsim (Kreu 3) dhe në planifikimin e zhvillimit të shkollës (Kreu 4). Ai paraqet një strukturë për të vlerësuar EQD. Së pari ai shpjegon karakteristikat kryesore të treguesve dhe më pas treguesit e cilësisë së EQD, që janë zhvilluar rishtazi për këtë instrument, duke u mbështetur në parimet e EQD të paraqitura në Kreun 2. Përdorimi i këtij instrumenti përshkruhet në Kreun 6.

1. Hyrje

Ky kre paraqet një instrument të veçantë për të vlerësuar EQD në shkollë, në përputhje me parimet e përgjithshme dhe metodën e sigurimit të cilësisë dhe të planifikimit të zhvillimit të shkollës. Siç e kemi parashtruar në kërret parardhës, shkolla është një njësi e efektshme për sigurimin e cilësisë. Një ndër aspektet kryesore të sigurimit të cilësisë është përdorimi i treguesve për vlerësimin në kuadrin e procesit të planifikimit të zhvillimit të shkollës. Qëllimi i treguesve të cilësisë të paraqitur më poshtë është të vëmë theksin, të strukturujmë dhe të lehtësojmë vlerësimin e EQD në shkollë: kjo bëhet duke përshkruar se cili përbërës i punës së shkollës duhet të vlerësuar në këtë fushë.

Në përgjithësi, treguesit janë elementët kryesorë për të bërë një vlerësim. Për të vlerësuaër punën e shkollës, sistemet e ndryshme kombëtare të treguesve do t'i strukturonin ata në katër fusha kryesore: input, procesi, output dhe konteksti.

Megjithatë meqë ata përqendrohen në EQD dhe përputhen me parimet e EQD dhe me metodën që ka në themel gjithëpërfshirjen e shkollës të përshkruar në Kreun 2, treguesit e EQD (a) nga pikëpamja

tematike, janë të strukturuar në tri fusha kryesore (kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënit; klima e shkollës; manaxhimi dhe zhvillimi); dhe (b) e paraqesin EQD si një parim i politikës dhe i organizimit të shkollës dhe si një proces pedagogjik.

E tërë puna e shkollës, që lidhet me EQD shprehet në gjashtë trgues të cilësisë dhe secili prej tyre ndahet në nëntema dhe nënçështje të tjera.

Treguesit pasqyrojnë vendimet e autorëve rreth rëndësisë së zbatimit të një detyre të veçantë që një shkollë e kryen në mënyrë të veçantë në lidhje me EQD. Përmbajta dhe fusha e veprimit e çdo treguesi janë në koherencë me njëri-tjetrin. Treguesit janë të ndërlidhur. Aspektet e EQD mund të shfaqen vetëm në njërin ose në tjetrin tregues, ashtu sikurse ata mund të shfaqen edhe në disa tregues. Në këtë rast ata do të shqyrtohen në këndvështrimin e fushës përkatëse.

Treguesit dhe në mënyrë të veçantë përshkruesit, paraqesin një cilësi të dëshiruar të EQD. Ato ofrojnë kriteret për të gjykuar dhe për të krahasuar “çfarë është” me “çfarë duhet të jetë”. Në këtë mënyrë, treguesit nuk përshkruajnë nivele të ndryshme të cilësisë së shkollës (nga e dobëta tek e shkëlqyeshmja), gjë që duhet të dalë nga vlerësimi. Objekti i planifikimit të zhvillimit të shkollës është vendimmarrja lidhur me masat për përmirësimin e shkollës dhe për zbatimin e tyre hap pas hapi, drejt standardeve të dëshirura. Përveç kësaj, grupi i treguesve sado të përgjithshëm që të jenë të referojnë, aq sa është e mundur, në praktika të zakonshme. Ata janë hartuar si një grupim i zakonshëm udhëzimesh që duhet të përshtaten për t’u përdorur në sisteme të veçanta arsimore.

Treguesit janë hartuar për të qenë të thjeshtë në përdorim. Megjithatë, ata janë edhe kompleks, përse kohë ata lidhen me detyra të ndryshme të shkollës. Në të njëjtën kohë, ata nuk duhet të vleësohen si një listë përfundimtare kontrolli. Shkolla, për të vleësuar punën e saj, mund të zgjedhë një, disa ose të gjithë treguesit. Në parim, ata pasqyrojnë vendimin që të gjithë aktorët mund ose duhet të përfshihen në procesin e vetvlerësimit dhe të përmirësimit të punës së një shkolle. Në mënyrë të veçantë, treguesit mund të përdoren si për vlerësimin e brendshëm të shkollës, ashtu edhe për atë të jashtëm, për shembull, të bërë nga inspektorët.

Kreu 6 përshkruan me hollësi, se si duhet të përdoren treguesit për të vlerësuar punën e shkollës në fushën e EQD.

Struktura e vlerësimit përmbledhet në tabelën e mëposhtme.

Fushat	Treguesit e cilësisë	Nënçështjet
Kurrikula, mësimdhënia, të nxënësit	Treguesi 1 A ka dëshmi për vendin e duhur të EQD në synimet, politikat dhe planet kurrikulare të shkollës?	<ul style="list-style-type: none"> • Politikat e shkollës në EQD • Planifikimi i zhvillimit të shkollës në EQD • EQD dhe kurrikula shkollore • Koordinimi i EQD
	Treguesi 2 A ka dëshmi që nxënësit dhe mësuesit kuptojnë EQD dhe i zbatojnë parimet e EQD në praktikën e tyre të përditshme në shkollë dhe klasë?	<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e të nxënësit të EQD • Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënësit • Mbikëqyrja e EQD
	Treguesi 3 A janë planifikimi dhe praktika e vlerësimit në shkollë në përputhje me EQD?	<ul style="list-style-type: none"> • Transparenca • Drejtësia • Përmirësimi
Kultura dhe klima e shkollës	Treguesi 4 A i pasqyron kultura e shkollës si duhet parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i parimeve të EQD në jetën e përditshme • Marëdhëniet dhe modelet e autoritetit • Shanset për pjesëmarrje dhe vetshprehje • Procedurat për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e dhunës dhe diskriminimit
Manaxhimi dhe zhvillimi	Treguesi 5 A ka dëshmi të një udhëheqje të efektshme të shkollës, të bazuar në parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> • Stili i udhëheqjes • Vendimmarrja • Ndarja e përgjegjësiave, bashkëpunimi dhe puna në grup • Ndjeshmëria
	Treguesi 6 A ka shkolla një plan të arsyeshëm zhvillimi që pasqyron parimet e EQD	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja dhe përfshirja • Zhvillimi profesional dhe organizativ • Manaxhimi i burimeve • Vetvlerësimi, mbikëqyrja dhe përgjegjshmëria



2. Treguesit e cilësisë për EQD

Kurrikula, mësimdhënia, të nxënit

Treguesi 1. A ka dëshmi për vendin e duhur të EQD në synimet, politikat dhe planet kurrikulare të shkollës?

Politikat e shkollës në fushën e EQD

Shkolla ka një politikë të shprehur qartë për zhvillimin e EQD, që përbën një element i rëndësishëm i synimeve të saj arsimore për stafin, nxënësit dhe bashkësinë. Kjo politikë lidh qartë qëllimet e përgjithshme të EQD me kontekstin dhe rrethanat aktuale të shkollës dhe me përparësitë kombëtare për veprim. Ajo përfshin qëllime të qarta praktike e strategjike të rëndësishme për zhvillimet në këtë fushë, duke pasqyruar edhe nevojat lokale. Politika në fjalë njih dhe pranon edhe grupimet e çështjeve të cilave duhet t'u kushtohet rëndësia e duhur, përfshi këtu kurrikulën, stilet dhe praktikën e mësimdhënies si dhe çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe drejtimin e shkollës në tërësi.

Planifikimi i zhvillimit të shkollës në EQD

Në shkollë ekziston një plan për vënien në jetë të politikës së saj. Ky plan, përmban hapat praktikë që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet e zhvillimit dhe është një përbërës i rëndësishëm për të gjithë planifikimin e zhvillimit të shkollës. I gjithë stafi i shkollës janë të vetëdijshëm për këtë plan dhe e zbatojnë atë në kuadrin e rolit dhe të përgjegjësi të tyre profesionale në shkollë dhe në klasë.

EQD dhe kurrikula shkollore

Përmbajtja e kurrikulës shkollore mbulon të gjitha njohuritë, aftësitë dhe vlerat e shpallura në udhëzimet kombëtare të kurrikulës së EQD. Politika e shkollës për integrimin e EQD në kurrikul është në përputhje me politikën kombëtare lidhur me kurrikulat, si në rastin kur theksi bie në strategjitë kroskurrikulare, në përfshirjen në të gjithë kurrikulën ose në kurset e veçanta kurrikulare. Në të njëjtën kohë ekzistojnë

dëshmi që shkolla i ka marrë në konsideratë të gjithë hapat e mundshëm për planifikimin e saj. Një shqyrtim i të gjithë kurrikulës nxjerr në pah rëndësinë e duhur që i është kushtuar EQD nga pikëpamja e kohës që i është lënë në kurrikul dhe përparësisë në kuadrin e rezultateve të pritshme. Përveç kësaj, këto përparësi pasqyrohen në veprimtaritë ekstrakurrikulare të shkollës në fushën e EQD si dhe në lidhjet pozitive dhe të efektshme të shkollës me bashkësinë.

Koordinimi i EQD

Shkolla ka caktuar një koordinator ose një grup koordinimi për veprimtaritë e EQD dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për të deleguar pushtetet dhe përgjegjësitë e duhura në personat ose në strukturat përkatëse. I gjithë stafi i shkollës pranon rëndësinë e këtij roli dhe mekanizmi. Ekzistojnë edhe procedurat e duhura për planifikime të përbashkëta dhe për rishikime sistematike të veprimtarive të EQD. Përveç këtyre, shkolla ka vënë në përdorim burime të ndryshme në këtë fushë si dhe materialet e duhura mësimore.

Tregues 2. A ka dëshmi që nxënësit dhe mësuesit e kuptojnë EQD dhe i zbatojnë parimet e EQD në praktikën e tyre të përditshme në shkollë dhe klasë?

Rezultatet e të nxënit të EQD

Në nivel klase ekzistojnë dëshmi që mësuesit dhe administratorët e shkollës janë angazhuar që nxënësit të arrijnë rezultatet e pritura në fushën e EQD. Ekziston raporti i duhur në planin mësimor lidhur me përparësinë e objektivave të të nxënit në fushën e EQD me praktikën e përditshme të mësuesit. Kështu, në këndvështrimin kroskurrikular, mësuesit e lëndës ende mësojnë lëndën e tyre me efektshmëri, ndërkohë që ata respektojnë, theksojnë dhe ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të EQD. Në kuadrin e raporteve të drejta të rezultateve të përgjithshme të të nxënit, ekziston trajtimi i duhur i njohurive të parimeve, të institucioneve dhe të proceseve demokratike dhe një ushtrim i kënaqshëm i aftësive pjesëmarrëse dhe i zhvillimit të vlerave dhe sjelljeve demokratike.

Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve

Mësuesit e shohin rolin e tyre si burim njohurish dhe autoriteti për nxënësit dhe në të njëjtën kohë, marrëdhëniet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve karakterizohen nga respekti dhe nga pranimi i i ndërsjellë i të drejtave, i përgjegjësive dhe interesave të njëri-tjetrit. Mësuesit transmetojnë njohuri që lidhen me EQD duke përdorur si metodat e transmetimit të njohurive ashtu edhe ato pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese. Nxënësve u sigurohen shanset për të mësuar demokracinë dhe pjesëmarrjen përmes përmbajtjes së duhur dhe në praktikë, për shembull, përmes punës me projekte. Të tilla projekte lidhen me punën e klasës në të cilën mësuesit veprojnë si lehtësues, duke qenë në të njëjtën kohë edhe pjesë e veprimtarive ekstrakurrikulare. Qytetaria demokratike mësohet përmes mundësive që u jepen nxënësve për t'u përfshirë, për shembull, në bashkësi dhe në veprimtarinë e OJF.

Mbikëqyrja e EQD

Janë marrë të gjitha masat për mbikëqyrjen e përparimit të nxënësve për arritjen e objektivave të të nxënësve në fushën e EQD. Përdoren dhe harmonizohen metoda të larmishme si teste, vëzhgime të mësuesve, të nxënësve, portofolet e nxënësve dhe vetvlerësimet e nxënësve. Ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zhvillimit individual dhe shoqëror të nxënësve si dhe procedurat për trajtimin e duhur dhe me efektshmëri të problemeve. Rezultatet e nxënësve u raportohen prindërve rregullisht. Ekzistojnë dëshmi për riplanifikimin të hollësishëm të mësimdhënies mbi bazën e rezultateve të procesit të mbikëqyrjes. Shkolla është në gjendje të ofrojë fakte të përparimit që ajo ka bërë në arritjen e qëllimeve të EQD.

Treguesi 3. A janë planifikimi dhe praktika e vlerësimit në shkollë në përputhje me EQD?

Transparenca

Mësuesit, përpara se të bëjnë vlerësimin e njohurive dhe të aftësive në lëndë të veçanta, u shpjegojnë nxënësve se çfarë shpresojnë prej tyre dhe cilat janë kriteret për vendosjen e notave. Ata u shpjegojnë atyre

rezultatet e vlerësimit, pse dhe si ata arritën në ato përfundime, u ofrojnë shembuj provimesh dhe testesh që janë vlerësuar me nota të ndryshme, si dhe shembuj të përgjigjeve të sakta. Nxënësit nxiten të kërkojnë qartësimin e kriterëve mbi bazën e të cilave janë vlerësuar me notë. Në të njëjtën kohë ata përfshihen në procesin e vlerësimit sa herë që është e përshtatshme.

Drejtësia

Shkolla e bazon veprimtarinë e saj në parimin e barazisë si një ndër parimet themelore në fushën e vlerësimit të njohurive dhe të aftësive. Kjo do të thotë se nxënësit vlerësohen me nota të njëjta për të njëjtat njohuri dhe aftësi. Mësuesi përdor të njëjtët kriterë për vlerësimin e të gjithë nxënësve, të cilët si grup duhet të vlerësohen të barabartë nga pikëpamja e statusit (si nxënës), pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, përkatësia etnike, fetare, gjuha, stili i jetës, prejardhja ekonomike-shoqërore, opinioni i tyre politik ose për çështje të tjera, nga interesi i veçantë për një lëndë ose nga dallime të tjera që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin arsimor.

Mësuesit nuk i përdorin vlerësimin e njohurive dhe të aftësive në lëndë të veçanta si mjet për të forcuar disiplinën në klasë.

Shkolla merr masa për të siguruar që grupet përkatëse të mësuesve zhvillojnë dhe të zbatojnë të njëjtët kriterë për të gjykuar dhe për të vlerësuar vlerësimi dhe që këto kriterë të jenë sa më shumë të jetë e mundur në përputhje me kriteret kombëtare të vlerësimit.

Përmirësimi

Mësuesit e përdorin vlerësimin për të fituar informacion të vazhdueshëm për nxënësit. Qëndrimi i nxënësve ndaj vlerësimit është pozitiv dhe rezultatet e tij përdoren prej tyre për të përmirësuar të nxënët. Rezultatet e vlerësimit (notat) u bëhen të njohura nxënësve dhe prindërve. Ato përdoren nga shkolla në procesin e vetzhvillimit dhe për përmirësimin e punës së mësuesve.

Rezultatet e vlerësimit përdoren për planifikimin e zhvillimit të shkollës. Në bazë të arritjeve të procesit të vlerësimit në kuadrin e planifikimit të zhvillimit të shkollës, përfshirë këtu edhe vlerësimin e

arritjeve të mësuesve dhe të stafit mësimor, vendosen synimet për përmirësimin e vlerësimit të shkollës.

Klima dhe kultura e shkollës

Treguesi 4. A i pasqyron si duhet klima dhe kultura e shkollës parimet e EQD?

Zbatimi i parimeve të EQD në jetën e përditshme të shkollës

Parimet e EQD përshkojnë të gjitha aspektet e jetës shkollore. Shkolla ndërmerr hapa të qartë për të siguruar njohjen, vlerësimin dhe zbatimin e parimeve të EQD në jetën shkollore. Nxënësit, mësuesit dhe aktorët e tjerë të shkollës i kuptojnë parimet e EQD si vlera të përbashkëta të një shkolle demokratike. Sjellja e tyre pasqyron respektin për dinjitetin personal, barazinë, drejtësinë, ndjeshmërinë, diversitetin, përfshirjen dhe solidaritetin. Angazhimi i të gjithëve për zhvillimin e synimeve, të vlerave, të simboleve dhe të praktikave të EQD në klasë, në veprimtari ekstrakurrikulare, në festa të shkollës dhe takime të tjera është i lartë.

Marrëdhëniet dhe modelet e autoritetit

Shkolla nxit dhe zhvillon hapur marrëdhënie miqësore dhe të kujdesi ndërmjet të gjithë aktorëve të saj. Komunikimi dhe sjelljet në shkollë pasqyrojnë modele të autoritetit që bazohen në rregulla, në shpërndarjen e qartë të roleve, të të drejtave dhe të përgjegjësisive. Të gjithë aktorët e shkollës, veçanërisht nxënësit, mësuesit dhe prindërit përfshihen në përgatitjen dhe përshtatjen këtyre rregullave. Shkolla vepron si një ekip, në të cilin marrëdhëniet dhe autoriteti janë të vendosura dhe ushtrohen që t'i shërbejnë zhvillimit individual dhe kohezionit në klasë dhe në shkollë.

Shanset për pjesëmarrje dhe vetshprehje

Funksionet e shkollës si një forum i hapur i të gjithë aktorëve të shkollës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së të nxënësve, të mësimdhënies dhe të manaxhimit. Nxënësit, marrin pjesë rregullisht në vendimmarrje dhe shprehin lirisht mendimin e tyre në të gjitha nivelet e jetës shkollore, drejtpërdrejt ose të tërthortë, përmes

këshillave të nxënësve, klubeve ose organizatave të ngjashme me to, medias. Ata janë të vetëdijshëm për rëndësisinë e pjesëmarrjes dhe të vetshprehjes për mirëqënien e tyre, si dhe për mirëqënien e shkollës dhe të shoqërisë. Duke u përfshirë në diskutime, nxënësit dhe i gjithë stafi arsimor dëshmojnë vetëdije dhe pjesëmarrje që buron prej njohurive, aftësive komunikuese, veçanërisht prej të dëgjuarit aktiv, të menduarit kritik dhe reflektiv dhe argumentues.

Procedurat për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e dhunës dhe diskriminimit

Shkolla zbaton politika, instrumente dhe procedura të efektshme për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e çështjeve të dhunës dhe të diskriminimit në mënyrë paqësore dhe dinjitoze. Konfliktet nuk shpërfillen ose zgjidhen thjeshtë me forcën e autoritetit. Ndryshimet në pushtet që lindin nga statuset e ndryshme të aktorëve të shkollës njihen dhe pranohen. Hapi i parë për të zgjidhur konfliktet është diskutimi, manxhimi dhe transformimi i tyre në burim i të nxënësve të mirëkuptimit dhe të respektit të ndërsjellë dhe i përgjegjësisë përmes zbatimit të parimeve të mbrojtjes së dinjitetit personal, të respektit për larmishmërinë, drejtësinë dhe paanshmërinë. Mësuesit, nxënësit dhe i gjithë stafi i shkollës janë të përgatitur dhe të angazhuar zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, veçanërisht me anë të mediacionit dhe negocimit.

Manaxhimi dhe zhvillimi

Treguesi 5, A ka dëshmi të një udhëheqje të efektshme të shkollës, të bazuar në parimet e EQD?

Stili i udhëheqjes

Udhëheqja e shkollës dëshmon se i kupton mirë parimet e EQD. Shkolla ka një udhëheqje aktive, përfshirëse dhe bashkëpunuese. Organizmat që qeverisin shkollën kanë pushtetin të marrin vendime lidhur me drejtimin dhe zhvillimin e shkollës dhe ka dëshmi se anëtarët e zgjedhur kryejnë rolin e duhur në drejtimin e shkollës. Drejtori i shkollës vlerëson EQD në zhvillimin e shkollës dhe hartimin e politikës së saj. Udhëheqja e

shkollës luan rol akti në ndërtimin e një klime pozitive dhe në vendosjen e kushteve që mundësojnë dialogun, pjesëmarrjen, respektin për të tjerët dhe për idetë e tyre. Manaxhimi i shkollës siguron që të gjithë anëtarët e këtij institucioni të kenë mundësi të arrijnë në informacionin që dëshirojnë.

Marrja e vendimit

Udhëheqja e shkollës pranon se është përgjegjëse për mbarëvajtjen e të gjitha çështjeve të shkollës dhe vepron në përputhje me këtë rol. Ajo nxit nismat, vendimet dhe veprimet e anëtarëve të stafit të shkollës. Një shkollë që funksionon mirë në këtë fushë përfshin nxënësit, prindërit, anëtarët e bashkisë, si dhe partnerët shoqërorë dhe agjenci të tjera, në procesin e vendimmarrjes për drejtimitet e ardhshme të shkollës. Drejtori i shkollës pranon bashkëpunimin në veprimet ekzekutive, në politikat alternative, në procedurat këshilluese dhe në vendimmarrjet e përbashkëta.

Përgjegjësia e përbashkët, bashkëpunimi dhe puna në ekip

Drejtori i shkollës përpiqet që të ndajë përgjegjësinë në bashkësinë shkollë. Ai krijon mundësi për përgjegjshmëri tek aktorët e shkollës, që kjo të jetë në gjendje të dëshmojë përparimet në fushën e të nxënësve dhe në arritjen e synimeve të saj. Në shkollë funksionon mirë grupi i zhvillimit të qytetarisë në të cilin bëjnë pjesë drejtori, mësuesit dhe përfaqësuesit e prindërve dhe të organizmave të zgjedhur të shkollës (si këshillat e nxënësve dhe komitetet e prindërve). Mësuesit e rinj kanë mbështetjen e duhur për të zhvilluar metodën e tyre të zhvillimit të EQD dhe rolin e tyre në kuadrin e politikës së përgjithshme të shkollës në fushën e EQD. Drejtori i shkollës i trajton të gjithë anëtarët e stafit të shkollës në mënyrë të barabartë. Ai nuk ruan distancën hierarkike me anëtarët e tjerë të stafit por e sheh veten e tij, si pjesë përbërëse e të gjithë bashkësisë së shkollës. Udhëheqja e shkollës kërkon dialog, debat dhe marrëveshje në rastet e dilemave, të pikëpamjeve e konflikteve të ndryshme. Mësuesit punojnë së bashku për realizimin e detyrave të zhvillimit dhe të temave kros-kurrikulare.

Ndjeshmëria

Udhëheqja e shkollës është e mirëinformuar dhe e angazhuar për zbatimin e ligjislacionit dhe të politikës që lidhet me EQD. Drejtori i shkollës përdor statusin e tij si drejtues profesional për të zhvilluar praktika të mësimdhënies dhe të të nxëniet që mbështesin parimet e EQD. Ai punon me anëtarët e stafit për të trajtuar me efektshmëri rastet e padëshiruara siç janë dhuna në shkollë, diskriminimi, seksizmi, veçimi, racizmi, ksenofobiadhe paragjykimi lidhur me çështjet fetare dhe grupet kulturore.

Treguesi 6. A ka shkolla një plan të arsyeshëm zhvillimi, që pasqyron parimet e EQD?

Pjesëmarrja dhe përfshirja

Pjanifikimi i shkollës është një proces i efektshëm bashkëpunimi. Ai përfshin një numër të larmishëm pjesëmarrësish (organizma qeverisës, drejtorin e shkollës, stafin mësimor, grupet e zhvillimit të qytetarisë, nxënësit dhe bashkësinë lokale) në të gjithë ciklin e planifikimit. Ekipi i manaxhimit fuqizon të gjithë anëtarët e stafit të shkollës për të siguruar një angazhim të qartë, përgjegjësi të përbashkët dhe mbështetje për planin në fjalë. Plani i zhvillimit të shkollës përmban kushtet dhe veprimet përkatëse për idenfikimin dhe plotësimin e nevojave të të gjithë nxënësve, përfshirë edhe ato të atyre me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta të nxëni. Në shkollë ekzistojnë strukturat e duhura për bashkëpunim dhe këshillim për të trajtuar çështjet e veçanta të zbatimit të planit (grupet e punës, komitetet drejtuese, ekipet e ekspertëve dhe të këshillimit, organizmat përfaqësuese të jashtëm etj) Bashkësia lokale përfshihet në procesin e planifikimit dhe të zbatimit. Kjo nënkujpton analizën e nevojave lokale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta shkollë-bashkësi, pjesëmarrje në procesin e mbikëqyrjes dhe të vlerësimit, të lobimit, të mbështetjes financiare dhe të reklamimit. Bashkësia lokale mbështet përparësitë e zhvillimit të shkollës, përfshirë këtu edhe çështjet që lidhen me EQD.

Zhvillimi profesional dhe organizativ

Plani kënaq shpresat për zhvillime profesionale dhe organizative të të gjithë shkollës. Ai vlerëson mundësitë e reja që përmbajnë praktikat dhe

veprimtaritë e EQD. Ai ofron parimet bazë dhe programin për lidhje me bashkësinë lokale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përparësive në këtë nivel.

Manaxhimi i burimeve

Stafi ka prejardhje të mirë profesionale dhe ofron shërbime cilësore. Plani ofron përgjegjësi konkrete për çdo individ dhe nis procesin e rishikimit sistematik të nevojave të të gjithë pjesëmarrësve për trajnim, informim dhe zhvillim. Plani i zhvillimit të shkollës vlerëson aftësitë që lidhen me EQD, për shembull njohuritë për demokracinë dhe institucionet e saj, aftësitë shoqërore dhe komunikuese, aftësitë që lidhen me pjesëmarrjen dhe përgjegjshmërinë (mbikëqyrjen, vlerësimin raportimin).

Ekzistojnë burime të shumta për të gjithë anëtarët e institucionit. Materialet shkollore, mjetet dhe shërbimet plotësuese janë parashikuar që të plotësojnë nevojat e shkollës me efektshmëri. Ekipi manaxhues ka përcaktuar coston vijuese të zbatimit të planit përmes marrëveshjeve ndërmjet organizmave profesionale dhe jo profesionale (organizmave qeverisës). Shkolla manaxhohet si një qendër buxheti, që shqetësohet më shumë për efektshmërinë e përdorimit të burimeve, për aftësinë e tërheqjes së mbështetësve financiarë, për përdorimin e treguesve të arritjeve, për përgjegjshmërinë dhe veprimtaritë që lidhen me publikun. Koha që është llogaritur për përmbushjen e të gjithë ciklit të planit është realiste, për shembull, nga tre në pesë vjet.

Vetvlerësimi, mbikëqyrja edhe proceset e përgjegjshmërisë

Shkolla ka një skemë efektive të vetvlerësimit, që përfshin rishikimin horizontal, sesionet e reflektimit, raportet e përparimit të paraqitura te organet qeverisëse dhe aktorët e ndryshëm të saj. Manaxhimi i shkollës ofron një sistem të rregullt të raportimit të përparimit në dritën e kritereve dhe të treguesve të arritjeve. Ajo i kushton vëmendje sistematike përdorimit me efektshmëri të burimeve dhe merr informacion të vazhdueshëm për vlerën në proces, të objektivave, të detyrave, të përgjegjësive, të metodave të punës dhe të afateve. Udhëheqja e shkollës siguron përgjegjshmërinë ndaj nxënësve, prindërve, stafit arsimor, ekipit manaxhues edhe bashkësisë lokale.

Planifikimi i zhvillimit të EQD në shkollë

Ky kre është një tërësi instrumentash. Objektivi i tij është të ndihmojë shkollën në përgatitjen dhe realizimin e planifikimit të zhvillimit të EQD. Vëmendja e tij përqendrohet kryesisht në procesin e vlerësimit që qëndron në bazë të planifikimit, dhe ofron treguesit fillestarë për mënyrën e përdorimit të kuadrit të vlerësimit për EQD të përfshirë në kreun 5, për këtë qëllim. Ky kre:

- Ndjek hapat e vlerësimit dhe të planifikimit të zhvillimit;
- Ofron informacionin, udhëzimet dhe instrumentet bazë;
- Përmban shembuj nga shkollat dhe modele nga vende të ndryshme.

1. Hyrje

Ky kre shërben si pikënisje, hyrje dhe nxitje për zbatimin e planit të zhvillimit të EQD në shkollë.

Ai nuk përmban përgjigje të gatshme dhe nuk është as manual dhe as përfundimtar në përgjigjet që ofron. Ata që do të planifikojnë dhe do të zbatojnë vlerësimin e EQD, ftohen t'i hedhin një vështrim burimeve dhe udhëzimeve shtesë në vendin e tyre, ose në faqen e

internetit për sigurimin e cilësisë së EQD.¹⁴ Për të zhvilluar më tej dhe për ta përshtatur instrumentin e propozuar në kushteve të një shkolle të veçantë dhe përparësive të saj lidhur me EQD, është e nevojshme të zhvillohet punë paraprake. Kjo punë përgatitore është pjesë e fazës fillestare të procesit të vetvlerësimit. Përdoruesit me përvojë në fushën e vlerësimit, mund të shkojnë në seksionin 3, i cili tregon se si duhet të përdoret kuadrin i veçantë i vlerësimit të EQD.

¹⁴ www.see-educoop.net/portal/edsqa.htm

Tabela 2

Planifikimi i zhvillimit të EQD në shkollë në tetë hapa

Hapi 1: Zhillo një kulturë vlerësimi	Rrita e vetëdijes për përdorimin dhe rëndësinë e vlerësimit; vlerësimi i parë më shumë si të nxënë dhe zhvillim sesa si kontroll; fitimi i aftësive të vlerësimit
Hapi 2: Ngritja e ekipit të vlerësimit	Ngritja e ekipit në shkollë: përkatësia; diskuto se çfarë duhet vlerësuar dhe si; lehtësuesi
Hapi 3: Zhvillo pyetjet e duhura	Çfarë informacioni kërkojmë dhe ku do të gjejmë atë? Transformo treguesit e EQD në çështje të vlerësimit
Hapi 4: Vendos për metodën e vlerësimit	Përdor larmi metodash për të mbledhur lloje të ndryshme informacioni
Hapi 5: Mblidh dhe analizo të dhënat	Identifiko pikat e forta dhe të dobëta, duke përdorur shkallën me katër pikë. Shqyrto arsyet për prirjet e zgjedhura; referoju të dhënat të jashtme
Hapi 6: Nxirr përfundime	Reflekto dhe përcakto arsyet për arritje të veçanta në fushën e EQD; pikat kryesore që kërkojnë përmirësim
Hapi 7: Përgatit, shpërnda raportin e vlerësimit	Diskuto përfundimet e raportit të vlerësimit në bashkësinë e shkollës
Hapi 8: Përgatit strategjinë e zhvillimit	Vendos se çfarë dhe si duhet ta bësh; çfarë duhet ndryshuar dhe çfarë jo; arri marrëveshje për përparësitë dhe për përgjegjësitë e secilit, kohazgjatja, nevojat për trajnim dhe mbështetje, procesi i mbikëqyrjes

Sfidat e planifikimit të zhvillimit të EQD

Zhvillo një kulturë vlerësimi	Fillo nga gjërat e vogla, ji pragmatik, mëso duke bërë
Vlerësimi i EQD	Jo vetëm vlerësim i përmasave njohese pr edhe i ndryshimit të qëndrimit dhe sjelljes
Pjesëmarrja e nxënësve në vlerësim	Kjo lidhet me aftësitë e EQD; e drejta për t' shprehur, si pjesë e pjesëmarrjes së të gjithë aktorëve të shkollës (shumë sy mbi të njëjtën shkollë)
Metoda hap pas hapi	Në ciklin e parë të vlerësimit, fillo me identifikimin e nivelit. Plani i zhvillimit të shkollës ka vendosur objektiva realistë
Procesi	Si të realizojmë vlerësimin, si të përfshijmë aktorët, si të motivojmë ndryshimin, si të ngremë një ekip, si të formojmë ndienjën e përkatësisë; diskutime, marrëveshje, proces vendimmarrjeje

2. Udhëzime të përgjithshme për vetvlerësimin e shkollës

Objektivat e vetvlerësimit të shkollës

Si është theksuar në kërret e mëparshëm, vetvlerësimi i shkollës është hapi i parë në procesin e planifikimit të zhvillimit të shkollës, që përbën thelbin e sistemit të sigurimit të cilësisë në arsim.

Objektivi kryesor i vetvlerësimit është që shkolla të zbulojë se në çfarë shkalle po e përmbush misionin e saj, të shpallur në politikën arsimore në nivel kombëtar dhe lokal. Po kështu, objektivi kryesor i vetvlerësimit të EQD është që shkolla të përcaktojë se në çfarë shkalle EQD në shkollë është në përputhje me parimet e EQD të shpallura në kreun 2 si dhe në politikat kombëtare dhe lokale në këtë fushë.

Përcaktimi i gjendjes së EQD në një shkollë të veçantë mund të bëhet në dy forma: (a) duke vlerësuar gjëndjen përpara fillimit të procesit të planifikimit të zhvillimit (vetvlerësimi fillestar); dhe (b) duke vlerësuar gjendjen e zbatimit të një plani të zhvillimit të EQD (vetvlerësimi vijues). Vetvlerësimi vijues mund të realizohet në mënyra: (a) vetvlerësimi tërësor që synon të sigurojë një pamje të përgjithshme të zhvillimit në këtë fushë; (b) vetvlerësimi i fokusuar, që synon të sigurojë një informacion të hollësishëm në një fushë të veçantë të EQD që është në qendër të interesit të shkollës për atë periudhë (për shembull, manaxhimi i shkollës). Pra vetvlerësimi nuk duhet të vlerësohet si qëllim në vetvete por si pjesë përbërëse e rëndësishme e një procesi përmirësimi. Si vlerësim fillestar, ai është fillimi i një procesi të vazhdueshëm ndryshimi. Si vlerësim vijues ai shënon fillimin e çdo cikli të planifikimit të zhvillimit.

Procesi i vetvlerësimit: Si të fillojmë?

Vetvlerësimi i EQD, nga njëra anë, është një proces kompleks dhe me sfida të mëdha dhe nga ana tjetër është një proces që t'i shpërblen përpjekjet e bëra. Përgatitja e tij zgjat nga shtatë deri një vit

shkollor. Për shkollat që nuk kanë përvojë në fushën e vetvlerësimit ai është një sfidë e vërtetë që kërkon hapat dhe veprimtaritë e mëposhtme:
Rritjen e vetëdijes së të gjithë aktorëve të shkollës për nevojën e procesit të vetvlerësimit të EQD, si mjet për përmirësime në nivel personal, profesional dhe në nivel shkolle.;

Sigurimin që informimit të të gjithë aktorëve për kuadrin e vetvlerësimit në fushën e EQD dhe të qëllimeve të tij;

Përzgjedhjen e metodave më të përshatshme për vetvlerësimin, duke u këshilluar me ekspertë dhe aktorë të shumë në këtë fushë;

Përgatitjen e instrumenteve të besueshme dhe të vlefshëm për vlerësim me ndihmën (nëse kërkohet) e ekspertëve nga institutet e kërkimeve arsimore ose ato të trajnimit të mësuesve;

Përgatitjen e stafit shkollor dhe e aktorëve të tjerë për të kryer vlerësim, përfshirë këtu edhe trajnimet për përdorimin e instrumenteve të vlerësimit;

Krijimin e një klime besimi e reflektimi të ndershëm, përfshirjeje, përgjegjshmërie dhe përgjegjësie për rezultate.

Njohja dhe zvogëlimi i elementëve kërcënues të vlerësimit, të kuptuarit e sfidës së vetvlerësimit si një proces të nxëni, zhvillimi i njohurive dhe i aftësive të nevojshme për vlerësim, rritja e angazhimit të të gjithë shkollës në këtë proces janë disa nga pikat kryesore e një procesi të krijimit të një kulture të re të vetvlerësimit.

Hapi i parë për të përballuar këto sfida, mund të jetë ai i realizimit të projekteve të vogla të vlerësimit, si një projekt pilot në klasë ose në shkollës në fushën e EQD ose për aspekte tjera të jetës shkollore.

Në kuadrin e zbatimit të lëndës së ekonomisë, “Nxënësit e klasës së nëntë, bënë një kërkim me temë: “Opinionit i nxënësve të klasës së nëntë për shkollën ku ata mësojnë” Nxënësit u drejtuan nga mësuesi i tyre. Nga data 5 deri në 15 maj të vitit 2002, u intervistuan 168 nxënës të klasës së nëntë, nga 176 nxënës që janë gjithsej në këtë vit shkollor në këtë shkollë.

Mihail Sebastian, Shkolla e mesme, Braila, Rumani¹⁵

¹⁵ Në I-Probe Net, Komenius 3, rrjeti për vetvlerësimin e projekterve dhe të të nxënët në bazë projekti në shkollë: www.i-probenet.net

Shkolla, duke u mbështetur në përvojën e fituar mund të fillojë një proces të përgjithshëm vetvlerësimi. Vetvlerësimi fillestar duhet të përfshijë të gjitha aspektet e rëndësishme të EQD, në përputhje me strukturën e vlerësimit të paraqitur në Kreun 5. Qëllimi i vlerësimit fillestar është të sigurojë në pamje të përgjithshme të EQD. Për këtë, ai duhet të shtrihet në atë shkallë që të përfshijë të gjithë treguesit e EQD. Në këtë nivel, informacioni i fituar do të jetë sipërfaqësor nga pikëpamja e hollësive.

Një analizë e thellë mund të realizohet vetëm përmes vlerësimit vijues i cili prek aspektet e EQD në mënyrë tërësore ose duke u përqendruar në çështjet parësore. Mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre duhet të bëhen më në thellësi, gjë që do të japë mundësinë të kuptohen më mirë pikat e forta dhe të dobëta që identifikohen gjatë vlerësimit.

Me kalimin e viteve, fusha dhe çështjet e vlerësimit do të bëhen për çështje më parësore dhe më të hollësishme. Megjithatë, duhet të vërejmë se një vetvlerësim më i hollësishëm shpesh herë kërkon përgatitje dhe përvojë më të madhe si në përgatitjen dhe zbatimin e instrumenteve të vlerësimit, ashtu edhe në interpretimin e të dhënave.

Zhvillimi i aftësive të vetvlerësimit, është një proces gradual, dhe në disa vende edhe disi i vështirë për t'u arritur. Megjithatë, mungesa e përgatitjes dhe e përvojës, nuk duhet t'i pengojë shkollat nga fillimi i procesit të vetvlerësimit. Regulla e artë për shkollat e reja në këtë proces është që kompleksiteti i vlerësimit duhet të përcaktohet nga shkalla e aftësive që ato zotërojnë.

Procesi i vetvlerësimit: kush përfshihet në të?

Ekipi i vetvlerësimit

Cilësia e vetvlerësimit të EQD varet nga organizimi i mirë i tij. I gjithë procesi duhet t'i besohet ose drejtuesit të shkollës, ose një personi tjetër të caktuar posaçërisht dhe me detyra të qarta për këtë qëllim. Procesi kërkon bashkërendim dhe rolin e një lehtësuesi sesa atë të udhëheqjes nga lart-poshtë. Në përputhje me parimet e EQD, në këtë proces duhet të përdoret metoda e pjesëmarrjes dhe e bashkëpunimit. Shumë nga detyrat e listuara më lart mund t'i besohen një grupi të zgjedhur që

përfaqësojnë aktorët e shkollës, të cilët mund të funksionojnë si një ekip përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e vlerësimit, gjatë gjithë procesit të vetvlerësimit.

Ekipi mund të përbëhet nga shtatë deri nëntë persona. Përbërja e tij mund të ndryshojë nga vendi në vend, në varësi të pranisë së funksioneve të ndryshme. Në të mund të marrin pjesë drejtori, një ose dy përfaqësues të mësuesve, një ose dy përfaqësues të nxënësve, këshilltari i shkollës (në disa vende ky është psikologu i shkollës), një prind, një përfaqësues i bashkësisë (p.sh. OJQ) dhe një përfaqësues i instituteve kërkimore ose i qendrave të trajnimit të mësuesve. Nëse shkolla ka një koordinator të EQD (ose një grup koordinues për EQD), ai duhet të përfshihet në ekipin e vlerësimit. Ajo që ka rëndësi është jo vetëm përfaqësimi në këtë proces dhe i të gjithë aktorëve të shkollës, por edhe që ky ekip të ketë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ndërmarrë një vetvlerësim.

Detyrat e një ekipi të tillë, me njohuritë dhe aftësitë e duhura për vetvlerësimin në përgjithësi dhe për atë të EQD në mënyrë të veçantë, janë si më poshtë:

- ◆ Përgatitja e instrumentit të vlerësimit;
- ◆ Trajnimi i stafit me teknikat e vlerësimit dhe për përdorimin e instrumenteve të vlerësimit në fushën e EQD;
- ◆ Sigurimi i informacionit dhe i këshillimit për vlerësuesit dhe aktorët e shkollës gjatë gjithë procesit të vetvlerësimit;
- ◆ Monitorimi i zbatimit të instrumentit të vlerësimit;
- ◆ Analiza dhe interpretimi i gjetjeve, në bashkëpunim dhe duke u këshilluar me një grup të gjërë aktorësh dhe ekspertë të jashtëm;
- ◆ Përgatitja e formave të ndryshme të raporteve për grupe të ndryshme aktorësh;
- ◆ Marrja dhe analiza e komenteve dhe sugjerimeve të aktorëve pas rishikimit prej këtyre të fundit të raporteve të vlerësimit.

Numri dhe natyra e detyrave të tilla varen edhe nga prania e udhëzimeve kombëtare për vetvlerësimin në përgjithësi dhe për EQD në mënyrë të veçantë. Në vendet ku këto udhëzime mungojnë, shkolla zhvillon metodën e saj të vetvlerësimit, duke u mbështetur në aftësitë që ajo zotëron. Në këto rrethana, do të ishte ndihmesë e madhe nëse shkolla do të bënte pjesë në rrjete kombëtare ose ndërkombëtare shkollash që punojnë për të njëjtin qëllim.¹⁶ Këto rrjete ofrojnë materiale dhe burime, mundësi për shkëmbim përvoja, veçanërisht kur shfaqen probleme për t'u zgjidhur, dhe për të grumbulluar përvojë në këtë fushë. Kjo mund të çojë në formulimin e politikave për vetvlerësimin e EQD në nivel kombëtar ose lokal.

Përfshirja e nxënësve dhe e aktorëve të tjerë

Vlerësimi i EQD kërkon përfshirjen e aktorëve në procesin e vlerësimit. Mendimi i aktorëve të ndryshëm (nxënës, prindër, mësues), në parim, duhet të kërkohet dhe të krahasohet. Kjo mund të arrihet, për shembull, përmes pyetësorëve paralelë dhe të ngjashëm.

Mbledhja e pikëpamjeve të nxënësve është një aspekt i rëndësishëm i procesit të përmirësimit të shkollës.

A mundet që mendimi i nxënësve të sjellë një ndryshim? Përgjigja jonë, por edhe ajo e shumë mësuesve që kanë punuar me ta është një “po” e fortë. Komentet e nxënësve për mësimdhënien dhe të nxënësve të shkollës ofron një program praktik për ndryshime që mund të ndihmojnë në përmirësimin e tyre, ose në identifikimin dhe modelimin e përmirësimit të strategjive të mësimdhënies. Idetë që vijnë nga bota e nxënësve mund të na ndihmojnë të shohim gjëra që zakonisht kalojnë pa tërhequr vëmendjen tonë, por që u interesojnë atyre.¹⁷

¹⁶Shih pwr shembull I-Probe Net, Comenius 3, rrjeti për vetvlerësimin e projekteve dhe të të nxënësve në bazë projekti në shkollë: www.i-probenet.net; Treasure Within, Comenius 3 rrjeti pwr vlerësimin e cilësisë në arsim: www.treasurewithin.com

¹⁷ Jean Rudduck dhe Julia Flutter, Si të përmirësoni shkollën tuaj – duke iu dhënë nxënësve një zë. Continnum 2004

Nxënësve nuk u kërkohet të vlerësojnë mësuesit. Meqë një vlerësim i tillë kërkohet për herë të parë, mësuesve u kërkohet që të zgjedhin dy klasa për ta vlerësuar atë. Kjo bëhet që mësuesit të kenë një ide për mendimit që nxënësit kanë për metodat e tij të mësimdhënies, për pikat e forta dhe të dobëta. Nga pikëpamja e manaxhimit, kjo do të ndihmonte në përcaktimin e nevojave të trajnimit të mësuesve. Në këtë vit, një mësues mund të vendosë nëse do të paraqesë këtë raport në intervistën e tij të përvitshme me drejtuesit e departamenteve.

Stedelijk Dalton Lyceum, Dordrecht¹⁸

Mbledhja e pikëpamjeve të nxënësve lidhet ngushtë me fitimin e aftësive dhe kompetencave të EQD të tilla si vet-reflektimi, mendimi kritik, përgjegjësia për përmirësime dhe ndryshim. Në të njëjtën kohë ajo përmbush të drejtën e nxënësve për të shprehur pikëpamjet e tyre për çështjet që u interesojnë dhe u siguron atyre një rol si pjesëtarë aktivë në bashkësinë shkollore. Së fundi, ajo ndihmon në vendosjen e marrëdhënieve më të drejta ndërmjet mësuesve dhe nxënësve. Kështu për shembull, Autoriteti për Kurrikulën dhe Kualifikimin në Britaninë e Madhe (Anglisht- QCA) në raportin e saj vjetor për edukimin qytetar, përfshiu një studim që përmbante pikëpamjet e nxënësve rreth rrugëve për t'u këshilluar me të rinjtë, si pjesë e një studimi më të gjërë lidhur me pikëpamjet e nxënësve për kurrikulën.¹⁹

Mbledhja e pikëpamjeve të nxënësve mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Studimi i QCA shqyrton “vlefshmërinë e mjeteve të ndryshme që synojnë të nxisin pikëpamjet e vërteta të nxënësve”, të tilla si intervistat e kryera nga të rriturit, intervistat e kryera nga nxënësit, përdorimi i kasetave ose i minidisqeve, intervistat individuale ose në grup, rëndësia e vendit për intervistat, përdorimi i pyetësorëve, pyetësorët online.²⁰ Për shembull, pyetësori i mëposhtëm është një pjesë e shkëputur nga materialet e përgatitura për vetvlerësimin e

¹⁸ Në I-Probe Net, Comenius 3, rrjeti për vetvlerësimin e projekteve dhe të të nxënësve në bazë projekti në shkollë: www.i-probenet.net;

¹⁹ Qytetaria, 2002/3 (raporti vjetor për kurrikulën dhe vlerësimin): www.qca.org

²⁰ Po aty, faqe 18

shkollës në Slloveni.²¹ Një burim tjetër është pyetëtori i realizuar online “Për të matur temperaturën e të drejtave të njeriut në shkollë”²² Pavarësisht se cila është metoda që përdoret, është e rëndësishme të mbahet parasysh rreziku me të cilin përballen nxënësit, kur atyre u kërkohet të shoqërojnë opinionin e shprehur me emrin e tyre. Shembulli i Belgjikës dëshmon për një rrezik të tillë, veçanërisht kur vetë mësuesi përfshihet aktivisht në këtë proces.

A është i vërtetë pohimi për klasën tuaj?	Jam plotësisht dakord	Jam dakord	Jam kundër	Jam krejtësisht kundër
Klasa ime gjithnjë e ndien veten si një grup				
Klasa ime përbëhet nga grupe nxënësish që nuk e kuptojnë mirë njëri-tjerin				
Klasa ime është e dhunshme				
Më pëlqen klasa ime sepse ndihem mirë në të				
Pë pëlqen klasa ime sepse nxënësit më duan				
Unë do të pëlqoja të isha në një klasë tjetër				

- Nw shkollwn e De Toverboom fwmijwt e klasws sw gjashtw, marrin njw raport tw shkruar nga mësuesi i tyre, katër herë në vit.
- Po mësuesi pse nuk merr ndonjë raport? Kështu, mësuesi Jan, merr dy herë në vit nga një raport të shkruar nga nxënësit e tij. Në këtë mënyrë ata mund të mësohen më mirë se si mund të trajtojnë çështjen e gjykimit dhe të të qënuarit të gjykuar.
- Në shtator, mësuesi u kërkon nxënësve të mendojnë për sjelljen e mësuesit të tyre. Në nëntor, nxënësit shkruajnë raportin e tyre të parë për mësuesin Jan. Ai diskuton me ta për disa nga aspektet e paqarta dhe mban parasysh vërejtjet dhe propozimet e tyre.
- Raporti i dytë për nxënësit dhe mësuesit shkruhet përpara muajit prill. Në këtë kohë, mësuesi ende mund të marrë parasysh komentet e nxënësve të tij, për të përmirësuar pikat e tij të forta dhe për të korrigjuar ato të dobëtat.
- Nxënësit përdorin piktura, shënime, grafike tekste etj., për të gjykuar mësuesin e tyre.

²¹ Broshura “Vlerwsimi i cilwsw dhe sigurimi i cilwsw nw arsim”, Slloveni, <http://kakovost.ric.si> (pwrkthim i lirw)

²² Shih: www.hrusa.org/hrmaterials/temperature/echrem.shtm

-
- Raportet ofrojnë mundësinë e vlerësimeve për qëndrimet dhe sjelljet. Ai u jep nxënësve më shumë siguri dhe i bën marëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe mësuesve më të drejta dhe të ndërsjella.

Shkolla De Toverboom – Shkolla Pema Magjike, Belgjikë²³

Etika e vlerësimit

Vlerësimi drejtohet nga disa parime të përgjithshme etike. Ndër to përmendim:

- ◆ Karakterin kontekstual, gjithanshmëria, dhe ndieshmëria në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit;
- ◆ Respektin për integritetin dhe dinjitetin e çdo personi që përfshihet në të;
- ◆ Mosdiskriminimin dhe respektin për privatësinë, veçanërisht vlerësimi lidhet më shumë me aspektet personale të jetës shkollore;
- ◆ Fshehtësinë dhe angazhimin për të ndryshuar në interes të të gjithëve;
- ◆ Të kuptuarit e të dhënave në mënyrë që gjykimi dhe interpretimi personal të verifikohen me kujdes për të shmangur përgjithësimet e tepëruara dhe përfundimet e njëanshme.

Këto parime, lidhen në mënyrë të veçantë me vetvlerësimin e EQD, që ka si objektiv jo vetëm njohuritë, por edhe vlerat, aftësitë dhe qëndrimet.

3. Përdorimi i treguesve të cilësisë së EQD

Struktura e vlerësimit e përcaktuar në Kreun 5 është planifikuar si pikënisje për vlerësimin e EQD. Treguesit e cilësisë së EQD dhe përshkrimi i tyre, nuk kanë qëllim që përdoren drejtpërdrejtë në vetvlerësimin e shkollës. Ata duhet të përshtaten në varësi të përparësive dhe politikës së shkollës në fushën e EQD, në nivel lokal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar, si dhe të kushteve të veçanta të

²³ Në I-Probe Net, Comenius 3, rrjeti për vetvlerësimin e projekteve dhe të të nxënësve bazë projekti në shkollë: www.i-probenet.net;

shkollës. Plani i hollësishëm i vlerësimit duhet të vendosë barazpeshën ndërmjet përparësive të përgjithshme dhe objektivave të të nxënit në shkollë, të përcaktuara në diskutimet dhe konsultimet ndërmjet mësuesve, nxënësve, prindërve dhe aktorëve të tjerë të shkollës.

Parimet të përgjithshme për vlerësimin e EQD

EQD është një koncept dinamik, gjithëpërfshirës dhe i drejtuar nga e ardhmja. Ai zhvillon idenë e shkollës si një bashkësi të nxëni dhe të mësuarit për jetën në demokraci, gjë që shkon përtej lëndëve të veçanta që mësohen në shkollë, mësimdhënies në klasë ose marrëdhëniet tradicionale mësues-nxënës. Megjithatë ai ka të bëjë me metoda të reja të fitimit të njohurive dhe të aftësive, shqetësimi i tij kryesor është ndryshimi i vlerave, i qëndrimeve dhe i sjelljeve.

Këto karakteristika të EQD duhet të mbahen parasysh gjatë gjithë procesit të vetvlerësimit. Edukimi i vlerave dhe i qëndrimeve ndryshon nga fitimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive njohëse. Ndërsa objektivi i parë ka të bëjë me të kuptuarit dhe të mbajturit mend të informacionit, i dyti ka të bëjë me nxitjen e angazhimit dhe të veprimit. Për rrjedhojë, vetvlerësimi i shkollës në fushën e vlerave dhe të ndryshimit të qëndrimeve në të gjitha fushat e EQD, duhet kryesisht të përqendrohet në proceset e të nxënit si dhe në përvojat, interpretimet subjektive dhe në modelet e sjelljes së aktorëve të saj. Ai duhet të ketë si objektiv të hapur ose të nënkuptuar kuptimin e ngjarjeve të shkollës, të shprehura ose të nënkuptuara ose vlerat dhe qëndrimet e fshehura, sjelljen e shprehur qartë dhe atë të nënkuptuar si të individëve ashtu edhe të grupeve. Mënyra më e thjeshtë për të matur ndryshimin e vlerave në fushën e EQD është të lejosh njerëzit të flasnin, të bëjnë komente e të diskutojnë për çdo çështje të veçantë të EQD.

Si rrjedhojë, si çdo vlerësim i mirë, edhe vlerësimi i EQD përfshin si aspektin sasior ashtu dhe atë cilësor të të dhënave dhe të metodave. Megjithatë, në këtë proces, ka të ngjarë që aspekti i cilësisë të sundojë.

Zhvillimi i pyetjeve të duhura

Me qëllim që të përdoren si duhet, treguesit e EQD dhe përshkrimi i tyre, duhet të kthehen në pyetje për mbledhjen e të dhënave. Pikënisja e një vlerësimi është qartësimi i informacionit që duhet të sigurohet.

Kur planifikohet procesi i vlerësimit dhe përcaktohen përbërësit e tij – përmbajtja vlerësimit, tipi i të dhënave, burimet e informacionit dhe metodat e vlerësimit – mund të përdoret struktura si pikë referimi për t’iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- ◆ Cili është informacioni dhe të dhënitë që po kërkojmë (p.sh. organizimi i shkollës, vlerat sunduese në klasë, kuptimi i koncepteve themelore, marrëdhëniet e autoritetit etj.)?
- ◆ Me cilin mjedis të nxënit të EQD ka të bëjë treguesi ose përshkruesi konkret dhe ku duhet kërkuar për të?
- ◆ Cili dokument e përmban informacionin e nevojshëm (p.sh. dokumenti i politikës së shkollës, kurrikula shkollore, statuti i shkollës, karta e nxënësve, kodi i etikës së mësuesve etj.)?
- ◆ Cilët janë personat ose grupet e aktorëve që mund të na sigurojnë informacionin e nevojshëm (p.sh. nxënësit, mësuesit, prindërit, administrata lokale, OJQ etj.)?
- ◆ Si do të mblidhen të dhënat (p.sh. me pyetësorë, me diskutime të grupeve të interesuara, me intervista individuale, me vëzhgime etj.)?

Në vijim, treguesit dhe përshkruerit duhet të kthehen në pyetje të përshtatshme për shqyrtim. Tabela 3 ofron shembuj të pyetjeve²⁴ të tilla të bazuara në treguesit e EQD

²⁴ Pyetjet janë marrë nga një dokument burimor i përgatitur nga Irlanda e Veriut, në kuadrin e një inspektimi të bërë për gjëndjen e edukimit qytetar në shkollë.

Tabela 3

Treguesi	Çështja	Shembuj pyetjesh
Treguesi 1 A ka dëshmi se EQD zë vendin e duhur në synimet, politikat dhe kurrikulën e shkollës?	Politikat e shkollës në fushën e EQD	A ekziston ndonjë dokument e veçantë i politikave të shkollës për EQD? A është ai i shoqëruar me masa konkrete për zbatim?
	EQD dhe kurrikula e shkollës	Cili është vendi që zë EQD në planin mësimor? A është i mjaftueshëm?
Treguesi 2 A ka dëshmi të shkallës së të kuptuarit të EQD nga nxënësit dhe të zbatimit të parimeve të EQD në praktikën e përditshme në shkollë dhe në klasë?	Rezultatet e të nxënit	<ul style="list-style-type: none"> • A po rritet besimi i nxënësve në cilësitë e tyre personale, a po reflektojnë ata për përvojat e tyre dhe a po rritet ndjenja e vetvlerësimit? • A po mësojnë nxënësit të jenë të durueshëm dhe tolerantë në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin? • A i respektojnë nxënësit ndryshimet me bashkëmoshatarët e tyre dhe me anëtarët e tjerë të bashkësisë? • A kanë fëmijët përvoja të gjëra që do t'i ndihmojnë të marrin vendime dhe veprime praktike të mënçura?
	Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit	A përfitojnë mësuesit nga: <ul style="list-style-type: none"> • Ngjarjet dhe nismat lokale? • Pikat e interesit për nxënësit e tyre, p.sh. ngjarje që prekin jetën e individëve dhe të bashkësisë? • Lajmet dhe çështjet aktuale?
Treguesi 4 A i pasqyron kultura e shkollës si duhet parimet e EQD?	Zbatimi i parimeve të EQD në jetën e përditshme të shkollës	Cili është toni dhe stili i lajmërimeve?
Treguesi 5 A ka dëshmi të një udhëheqje të efektshme të shkollës, të bazuar në parimet e EQD?	Përgjegjësi e përbashkët, bashkëpunim dhe punë në ekip	Kush është i përfshirë në hartimin e politikës së shkollës në përgjithësi dhe në fushën e EDD në mënyrë të veçantë?

Pyetjet në Tabëlën 4 mund të jenë të vlefshme në bisedat me nxënëit²⁵

Tabela 4

Treguesi	Çështja	Shembuj pyetjesh
Treguesi 2 A ka dëshmi të shkallës së të kuptuarit të EQD nga nxënësit dhe të zbatimit të parimeve të EQD në praktikën e përditshme në shkollë dhe në klasë?	Rezultatet e të nxënit të EQD Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit	Cilat janë gjërat që keni mësuar rreth qytetarisë që e vlerësoni interesante dhe të vlefshme në jetën tuaj të përditshme? A ka ndonjë gjë, nga ato që keni mësuar, që ju duket e pavlerë? Në ç' mënyrë mësuesi i thekson çështjet e qytetarisë në lëndë të tjera? A ka kuptim dhe rëndësi për ju puna që bëni në lëndën e qytetarisë dhe në lëndë të tjera? A ka lidhje me përmbajtjen e lëndës? A mund të përdorni aftësitë e fituara në një lëndë edhe në lëndë të tjera? Cilat janë mundësitë që ju ofrohen për të marrë pjesë në diskutime dhe në veprimtaritë e qytetarisë? A ju është dhënë ndonjë përgjegjësi ose rol i veçantë në veprimtaritë e ndërmarra në fushën e qytetarisë? A keni patur mundësi të punoni me të tjerët? Cilat kanë qenë mundësitë për të diskutuar për çështje kontradiktore? A mësoni rreth kulturave të ndryshme që përfaqësohen në shkollën, në bashkësi ose në vendin tuaj? A keni mundësi të diskutoni dhe të sfidoni stereotipat, p.sh, lidhur me gjininë dhe etnitë? Cilat janë burimet e informacionit që përdorni në mësimet e qytetarisë? Në cilat veprimtari të bashkësisë keni marrë pjesë ndonjëherë? Përse janë zhvilluar këto veprimtari dhe cilat janë arritjet e tyre?
Treguesi 4 A i pasqyron kultura e shkollës si duhet parimet e EQD?	Mbikëqyrja e EQD Mundësitë për pjesëmarrje dhe vetshprehje	Si e identifikoni përparimin e bërë në fushën e qytetarisë? Si vlerësohet puna juaj? A keni patur ndonjë mundësi për të marrë pjesë në vendimarrje? Si e vlerësoni që pikapamjet tuaja janë dëgjuar? A ka ndonjë këshill shkollë në të cilin ju mund të jepni ndihmesën tuaj? Si vepron ai?

²⁵ Pyetjet janë marrë nga Inspektimi i qytetarisë, me udhëzues pwr vetvlerësimin, Mbretëria e Bashkuar, OFSTED, 2002

Të hartosh pyetjet për të hulumtuar në fushën e EQD, nuk do të thotë të përgatitësh dhe të plotësosh një pyetësor. Pyetjet të ndihmojnë të përqendrohesh në atë që kërkon. Ato duhet të përgatiten me kujdes dhe duhet të jenë të qarta. Për këtë arsye, do të ishte mirë që ato të vlerësoheshin edhe nga të tjerë, që të bëhen të kuptueshme për të gjithë.

Pasi të përgatiten, pyetjet shërbejnë si bazë për të vendosur për instrumentet e vetvlerësimit.

Përcaktimi i metodave

Për mbledhjen e të dhënave mund të përdoren metoda të ndryshme. Më kryesoret prej tyre janë pyetësorët, intervistat, grupet e përzgjedhura, vëshgimet dhe analiza e dokumenteve. Metoda të tjera krijuese janë portofolet, ditaret, vlerësimi i fotografive, rrëfimi i ngjarjeve. Përshkrimi i shkurtër i këtyre metodave gjendet në Shtojcën 2.²⁶

Në kuadrin e vlerësimit të EQD në shkollë, të përshkruara në Kreu 5, çështjet ndryshojnë nga gjërësia dhe tërësia e asaj që pëfshijnë. Disa prej tyre janë fakte (p.sh. ekzistenca e një politike për EQD në shkollë; integrimi i EQD në kurrikulën e shkollës etj.), të tjera bazohen më shunë në sistemin e vlerave dhe kanë të bëjnë me qëndrimet (p.sh. angazhimi ndaj parimeve të EQD, shprehja e lirë e mendimeve të nxënësve etj.) dhe disa të tjerë kanë të bëjnë me procedurat dhe proceset (p.sh. trajtimi i barabartë dhe me dinjitet i të gjithë nxënësve, përfshirja e nxënësve në procesin e vlerësimit, zgjidhja paqësore e konflikteve etj.)

Që të kuptojë vendin dhe rolin e saj në kuadrin e këtyre tri përmasave, shkolla duhet të bëjë sa më të larmishëm mbledhjen dhe harmonizimin e të dhënave që mbledh. Vlerësimi i këtyre përmasave kërkon përdorimin e shumë instrumenteve. Zgjedhja e tyre varet kryesisht nga lloji i informacionit që kërkohet. Megjithatë grupi që është objekt i hulumtimit, nuk duhet lënë jashtë ketij procesi; edhe ai duhet të merret parasysh kur të zgjidhet metoda e duhur.

²⁶ Shih edhe “Një udhezues praktik për vetvlersimin, të përgatitur nga John , McBeath, Denis Meuret, Michael Schratz: http://europa.eu.int/comm/education/archive/poledu/pracgui/practi_en.html

Për shembull, vlerësimi politikës së shkollës për EQD (treguesi 1) mbulon disa çështje (që lidhen me faktet dhe qëndrime) të ndërlidhura me njëra-tjetrën:

- ◆ Ekzistenca e një politike të shkollës në fushën e EQD mund të pranohet duke u mbështetur në analizën e dokumenteve të saj, pavarësisht nga fakti që ka ose jo një politikë të shpallur në këtë drejtim.
- ◆ Vlerësimi i cilësisë së saj kërkon një lloj të ri shqyrtimi. Ai mbështetet në disa kritere të vendosur përpara se të fillojë vlerësimi. Në fushën e EQD, një politikë e shkollës e shprehur qartë, do të thotë që parimet e EQD të jenë pjesë përbërëse e të gjithë jetës së shkollës (kurrikulës, mësimdhënies, të nxënit, klimës dhe kulturës së shkollës, manaxhimit dhe zhvillimit). Nëse pranohet ky kriter, atëherë, për të vlerësuar cilësinë e politikës, mjafton të harmonizosh analizën e dokumenteve me listën e parimeve të EQD.
- ◆ Një çështje tjetër është vlerësimi i shkollës në të cilën kuptohet politika e shkollës në fushën e EQD nga të gjithë aktorët e saj. Ky vlerësim mund të realizohet me anë të përdorimit të disa instrumenteve standard të vlerësimit të njohurive (p.sh. testet), të instrumenteve të vlerësimit përshkrues, si intervista ose me anë të përdorimit të shkollës së vetvlerësimit.

Tabela 5 ofron shembuj për tre tregues të metodave të mundshme për t'u përdorur, në përputhje me llojin e çështjeve të trajtuara.

Tabela 6 përmban një pamje të përgjithshme të përdorimit të metodave dhe instrumenteve të ndryshme për treguesin e cilësisë të paraqitur në Kreun 5

Së fundi, procesi i mbledhjes së të dhënave duhet të bazohet në parimin e famshëm që thotë “Bëje këtë proces sa më të thjeshtë që të jetë e mundur”. Përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve duhet të bëhet në përputhje me kapacitetet ekzistuese në fushën e aftësive të vlerësimit, e mundësive për zhvillimin profesional, e përvojës, e burimeve të vlefshme dhe të kohës.

Tabela 5

Tregues	Lloji i pyetjes	Metodat e mundshme
Treguesi 1: Vendi i duhur i EQD në synimet, politikat dhe kurrikulën e shkollës	A ekzistojnë politika të EQD në shkollë?	Listë dokumentesh Analizë dokumentesh
	Cila është cilësia e politikës së EQD në shkollë?	Analizë dokumentesh, krahasime me listën e parimeve të EQD
Çështja: politika e shkollës në EQD	A janë aktorët e shkollës në dijeni të politikës së EQD në shkollë dhe a e kuptojnë atë?	Pyetësorë me shkallë vetvlerësimi. Intervista
Treguesi 2: Të kuptuarit e parimeve të EQD, njohja dhe zbatimi i parimeve të EQD në praktikën e përditëshme të shkollë dhe të klasës	Cili është procesi i mësimdhënies së EQD? Ç' plane dhe veprimtari mësimore ekzistojnë?	Listë dokumentesh, Analizë dokumentesh Portofoli i mësuesit Vlerësim fotosh
	Çështja: metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënit	A bazohet mësimdhënia në parimet e EQD?
Treguesi 5: Udhëheqje efektive të bazuar në parimet e EQD	Si merren vendimet në shkollë? Cilët janë aktorët që përfshihen në vendimmarrje?	Analizë dokumentesh Pyetësorë
	Çështja: Vendimmarrja	A bazohet vendimmarrja në parimet e EQD?

Tabela 6

Fushat	Treguesi i cilësisë	Çështja	Instrumenti i vlerësimit
Kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënit	Treguesi 1 A ka dëshmi se EQD zë vendin e duhur në synimet, politikat dhe kurrikulën e shkollës?	<ul style="list-style-type: none"> • Politikat e shkollës në fushën e EQD • Planifikimi i zhvillimit të shkollës në EQD • EQD dhe kurrikula e shkollës • Koordinimi i EQD 	Analizë dokumentesh Vëzhgime Intervista me grupe të caktuara
		Treguesi 2	<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e të nxënit

	A ka dëshmi të shkallës së të kuptuarit të EQD nga nxënësit dhe të zbatimit të parimeve të EQD në praktikën e përditshme në shkollë dhe në klasë?	<ul style="list-style-type: none"> në EQD Metoda dhe procese të mësimdhënies dhe të nxënimit Monitorimi i EQD 	Analizë dokumentesh Intervista Portofole Ditare Grupe në fokus
	Treguesi 3 A është planifikimi dhe praktika e vlerësimit në shkollë në përputhje me parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Transparenca Drejtimi Përmirësim 	Vëzhgim Intervista me grupe në fokus Pyetësorë Analizë dokumentesh
Kultura dhe klima e shkollës	Treguesi 4 A i pasqyron kultura e shkollës si duhet parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i parimeve të EQD në jetën e përditshme Mundësi për pjesëmarrje vetshprehje dhe Procedura për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e dhunës dhe diskriminimit Marrëdhënie dhe modele të autoritetit 	Vëzhgime Pyetësorë Diskutime me grupe në fokus Intervista Rrëfim ngjarjesh Analizë Intervista dokumentesh Vlerësim fotosh
Manaxhimi dhe zhvillimi	Treguesi 5 A ka dëshmi të një udhëheqje të efektshme të shkollës, të bazuar në parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Stili i udhëheqjes Vendimmarrja Ndarja e përgjegjësi, bashkëpunimi dhe puna në grup Përgjegjëshmëria 	Vëzhgime Pyetësorë Shkallë vlerësimi Diskutime me grupe në fokus
	Treguesi 6 A ka shkolla një plan të arsyeshëm që pasqyron parimet e EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje dhe përfshirje Zhvillim profesional dhe organizativ Manaxhim burimesh Vetvlerësim, mbikëqyrje dhe përgjegjshmëri 	Analizë dokumentesh Pyetësorë Vëzhgime Shkallë vlerësimi Intervistë

4. Analiza, përfundime dhe raportimi

Të dhënat, për mbledhjes së tyre duhet të përpunohen. Analiza dhe interpretimi i të dhënave varet nga objektivat dhe fusha e vlerësimit të EQD. Sa më i thellë të jetë vlerësimi, aq më shumë lind nevoja për të dhëna të detajuara, gjë që do të shoqërohet me rritjen e kompleksitetit të përpunimit të të dhënave dhe të analizës së tyre. Në këto kushte, për shkollën mund të jetë me vlerë pajtimi i një eksperti nga institucione kërkimore ose fakultete edukimi për ta ndihmuar atë në zhvillimin e vetvlerësimit të EQD.

Të dhënat e mbledhura, për shembull, përmes pyetësorëve, vëzhgimeve, intervistave etj., duhet të organizohen dhe të grupohen në përputhje me objektivat dhe çështjet e vlerësimit. Analiza do të kërkojë identifikimin e modeleve, të shoqërimeve, të lidhjeve shkakësore; interpretimi do të kërkojë vendosjen e informacionit në kuadrin e një këndvështrimi të caktuar.

Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta

Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të shkollës në fushën e EQD, përbën një ndër aspektet më të rëndësishme të analizës dhe të interpretimit të të dhënave në këndvështrimin e planifikimit të zhvillimit. Ky identifikim ofron bazat për vendosjen e përparësive të një strategjie përmirësimi.

Në këtë instrument, propozohet që arritjet e një shkolle në fushën e EQD, duhet të maten me një shkallë me katër nivele. Gjykimi i përgjithshëm i çdo treguesi, duhet të bëhet në bazë të mbledhjes së të dhënave të duhura në përputhje me katër nivelet e mëposhtme:

- ◆ **Niveli 1** – pikat e dobëta më të rëndësishme që ndodhen pothuajse ose në të gjitha fushat;
- ◆ **Niveli 2** – më shumë pika të dobëta se të forta;
- ◆ **Niveli 3** – më shumë pik atë forta se të dobëta;
- ◆ **Niveli 4** – pika të forta pothuajse ose në të gjitha fushat dhe pika të bobëta të parëndësishme.

Tabela 7, përshkruan katër nivelet e arritjes për treguesin 1 dhe ofron një shembull për zhvillimin e shkallës prej katër nivelesh të EQD

Tabela 7

Treguesi 1: dëshmi për një vend të përshtatshëm të EQD në qëllimet, politikat dhe kurrikulën e shkollës	
Niveli 1	Shkolla nuk ka një politikë të shpallur për zhvillimin e EQD. EQD nuk lidhet me asnjë nga fushat e jetës shkollore. Personeli dhe nxënësit e shkollës nuk janë në dijeni të EQD
Niveli 2	Shkolla ka një politikë të shpallur për zhvillimin e EQD. Megjithatë, si ajo ashtu edhe përparësitë e saj nuk janë të shprehura qartë. Përvbeç kësaj, politika nuk është e shoqëruar me një plan veprimi gjë që pengon ndikimin e EQD në praktikën e shkollës.
Niveli 3	Shkolla ka një politikë për zhvillimin e EQD, të shprehur qartë dhe në përputhje me të gjitha përparësitë e përcaktuara në nivel shkolle, në nivel lokal dhe kombëtar. Politika shpall qartë parimin e integritetit të EQD në të gjitha aspektet e jetës shkollore (në kurrikul, në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies; në klimën e shkollës, në manaxhimin dhe zhvillimin e shkollës). Megjithatë, ajo nuk shoqërohet me një plan të qartë veprimi, gjë që shkakton hendeqe në fushën e zbatimit.
Niveli 4	Shkolla ka një politikë për zhvillimin e EQD, të shprehur qartë dhe në përputhje me të gjitha përparësitë e përcaktuara në nivel shkolle, në nivel lokal dhe kombëtar. Politika shpall qartë parimin e integritetit të EQD në të gjitha aspektet e jetës shkollore (në kurrikul, në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies; në klimën e shkollës, në manaxhimin dhe zhvillimin e shkollës). Kjo politikë shoqërohet me një plan të drejtpërdrejtë veprimi, në të cilin përcaktohen qartë si masat ashtu edhe përgjegjësitë

Megjithatë, këtu duhet theksuar fakti që përshkrimi i katër niveleve është disi arbitrar për qëllimet e këtij ushtrimi. Këtu ata ofrohen si shembuj, që jo domosdoshmërisht pasqyrojnë realitetin shkollor, në të cilin aspekte e ndryshme mund të harmonizohen ose të shfaqen ndryshe nga njëri nivel në tjetrin.

Arritjet e përgjithshme të shkollës mund të paraqiten në mënyra të ndryshme si ilustron në shembujt në figurën 5 dhe 6.

Figura 5. Rezultatet e njw shkolle....





Figura 6...e paraqitur në formë grafike



Përfundime nga vlerësimi

Përfundimet e përgjithshme duhet të mbulojnë katër fusha bazë:

- ◆ Arritjet e shkollës në fushën e EQD në përgjithësi;
- ◆ Gjëndja e shkollës lidhur me secilin tregues cilësie;
- ◆ Aspektet më të sukseshme dhe më pak të sukseshme të EQD në shkollë;
- ◆ Pikat më të rëndësishme që mund të rrezikojnë zhvillimin e mëtejshëm të EQD në shkollë.

Në rastin kur vlerësimi shoqërohet me një fazë tjetër vijuese, përfundimet duhet të përfshijnë edhe një krahasim me vlerësimet e mëparshme, qofshin ato të përgjithshme ose për ndonjë aspekt të veçantë të EQD, me qëllim që të mund të gjykohet për shkallën e përparimit, të qëndrimit në vend ose të kthimit prapa në përgjithësi ose në fusha të veçanta. Këtu është rasti të jepen edhe shpjegime të mundshme ose të zbulohen shkaqet për secilin nga rastet e mësipërme. Analiza duhet të marrë parasysh kontekstin e shkollës (për shembull, burimet ekzistuese, përbërjen shumëkulturore etj).

Analiza dhe përfundimet e fundit duhet të përfshijnë, nëse është e mundur, të dhëna të EQD të marra nga burime të jashtme si rezultatet e testeve kombëtare, rezultatet e insepktimeve për gjëndjen e përgjithshme të shkollës ose të EQD në mënyrë të veçantë.

Raportimi

Raportimi është hapi i fundit i procesit të vlerësimit. Ai është në të njëjtën kohë edhe një aspekt i rëndësishëm i një sistemi të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë dhe urë ndërmjet vlerësimit dhe planifikimit të zhvillimit.

Gjërësia dhe stili i raportimit mund të ndryshojnë në varësi atyre të cilëve ai u drejtohet. Në EQD, shkolla duhet të përgatisë raporte të ndryshëm për grupe të ndryshëm aktorësh, si për shembull:

- ◆ Raporte të përgjithshme që u drejtohen stafit të shkollës, bordit të shkollës, ministrive dhe inspektoratit;

-
- ◆ Raporte të thjeshtuara që u drejtohen prindërve dhe aktorëve të tjerë nga bashkësia lokale;
 - ◆ Raporte të shkurtëra për publikun e gjërë, përfshirë këtu edhe mediam (fletëpalosje, broshura etj.);
 - ◆ Raporte të përgatitura për faqen e internetit të shkollës.

Të gjitha raportet për EQD, duhet të jenë të thjeshta dhe të qarta. Ato duhet të përmbajnë tabela dhe grafikë shpjegues, veçanërisht për prindërit dhe aktotërët e tjerë jashtë shkollës. Praktika e raportimit të vazhdueshëm të bazuar në objektivat kryesorë të shkollës për zhvillimin e EQD ndihmon në rritjen e vetëdijes në fushën e ED dhe në rritjen e interesit të bashkësisë lokale për zhvillimin e EQD në shkollë dhe në bashkësi, si dhe për zhvillimin e strategjisë së përgjithshme të qeverisë në këtë fushë.

5. Planifikimi i zhvillimit të EQD

Hap pas hapi

Ideja bazë e këtij instrumenti, që buron edhe nga kërkimet,²⁷ është që shkolla, shumë rrallë (dhe vetëm në raste të veçanta) do të mund të arrijë nivelin 4 në fushën e EQD. Konteksti, (shkalla e vetëdijes dhe të rrymës së përgjithshme ekziston në politikat arsimore në fushën e EQD, përgatitja e shkollës dhe e mësuesve, ekzistenca e materialeve, konteksti i përgjithshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor në nivel shkollor, lokal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar) luan rol shumë të fuqishëm në krijimin e mundësive për të arritur këtë nivel.


Sfida kryesore është ngritja e një procesi të përmirësimit hap pas hapi që bazohet në nivelin fillestar që shkolla do të identifikojë në procesin e vetvlerësimit. Plani i zhvillimit të EQD do të përcaktojë kalimin nga njëri nivel në tjetrin si një objektiv zhvillimit dhe jo kalimin menjëherë në nivelin e katërt.

²⁷ Studim mbarë-evropian për politikat në fushën e EQD, KE, ISBN: 92-871-5608-5, botim i KE 2004

Figura 7 ilustron katër nivelet e mundshme të skenarit. Ajo është përshtatur nga një model i një vetvlerësimi të shkolles të bërë në Suedi, që ndodhet në Shtojcën 3²⁸. Shembuj janë vetëm tregues dhe janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Për këtë arsye ata nuk mbulojnë përmbajtjen e të gjithë treguesëve të shpallur në Kreun 5 dhe të bazuar në udhëzimet ekzistuese të EQD në nivel kombëtar dhe shkollor.

²⁸ “Qualis project”, ku 12 bashkitë në Suedi kryen një vlerësim të përgjithshëm cilësor në shkollat lokale. Shih: <http://www.qualis.nu/nacka/assess.htm>

Figura 7. Nje metodë hap pas hapi



Përgatitja e planit të zhvillimit të EQD

Siç tregohet në Kreun 3, planifikimi i zhvillimit të shkollës në fushën e EQD, duhet të përfshijë përmasat e mëposhtme, që bazohen në modelin e pikave të forta dhe të dobëta:

- ◆ Hartimi i një strategjie të zhvillimit që përshin vendimmarrjet për përparësitë e zhvillimit gjatë vitit në vijim, përcatimi i objektivave të zhvillimit, vendosja e objektivave në përputhje me mundësitë e shkollës, identifikimi i hapave që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat, si dhe përgjegjësitë (ndonjëherë, në këtë proces marrin pjesë edhe autoritetet lokale të arsimit ose inspektorati kombëtar).
- ◆ Identifikimi i nevojave të veçanta, madje edhe individuale të trajnimit, që burojnë nga këto përparësi (drejtuesi dhe stafi i shkollës) dhe zhvillimi i një plani trajnimi si pjesë e planit të përgjithshëm të shkollës.
- ◆ Identifikimi i nevojave për mbështetje në drejtime të tjera (konsulencë, burime të reja mësimore etj.) dhe sigurimi i mjeteve për t'i siguruar ato.
- ◆ Identifikimi i rrugëve në të cilat duhet të ndryshojnë organizimi ose manaxhimi i shkollës, për të përmbushur objektivat si dhe shpërndarja e burimeve lidhur me planifikimin e zhvillimit.
- ◆ Sigurimi i mjeteve të thjeshta të mbikëqyrjes së përparimit të bërë në drejtim të arritjes së objektivave dhe parashikimi i masave të përshtatshme që mund të ndërmerren nëse do të jetë e nevojshme.

Nisma e planifikimit të zhvillimit të shkollës në Irlandë²⁹ ofron këto udhëzime për vendosjen e përparësive

²⁹ Shih: www.sdpi.ie

Burimet e shkollës në drejtim të personelit, të përvojës, të energjisë, të kohës dhe të parave janë të kufizuara. Për këtë arsye, në përputhje me nevojat dhe mundësitë, përcaktohen edhe përparësitë në varësi:

- Të rëndësishme që kanë për zhvillimin e shkollës, në kuadrin e të gjithë faktorëve të kontekstit të saj.
- Të kapacitetit të shkollës për t'i trajtuar ato.
- Të angazhimit konkret të shkollës në trajtimin e tyre.

Në përzgjedhjen e përparësive është e rëndësishme të mbahen parasysh nevoja për të arritur një barazpeshë ndërmjet mirambajtjes dhe zhvillimit. Për të siguruar qëndrueshmërinë në këtë proces, që është dhe themeli i zhvillimeve të reja, duhet të ruhet vazhdimësia me praktikën e së kaluarës dhe të sotmes. Reformat jodemosdoshmërisht duhet të ndryshojnë çdo gjë. Në këto raste i duhet kushtur vëmendje sasisë së punës që shkolla ka mundësi të përballojë në procesin e zhvillimit. Planifikimi i zhvillimit duhet të harmonizojë nga njëra anë konsolidimin e ndryshimeve të së kaluarës me fillimin e ndryshimeve të reja dhe me përgatitjen e ndryshimeve të ardhshme.

Në përputhje me Parimet e EQD, nuk është rëndësishëm vetëm rezultati përfundimtar, për shembull plani i zhvillimit të EQD, por edhe përgatitja e procesit, i cili duhet të përfshijë të gjithë aktorët . Po kështu duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë, rolet dhe detyrat e secilit për përgatitjen e planit të zhvillimit. Raporti i vetvlerësimit duhet t'i paraqitet të gjithë aktorëve, me të cilët duhet të organizohen konsulta dhe diskutime lidhur me gjetjet e vlerësimit. Procesi i konsultimit, mundësisht të përfshijë diskutime me grupe të përzgjedhura, debate shkollë, debate të nxënësve (në këshillat e nxënësve, në klasë, në median e nxënësve etj), intervista individuale ose në grupe, pyetësorë (për shembull drejtuar prindërve).

Tabela 8 mund të përdoret për të përmbledhur planin e zhvillimit të shkollës.³⁰ Kolona e fundit ndihmon në mbikëqyrjen e përparimit të zbatimit dhe ofron një pikënisje për ciklin tjetër të planifikimit të zhvillimit.

³⁰ Kjo tabelë bazohet në Instrumentin e vetvlerësimit për qytetarinë demokratike, të botuar në Qershor 2004 nga Departamenti i edukimit dhe i aftësisë, Britani e Madhe. Shih: www.defs.gov.uk/citizenship

Tabela 8

Fusha e shkollës	Veprimi	Kush	Kur/deri	Mbështetja	Fakte të zbatimit
Bazuar në treguesit cilësisë EQD					

Procesi i planifikimit të zhvillimit në një shkollë në Irlandë përshkruhet si më poshtë³¹:

Për të hartuar planin e shkollës në St. Patrik, ne filluam së bashku një proces të këndshëm dhe të vlefshëm të vetvlerësimit. Në fillim patëm ndihmën e një anëtar të nismës për mbështetjen e planifikimit të zhvillimit të shkollës. Ai na njohur me procesin e rishikimit të punës së shkollës (pikat e forta, shqetësimet, mundësitë, rreziqet – Anglisht S.C.O.T.). Ne hartuan një listë të pikave të forta në të gjitha fushat – që nga mjedisi fizik e deri te kultura e shkollës. Më pas bëmë një hap prapa dhe identifikuam disa nga fushat ku mendonim se mund të kishim bërë më shumë. Më pas, individualisht, çdo mësues caktoi tri pika në fushat ku kishte nevojë për veprime të menjëhershme dhe dy dhe një pikë në fushat që do t'i ndiqnin ato. Drejtori llogariti përfundimet dhe kështu ne identifikuam pesa çështjet më të rëndësishme për t'u trajtuar në atë vit shkollor. Ne diskutuam për mënyrën e trajtimit të këtyre çështjeve dhe më pas theksuam ato gjëra që mund të ndërhyjnë në planet tona. Drejtori ynë na dha një listë me ide dhe afatet për zbatimin e tyre. Më vonë, ne u takuam për të reflektuar për çka ishte bërë mirë dhe për ato që kishin nevojë për më shumë vëmendje nga ana jonë. Në e rifilluam procesin këtë vit me pesë fusha të tjera për t'u trajtuar. Ky proces ishte pozitiv që në hapat e parë të tij dhe ne ndienim kënaqësinë e pasurimit të listës së pikave tona të forta. Ne fituam menjëherë besimin tek vetja. Të gjithë mësuesit u përfshinë që në fillim të procesit. Idetë erdhën nga poshtë lart, kështu që secili pjesëmarrës i shihte ato si të tijat. Ne vendosën pesë objektiva të arritshëm – përpjekja për të trajtuar të gjitha shqetësimet tona gjatë një viti shkollor do të kishte dështuar dhe për rrjedhojë do të na shkuraonte. Gjatë vitit të shkuar ne arritën suksese, për këtë arsye edhe këtë vit duam ta përsërisim këtë përvojë.

Shkolla St. Patrik, Slane.Co. Meath, Irlandë

Zbatimi i planit të zhvillimit të EQD

Mundësia për zbatimin e planit të zhvillimit të EQD varet nga masat në kuadrin e sistemit të sigurimit të cilësisë për EQD të përshkruar në Kreun 7.

³¹ Në I-Probe Net. Comenius 3 Rrjeti për vetvlerësimin e projekteve dhe të nxëniet në bazë projekti në shkollë: www.i-probenet.net



Drejt një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD

Ky kre i fundit i këtij instrumenti plotëson idetë e sipërpëndura për sigurimin e cilësisë së EQD në nivel shkolle dhe ofron një pamje të përgjithshme të rolit të politikave arsimore në zhvillimin e një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD. Ai shqyrton nevojat dhe çështjet e sigurimit të cilësisë së EQD në nivelin e sistemit arsimor në dy rrugë paralele:

- Ai rishikon sistemin e sigurimit të cilësisë dhe përbërësit e tij në këndvështrimin e EQD;
- Ai shqyrton kërkesat për një sistem të veçantë të sigurimit të cilësisë për EQD;
- Së fundi, ofron një listë të masave politike të nevojshme për ngritjen e një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD.

1. Hyrje

Kreu 5 dhe 6 e trajtojnë vërtetimin dhe planifikimin e zhvillimit të EQD në shkollë si thelbi i sigurimit të cilësisë në këtë fushë të veçantë. Ky kre kalon në nivel sistemi dhe trajton ato përbërës të sistemit të sigurimit të cilësisë që qëndrojnë përreth shkollës (shih figurën 2), duke ofruar një shtysë dhe mbështetje për planifikimin e zhvillimit të shkollës. Ai ritrajton përbërësit e sistemit të sigurimit të cilësisë të paraqitura në kreun 3 dhe i lidh ata me parimet dhe praktikën e EQD.

Çështjet në vijim duhet vlerësuar si pikënisje për diskutime në këtë terren të ri ku do të futemi. Këtë e themi sepse nëse sistemet e sigurimit të cilësisë në arsim, në formë dhe fazë të ndryshme pothuajse

ekzistojnë në të gjithë Evropën, sigurimi i cilësisë së EQD ekziston vetëm pjesërisht ose nuk ekziston fare.³²

2. Përbërësit e sigurimit të cilësisë në këndvështrimin e EQD

Trajtimi i EQD si një qëllim i arsimor kërkon edhe shqyrtimin e karakteristikave kryesore të një sistemi të sigurimit të cilësisë të bazuar në parimet e EQD. Kjo do të thotë që parimet e EQD të zbatohen në sistemin e sigurimit të cilësisë dhe në përbërësit e tij. Në këtë kuadër janë identifikuar edhe faktorët kryesorë të qeverosjes arsimore demokratike.

Përcaktimi i cilësisë

Këndvështrimi i EQD kërkon që përcaktimi i cilësisë ose vendosja e qëllimeve pse objektivave arsimorë të bëhet përmes një procesi pjesëmarrjeje dhe bashkëveprimi të të gjithë aktorëve.

Lidhur me kurrikulën kombëtare, një përcaktim i tillë përputhet, për nga natyra, drejtimi dhe koha, me proceset reformuese që po zhvillohen në shumë vende. Në shkollë për shembull, përcaktime të tilla duhet të bëhen në mënyrë sistematike.

Përcaktimi i cilësisë kërkon që, përveç njohjes dhe pranimit të rëndësisë së metodës pjesëmarrëse, të merret parasysh në të njëjtën kohë, edhe domosdoshmëria e njohurive profesionale. Po kështu, aktorë të ndryshëm kanë përgjegjësi të ndryshme dhe luajnë role të ndryshme në procesin e vendimmarrjes.

Përgjegjshmëria

³² Studimi për politikën e EQD dhe Manaxhimit të diversitetit në Vendet e Evropës Juglindore: Një studim mbarëevropian për politikën në fushën e EQD, KE, 2003

Në themel të përgjegjshmërisë qëndrojnë rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme në fushën e vendimmarrjes. Përgjegjshmëria nënkupton pozicione dhe marrëdhënie të ndryshme pushteti që kanë të bëjnë me çështje të tilla si: “Kush jep llogari dhe kujt ja jep atë?”, “Cilat janë pasojat për veprimet/mosveprimet dhe vendimet?”

Përgjegjshmëria që bazohet në EQD nënkupton fuqizimin e atyre që kanë më pak pushtet. Kjo nuk ndikon në rolet që ata kanë në pushtetin formal por vë theksin tek ideja që barazia dhe mund të arrihet duke rritur njohuritë e aktorëve për cilësinë e proceseve arsimore dhe duke i aftësuar ata në dhënien e gjykimeve.

Me fjalë të tjera, ndarja e informacionit dhe e transparencës do të pakësojë rastësitë dhe arbitraritetin në marrjen e vendimeve.

Të dhënat e jashtme

Në këndvështrimin e barazisë, masat për përgjegjshmërinë që lidhen me metodat e konkurrencës së tregut nuk janë të pëlqyeshme pasi prodhojnë ose rritin pabarazitë: shkolla më e mirë priret t’i tërheqë nxënësit dhe burimet, ndërkohë që shkolla me rezultate më të dobëta do të ketë më pak burime dhe për rrjedhojë më pak shanse për nxënësit që mësojnë në të.

Inspektimi

Inspektimi që bazohet tek EQD kërkon ndryshimin e kulturës së inspektimit, duke zbatuar parimet dhe duke bërë të vetat qëndrime të tilla si respekti, dinjiteti dhe bashkëpunimi.

Për shkak të vetvlerësimit të shkollës, inspektimi ndryshon nga një burim i vetëm në një burim plotësues informacioni – “syri i jashtëm” i funksionimit të shkollës. Për rrjedhojë, pushteti për të marrë vendime ndahet ndërsa mundësia që këto gjykime të jenë të rastësishme dhe arbitrare pakësohet.

Në këndvështrimin e sigurimit të cilësisë, qëllimi i raporteve dhe gjykimeve të inspektimit është të nxisë përmirësimin e punës dhe jo të kontrollojë përputhshmërinë me udhëzimet.

3. Sigurimi i cilësisë së EQD

Rritja e efektshmërisë së EQD kërkon që përbërës të caktuar të sistemit të sigurimit të cilësisë të përqendrohen tek EQD si plotësues dhe të mbështetiin planifikimin e zhvillimit të shkollës në fushën e EQD si përshkruhet në Kreun 6.

Politikat e EQD

Politika të veçanta të EQD janë të domosdoshme për të përcaktuar synimet arsimore në këtë fushë, fillimisht në nivel kombëtar e më pas në nivel shkolle. “Studimi mbarë Evropian i KE për politikat e EQD”³³, ofron dëshmi që deklaratat politike (që përmbajnë objektiva dhe qëllime të përgjithshme) dhe dokumentet kurrikulare (që përmbajnë objektivat dhe metodat arsimore), ekzistojnë dhe janë të zhvilluar në të gjithë Evropën.

Nga ana tjetër, kohët e fundit janë identifikuar probleme themelore që lidhen me zbatimin e politikave, ku dallon në mënyrë të veçantë mungesa e planeve të strukturuar të zbatimit të politikave dhe e politikave të përshtatshme të trajnimit të mësuesve, përfshi këtu trajnimin fillestar ashtu dhe atë të vazhduar.

Të dhënat e jashtme

Për sigurimin e të dhënave të jashtme që lidhen me EQD, që do të plotësonin vetvlerësimin e shkollës për EQD, mund të ndërmerren disa hapa:

- ◆ Rezultatet e përgjithshme të shkollës duhet të merren parasysh pasi ata ndikojnë tërthorazi në EQD. Ato dëshmojnë edhe për klimën e shkollës dhe mundësinë e saj për ndryshim.

³³ Studim mbarë-evropian për politikat në fushën e EQD, KE, ISBN: 92-871-5608-5, botim i KE 2004

-
- ◆ Rezultatet e provimeve kombëtare në lëndë që lidhen me EQD si historia, shkencat shoqërore etj., mund të ofrojnë informacion të vlefshëm për EQD.
 - ◆ Vëmendje duhet t'i kushtohet vlerësimit dhe raportimit të arritjeve të nxënësve në fushën e EQD si dhe në matjen e ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë të EQD, veçanërisht lidhur me ndryshimin e qëndrimeve. Për këtë janë të nevojshme kërkime dhe punë e mëtejshme në këtë fushë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.³⁴
 - ◆ Mbikëqyrja e politikave dhe praktikave të EQD mund të realizohet në nivel kombëtar dhe evropian, përmes mbledhjes së shembujve të praktikave të mira, studimeve krahasuese dhe kërkimeve afatgjata.³⁵

Inspektimi

Inspektorët kanë nevojë të trajnohen, që të jenë të aftë të kuptojnë gjërësisht parimet, metodat dhe mjediset e të nxënësve të EQD dhe të mund të shohin cilësinë dhe efektshmërinë e EQD përtej kërkesave të thjeshta kurrikulare. Për këtë arsye, është i nevojshëm edhe sigurimi i udhëzimeve dhe i materialeve të përshtatshme për inspektimin e EQD.

³⁴ Deri tani i vetmi burim të dhënash në nivel ndërkombëtar në këtë fushë gjëndet në adresën: http://www2.hu-berlin.de/empir_bf/iea_e.html
BE ka bërë pjesë të programit të tij të punës “Edukimi dhe trajnimi 2010” përcaktimin e treguesve për të mësuarit gjatë gjithë jetës për qytetarinë demokratike.

³⁵ Për shembull, në Angli, Departamenti për Edukim dhe aftësi ka nisur një studim nëntëvjeçar për Edukimin qytetar. Ky studim po kryhet nga Fondacioni Kombëtar për kërkime arsimore (NFER) dhe kërkon të masë ndikimet afatshkurtëra dhe afatgjata të kurrikulës së re të qytetarisë. Shih: www.nfer.ac.uk/research/citizenship.asp

4. Marrja e masave për sigurimin e cilësisë së EQD

Vendosja e një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD kërkon nga autoritetet arsimore, veçanërisht nga ministritë e arsimit, vullnet për të vepruar dhe për të marrë vendime politike dhe masa për këtë qëllim.

“Studimi mbarëevropain”³⁶, dëshmon se politika të tilla për sigurimin e cilësinë në Evropë mungojnë.

Rishikimi i situatës

Si përshkruhet në Kreun 1, përdorimi i këtij instrumenti duhet të bazohet në rishikimin e situatës së sigurimit të cilësisë në arsim dhe në EQD në një vend të caktuar. Instrumenti kërkimor i përgatitur për studimin e Sigurimit të cilësisë së EQD në Evropën JugLindore, mund të shërbejë si shembull në këtë drejtim. (shih Shtojcën 2). Objektivi i këtij rishikimi është të përcaktojë burimet dhe pengesat që ekzistojnë në sistemin e sigurimit të cilësisë së një vendi. Ai duhet të identifikojë cilët prej përbërësve të sistemit të sigurimit të cilësisë të paraqitur në Kreun 3, ekzistojnë dhe cilët mungojnë, si funksionojnë dhe bashkëveprojnë etj.

Ngritja e një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD

Masat për ngritjen e një sistemi të sigurimit të cilësisë së EQD, nga njëra anë duhet të mbulojnë sigurimin e cilësisë së arsimit në përgjithësi, për të siguruar një qeverisje arsimore demokratike dhe, nga ana tjetër, sigurimin e cilësisë së EQD në mënyrë të veçantë për të siguruar efektshmërinë e EQD në shkollë. Tabela 9, përmbledh masat e mundshme që lidhen me përbërësit e sistemit të sigurimit të cilësisë në të dy këndvështrimet e sipërpërmendura.

³⁶ I cituar më sipër

Në kushtet e situatave të larmishme në Evropë, fushat e rekomanduara për veprim janë nga natyra e tyre tepër të përgjithshme. Ato duhet të përshtaten për kushtet e veçanta kombëtare dhe lokale dhe të krijojnë bazat për përgatitjen e një plani kombëtar për sigurimin e cilësisë së EQD.

Këto masa mund të përmbajnë:

- ◆ Përshtatjen e kuadrin politik dhe legjislacionit për sigurimit të cilësisë së EQD;
- ◆ Ngritja e strukturave të reja dhe reformimi i strukturave ekzistuese;
- ◆ Politika dhe programe trajnimi;
- ◆ Bashkëpunim dhe rrjete të vendimmarrësve dhe praktikantëve;
- ◆ Mbledhja dhe përhapja e shembujve të praktikës së mirë për sigurimin e cilësisë së EQD;
- ◆ Shkëmbimet dhe bashkëpunimet në nivel evropian.

Tabela 9

Fusha të rekomanduara për veprim		
	Sigurimi i cilësisë	Sigurimi i cilësisë së EQD
Bazat e Sigurimit të cilësisë së EQD	Fuqizimi i shkollave si tregues themelor për matjen e arritjeve	EQD si qëllim i politikave dhe sistemeve arsimore
	Decentralizimi i arsimit dhe autonomia e shkollës	Politikë dhe kurrikul e veçantë dhe plan zbatimi për EQD.
Planifikimi i zhvillimit të shkollës	Statusi i vetvlerësimit shkollor	Kërkesa për vetvlerësimin e EQD
	Instrumenti kombëtar i vlerësimit	Instrument i veçantë për vlerësimin e EQD
	Vlefshmëria e rezultateve të provimeve kombëtare	Përfshirja e EQD në instrumentet kombëtare të vlerësimit
Mësuesit dhe drejtorët	Trajnim fillestar dhe i vazhduar në grup (vetvlerësim, planifikimi i zhvillimit të shkollës, udhëheqja demokratike)	Trajnim fillestar dhe i vazhduar lidhur me parimet, mësimdhënien dhe praktikatat e të nxënësve të EQD.
	Inspektimi	Reformat e sistemit të inspektimit në këndvështrimin e sigurimit të cilësisë, duke siguruar pavarësinë dhe besueshmërinë
Përgjegjshmëria	Trainimi inspektorëve në fushën e sigurimit të cilësisë	Udhëzime dhe materiale për inspektimin e EQD
	Përgjegjshmëria	Kërkesa dhe masa për përgjegjshmëri e funksionimit të shkollës
Mbështetje	Roli i autoriteteve lokale në planifikimin e zhvillimit të shkollës	Trajnimi i zyrtarëve lokale në fushën e EQD
	Këshillë eksperti	
	Kërkimi dhe vlerësimi në dhe për sigurimin e cilësisë në arsim	Kërkim dhe vlerësim në fushën e matjes së rezultateve të nxënësve dhe të ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë të EQD

Shtojca 1: Lista e autorëve dhe e atyre që ndihmuan në përgatitjen e këtij instrumenti

Grupi i draftit të Instrumentit të sigurimit të cilësisë së EQD

Çezar Birzea, Drejtor i Institutit të Shkencave Pedagogjike, Bukuresht, Rumani

Mikela Çekini (Michela Cecchini), konsulente, Mbretëria e Bashkuar, Manxher i projektit të Sigurimit të cilësisë së EQD

Kamerun (Cameron) Harrison, Drejtor, Shoqata Harrison Lemon, Skoci
Janez Krek, CEPS, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Ljubjanës,

Sloveni, Instituti koordinues i projektit të sigurimit të cilësisë së EQD
Vedrana Spajić Vrkas, Profesor, Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i

Filozofisë, Departamenti i Edukimit, Kroaci

Miriam Karela, Specialist programi, UNESCO, Departamenti i

Promocionit të Arsimit Cilësor, seksioni i edukimit për paqe dhe të drejtat e njeriut

Kontribute dhe vlerësime

Isabel Bairon (Byron), Byroja Ndërkombëtare e Edukimit (IBE), UNESCO

Xhejms Kerr, Studjues, Fondacioni Kombëtar për Kërkime Arsimore (NFER), Mbretëria e Bashkuar, anëtar i grupit të politikës së EQD të Këshillit të Evropës

Dr. Mojca Kovač, Sebart, Universiteti i Ljubjanës, Sloveni

Profesor Xhon Kakbeth, Universiteti i Kembrixh, Mbretëria e Bashkuar
Bart Maes, Studjues, Departamenti për Zhvillime Arsimore, Ministria e Arsimit, Komuniteti Flemish, Belgjikë, Anëtar i grupit të politikave të KE

Liljana Subotić, inspektore, Mal i Zi

Mësues të EQD dhe të lëndëve që lidhen me EQD, Drejtues shkollash, ekspertë në EQD dhe sigurimin e cilësisë, përfaqësue të OJQ, aktivë në fushën e EQD, Rumani

Shtojca 2. Metoda e mbledhjes së të dhënave

Meodat dhe instrumentet që ato përmbajnë, të cilat shkolla mund t'i përdorë për vetvlerësimin e EQD janë të shumta. Përzgjedhja e tyre duhet të bëhet në varësi të qëllimit të vetvlerësimit (për shembull, për të patur një tablo të përgjithshme, për të bërë një analizë tërësore ose për të kryer një shqyrtim të thelluar për një çështje të caktuar), të natyrës së çështjes që do të vlerësohet, vlefshmërisë së burimeve njerëzore dhe materiale dhe të kohës.

Shkallët e vlerësimit

Deklaratat dhe çështjet vlerësohen sipas shkallëzimeve të mëposhtme:

Shembulli 1 (Shkalla Likert)

- 1: Mbështes fuqimisht
- 2: Jam dakord
- 3: I pavendosur
- 4: Nuk jam dakord
- 5: Kundërshtoj fuqimisht

Shembulli 2

Niveli 1: pikat e dobëta të rëndësishme që ndodhen pothuajse ose në të gjitha fushat;

Niveli 2: më shumë pika të dobëta se të forta;

Niveli 3: më shumë pik atë forta se të dobëta;

Niveli 4: pika të forta pothuajse ose në të gjitha fushat dhe pika të dobëta të parëndësishme.

Pyetësi

Një pyetësor është një radhë pyetjesh që prekin aspekte të ndryshme të çështjes në shqyrtim. Ai lejon mbledhjen e të dhënave të shumta (faktike ose opinione) dhe është i thjeshtë për t'u administruar. Megjithatë, hartimi dhe zbatimi i një pyetësi kërkon shumë kohë dhe mund të ketë probleme me besueshmërinë e tyre. Kur zbatohet në grupe të ndryshme, gjuha dhe slili i pyetjeve duhet të përshtaten, veçanërisht kur u drejtohen të rinjve dhe prindërve. Një pyetësor i fokusuar hartohet për të hetuar probleme ose fusha të veçanta.

Listkontrolli

Listkontrolli është një pyetësor i thjeshtë me përgjigje PO ose JO. Ajo është një rrugë e shpejtë dhe e thjeshtë për të shqyrtuar njëlistë të gjatë çëshjesh dhe për të identifikuar ato që kërkojnë diskutim ose shqyrtim të mëtejshëm.

Intervista

Intervista ndihmon në marrjen e një informacioni ose shpjegimi të thelluar nga të intervistuarit, veçanërisht të opinioneve, ndienjave, njohurive etj. Ai mund të përdoret për të plotësuar rezultatet e një pyetësori., Ai mund të përbëhet nga një listë pyetjesh të cilave i intervistuari u përgjigjet (intervistë e strukturuar) ose mund të hartohet në një mënyrë të tillë ku pyetjet shërbejnë vetëm si një kornizë ndaj të cilës i intervistuari duhet t'i përgjigjet hapur (intervistë informale dhe pjesërisht e strukturuar). Megjithatë, kategorizimi, përpunimi dhe interpretimi i të dhënave kërkon përsëri shumë kohë. Përveç kësaj, një i intervistuar duhet të trajnohet dhe të jetë i përgatitur për një hetim ballëpërballë. Ai kërkon një nivel të lartë të aftësive dëgjuese dhe komunikuese dhe aftësi për të minimizuar përgjithësimet e tepëruara, njëanshmëritë dhe manipulimet me të intervistuarin. Për të shmangur këto, hartuesi i intervistës duhet të zhvillojë kritere të qarta, të përgatisë udhëzime për intervistën dhe të mundësojë që të gjithë të intervistuarit të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në këtë fushë.

Intervistat mund të bëhen me individë dhe grupe në mënyra të larmishme.

Intervistat ndërmjet kolegëve

Këto intervista janë ato që zhvillohen ndërmjet dy personave që kanë status të njëjtë ose të ngjashëm, (për shembull, ndërmjet dy mësuesve, dy nxënësve, dy drejtuesve etj).

Intervistat me grupe të përzgjedhura

Intervista me një grup të përzgjedhur prej dhjetë deri pesëmbëdhjetë vetësh, që përfaqësojnë grupe të caktuara aktorësh. Një grup i përzgjedhur, i përzierë mund të përbëhet nga përfaqësues të mësuesve,

të nxënësve, të prindërve, të stafit të shkollës, të OJQ, të drejtuesve të bashkësisë, të drejtuesve të nxënësve, të punonjësve shkencorë, të trajnerëve etj. Këto intervista ofrojnë një larmi të dhënash, por mund të jenë të vështira për t'u realizuar dhe në këtë mënyrë kërkon përgatitjen e duhur të drejtuesit të tyre ose një ndihmës me përvojë.

Vëzhgimi

Vëzhgimi ka të bëjë me një shqyrtim tërësor të një njarjeje, të një grupi ose të një individe. Vëzhgimi i kolegëve ndodh kur një person vëzhgon sjelljen e një personi që ka të njëjtin status me të (mësues-mësues, nxënës-nxënës etj.) Ky vëzhgim, përveç se është një mjet për mbledhjen e të dhënave, mund të ndihmojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. Vëzhgimi nga mësuesit i njëri-tjetrit ndihmon në edukimin e përgjegjshmërisë së mësuesve, ndërsa vëzhgimi i bërë nga nxënësit rrit vetëdijen dhe përgjegjësinë e tyre rezultatet e të nxënit. Megjithatë, ai nënkupton, mbajtjen e një protokollit të mirëorganizuar vëzhgimi, trajnim të vëzhguesit dhe një klimë besimi ndërmjet vëzhguesit dhe të vëzhguarit, të bazuar në një marrëveshje rreth çështjes dhe metodës së vëzhgimit.

Analiza SWOT³⁷ (pikat e forta, dobësitë, shanse dhe rreziqe)


Analiza SWOT është një mjet për të bërë analiza strategjike, që ndihmojnë në identifikimin e një situatë dhe në shqyrtimin e skenareve të mundshme të zhvillimit. Ajo shqyrton dhe lidh aspektet themelore të çështjes në interes (faktorët e brendshëm) si dhe mjedisin e saj (faktorët e jashtëm). Faktorët e brendshëm, zakonisht ose të paktën pjesërisht, janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë. Faktorët e jashtëm zakonisht nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë.

³⁷ SWOT – anglisht: strengths, weaknesses, opportunities, threats

Faktorët e brendshëm	Pikat e forta Aspektet pozitive, avantazhet	Pikat e dobëta Aspektet negative, dizavantazhet
Faktorët e jashtëm	Mundësitë Mundësi për përmirësim dhe ndryshim	Rreziqet Pengesa ndaj përmirësimit ose ndryshimit

Fusha e forcave

Analiza e fushës së forcave përdoret për të parë të gjitha forcat pro dhe kundër një vendimi ose situatë. Ajo ndihmon në identifikimin e peshës pro ose kundër, të avantazheve dhe dizavantazheve, përsheptuesit ose pengesat, duke i listuar të gjitha forcat pro vendimit ose ndryshimit në një kolonë dhe të gjitha forcat kundër vendimit ose ndryshimit në një kolonë tjetër. Çdo forcë i jepet një vlerësim. Radhitja e tyre do të ilustrojë fushat parësore për vendime dhe pengesat kryesore



Diagrami i fushave të forcës

Portofoli

Një portofol përmban një përmbledhje të arritjeve të regjistruara, të punës dhe të përvojës personale. Në të njëjtën kohë ai është edhe një mjet për vetvlerësim nëse faktet janë mbledhur në përputhje me kriteret e arritjeve të tilla si kompetenca, pikat e forta, mesatarja dhe fushat e problemit.

Vlerësimi i fotove

Vlerësimi i fotove është një mënyrë krijuese për të zbuluar perceptimet dhe përshtypjet. Nëse fotot e marra në një ngjarje të caktuar paraqiten për shembull si postera, atëherë, përshtypjet pozitive ose negative bëhen të njohura dhe diskutohen në klasë

Ditari

Ditari është një dokument në të cilin shënohen rregullisht çështje personale. Shënimet personale kanë një përmasë të fuqishme refleksioni. Si pjesë e procesit të vlerësimit, ditati mund të fokusohet në çështje të pranuar gjërësisht dhe të përdorura si referenca personale në diskutime.


Shtojca 3: Zhvillimi hap pas hapi

- Ekziston një grup pune
- Cilësia në të ndryshon
- Ekzistojnë kushte paqej dhe qetësi për të punuar
- Metodat e punës kryesisht drejtohen nga mësuesit
- Ekziston një udhëheqje e qartë
- Nuk ka sistem vlerësimi
- Ka një farë pune sistematike për përmirësim
- ndihet një farë ndikimi i nxënësve dhe prindërve
- buxheti është i barapeshuar

- Udhëheqje e qartë dhe strategjike
- Qëllimet dhe vlerësimi funksionojnë në nivel klase
- Nxënësit vendosin qëllimet dhe dokumentojnë të nxënëtit e tyre
- Bashkëpunim me prindërit në të gjitha nivelet
- Ekziston klimë besimi dhe respekti të ndërsjellë
- Metodat e punës janë të larmishme dhe fleksibël
- Përdorim i efektshëm i burimeve në të gjitha fushat
- IT përdoret sistematikisht kudo

- Ekziston një sistem i përbashkët vlerash që shfaqet gjatë punës së përditshme
- Nxënësit reflektojnë për të nxënëtit e tyre dhe zhvillojnë stilet e tyre të të nxënëtit
- Nxënësit dhe prindërit ndajnë përgjegjësinë e tyre për të gjitha veprimtarisë që u intereson
- Metodat e punës vlerësohen rregullisht
- Grupet e punës marrin përsipër përgjegjësinë për të nxënëtit
- Shkolla komunikon lirisht me bashkësinë lokale
- Të gjithë bashkëpunëtorët përqendrohen në burimet e mira të manaxhimit

- Lidhje e qartë ndërmjet synimeve për një sistem bazë vlerash dhe metodave të punës
- Të nxënëtit ka si pikënisje individin
- Kryhet punë sistematike për zhvillimin e metodave
- Shkolla arrin rezultate më të mira vit pa viti
- Planet për trajnimin e mësuesve kontrollohen dhe përmirësohen rregullisht
- Zhvillohet punë sistematike për përmirësim në çdo nivel



Shtojca 4: Udhëzime për planifikimin e veprimit

Hapi 1: Çfarë dëshirojmë të arrijmë?

Përcakto objektivat

Objektivat duhet të jenë: specifikë, të matshëm, të vëzhgueshëm, të arritshëm, realistë, në kohë

Specifikë: (d.m.th. duhet të jenë të saktë sa të tregojnë rezultatin e kërkuar)

Të matshëm, të vëzhgueshëm (ata duhet të jenë të matshëm ose të vëzhgueshëm që edhe progresi të jetë i matshëm)

Të arritshëm (duhet të jenë të arritshëm në kuadrin e kufizimeve që vendosin rrethanat e shkollës)

Realistë (duhet të bazohen në supozime realiste për sjelljen njerëzore, natyrën e organizatës dhe mundësitë)

Kohëzgjatja (duhet të tregojnë kohën në të cilën duhet të arrihen)

Hapi 2: Çfarë do të bëjmë për t'i arritur objektivat?

Identifiko drejtime të ndryshme veprimi

Është e rëndësishme të eksplorosh mundësitë që ekzistojë për të përcaktuar atë që do të mundësojë më mirë arrijen e objektivave

Hapi 3: Si do të arrijmë

Zgjidh dhe përcakto një kurs veprimi

Në këtë fazë, vëmendja është në përcaktimin me saktësi të asaj që është bërë. Një kurs veprimi është zgjedhur. Detyrat janë përcaktuar qartë dhe është përcaktuar edhe rendi i veprimeve

Hapi 4: Cilat janë burimet për të cilat kemi nevojë

Identifiko kërkesat për burime

Burimet për veprimin e zgjedhur identifikohen për t'i shërbyer pikërisht kërkesave njerëzore, organizative dhe fizike të zbatimit të planit.

Hapi 5: A është plani i realizueshëm?

Rishiko planin nëse është e nevojshme

Në këtë pikë do të ishte me vlerë të shqyrtohet nëse kursi i zgjedhur i veprimit mund të zbatohet në shkollë, veçanërisht në dritën e mundësisë së arrijtes së objektivave

Hapi 6: Kush do të zbatojë atë?

Përcakto përgjegjësitë

Çdo individ i caktohet një detyrë e veçantë në kuadrin e kursit të zgjedhur të veprimit, kështu që është e qartë përgjegjësia e secilit në shkollë

Hapi 7: Kur do të zbatohet?

Vendos afatet

Afatet vendosen për t'i dhënë shtysa punës së zbatimit dhe për të lehtësuar procesin

Hapi 8: Si do të marrim vesh nëse çdo gjë funksionon mirë?

Identifiko kritere për sukses

Detajo procesin e monitorimit dhe të vlerësimit

Shtojca 5: Instrument kërkimi për rishikimin e sigurimit të cilësisë së EQD

Ky instrument kërkimi është përdorur për të përgatitur raporte kombëtare për sigurimin e cilësisë në arsim dhe në EQD në vendeet e Evropës JugLindore³⁸

Ky instrument kërkimi është i bazuar në metodën e sigurimit të cilësisë të përshkruar në Kreun 3 dhe synon të trajtojë tri çështje kryesore:

- ◆ Politika dhe të kuptuarit e reformës. Cila është shkalla e vetëdijes dhe e interesit për sistemet e sigurimit të cilësisë si sektorë kyç të sistemeve të arsimit në vendet e rajonit, veçanërisht në ministritë e arsimit? Sa kuptohet në kuadrin e sistemit ndryshimi ndërmjet metodës së sigurimit të cilësisë dhe asaj të kontrollit të cilësisë dhe veçanërisht në komunitetin e politikëbërësve?
- ◆ Burimet dhe pengesat aktuale. Në çfarë shkalle elementët e infrastrukturës aktuale mund të mbështesin nëse u kërkohet sistemin e sigurimit të cilësisë? Cilat janë problemet aktuale që burojnë nga gjëndja e strukturës ekzistuese, e kulturës organizative dhe procedurave që janë trashëguar nga një sistem i mëparshëm joefektiv i sigurimit të cilësisë? Cilat janë detyrat që duhet të merren përsipër në studimin tonë dhe cilat janë pengesat që duhet të kapërcehen përpara se të ngrihet një sistem efektiv i sigurimit të cilësisë në sistemin shkollor ose kombëtar?
- ◆ Hapat e mëtejshëm. Nëse fusha e EQD do të përdorej për të gjykuar për zhvillime të tilla të gjëra, cila do të ishin pikënisjet për planifikimin e një programi pilot?

Interesi aktual për cilësinë e arsimit në vend?

- ◆ A ka dëshmi të interesit publik ose profesional për cilësinë e arsimit në vendin tuaj – veçanërisht në qeveri? Në çfarë forme ekziston një

³⁸ Si pjesë e projektit për EQD: Nga politika në praktika të efektshme përmes sigurimit të cilësisë.

interes i tillë. A ekziston vetëdija për interesin ndërkombëtar që ekziston aktualisht në këtë fushë?

- ◆ A është çështja e përcaktimit të veçantë të “cilësisë” e zhvilluar sa duhet? A ipërfshin ajo çështjet e EQD?
- ◆ A ekziston interesi për përdorimin e kësaj metode ne proceset aktuale të reformës arsimore? A janë ndërmarrë deri sot hapa konkretë në këtë drejtim?

Interesi aktual në sistemet e sigurimit të cilësisë në arsim në vend

- ◆ A ekzistojnë fakte që dëshmojnë për interesin e qeverisë në sistemet e sigurimit të cilësisë që lidhen me shkollat në vendin tuaj? Si shprehet ai në vendin tuaj? A është ai sistemik në metodën që përdor? Në çfarë faze është? A ekziston ndonjë dokument për këtë qëllim?
- ◆ A dëshmon interesi që shprehet në dokumentin e politikave për një shkallë të lartë të të kuptuarit të pushtetit dhe të përdorimit të metodës së sigurimit të cilësisë? A është ai i ndieshëm ndaj pengesave që mund të shfaqen? A dëshmon për kuptimin e duhur të kundërshtisë që ekziston ndërmjet sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë? A pasqyron ai shkallën e vetëdijes për problemet që mund të lindin gjatë zhvillimit të kësaj metode?
- ◆ Përveç çështjes së interesit për një metodë sistemike të sigurimit të cilësisë, a ka fakte që dëshmojnë për interesin e qeverisë për ndonjë element të veçantë të përmendur në hyrje? (për shembull, zhvillimi i një agjencie kombëtare të vlerësimit, reformimi i inspektoratit kombëtar ose angazhimi i kërkuesve për të punuar në këtë fushë?). Si shprehet ky interes? A lidhet ai hapur me sigurimin e cilësisë? A mund të lidhet? Cilat janë zhvillimet që po ndodhin aktualisht?
- ◆ A ka fakte që dëshmojnë për interesin të shprehur ndërmjet shkollave, drejtuesve të shkollave, shoqatave të mësuesve? Si shprehet ai? A ka ndonjë botim në të cilin është shprehur ky interes? A është qeveria në dijeni të këtij interesi? A e mbështet/e nxit ajo atë? Si?

-
- ◆ A ka botime të ndonjë akademiku në vendin tuaj për këtë çështje? Cila është fusha e tyre e interesit? Çfarë thonë ata?
 - ◆ A ka ndonjë OJQ që po zhvillon interesin e saj për aftësitë në fushën e sigurimit të cilësisë?

Fuqizimi dhe delegimi i përgjegjësisë

- ◆ A ekziston ndonjë politikë kombëtare, në të cilën shpallen synimet për delegimin e përgjegjësisë/vendimmarrjes në shkollë?
- ◆ A ka patur zhvillime në këtë fushë. Cila janë reagimet. A janë vlerësuar rezultatet?
- ◆ Cila është shtrirja e këtyre zhvillimeve? Në pajtimin e stafit, ndryshimin e planit, përzgjedhjen e librave, mbulimin e trajnimeve ose mbështetje me konsulencë? Manaxhimi i buxhetit? Fleksibilitet në kurrikul? Përfshirja lokale në zgjedhjen e drejtuesve?
- ◆ A ka rregullime për qeverisje lokale? Përfshirja e njerëzve të bashkësisë jashtë shkollës? Cilat janë pushtetet e vendimmarrjes që i janë deleguar organizmave lokalë? A ka përfshirje të nxënësve dhe prindërve në këtë proces?
- ◆ A ka burime lokale për gjetje forndesh për zhvillimin e shkollës? Cili është përgjegjës për këtë? Kush i manaxhon fondet ekzistuese? Cila është përgjegjshmëria për përdorimin e tyre?
- ◆ Aë janë të intervistuarit në gjëndje të prshkruajnë një model të praktikës lokale në manaxhimin e shkollës? Si po zhvillohen ata? Çfarë të dhënash ofrojnë ata se si perceptohen zhvillimet e bëra dhe cili është progresi i tyre? A ka të dhëna për lindjen e stilit pjesëmarrës në shkollë?
- ◆ A ka të dhëna që stafi e pranon përgjegjësinë e përbashkët për funksionimin/planifikimin e shkollës? A zhvillohet takime me të gjithë stafin e shkollës? Cilat janë çështjet që trajtohen atje?
- ◆ A i pengon praktika aktuale e shkollës (lidhur me rolin e mësuesit si anëtar i një grupi më të gjërë – stafit të shkollës) zhvillime të tilla? A i lejojnë kontratat e mësuesve dhe puna aktuale praktike stafin që të zhvillojë praktikën e punës së përbashkët?

-
- ◆ Sa të lira janë shkollat që të zhvillojnë praktika të mira ose të ndërmarin nisma në çështjet e manaxhimit, të kurrikulës, të mësimdhënies, të të nxënit dhe të vlerësimit?

Vetpërmirësimi i shkollës

- ◆ A janë te intervistuarit tuaj në gjëndje të japin të dhëna lidhur me përqafimin nga shkolla të metodës së vetpërmirësimit, të vetvlerësimit të shkollës? Si realizohet ajo? Sa e përhapur është? A është qeveria e interesuar për këtë?
- ◆ A është e vetedijshme qeveria ose shkollat për rëndësinë e çështjeve të kulturës së shkollës? Si shfaqet kjo?

Trajnimi dhe mbështetja e shkollës me këshillime

- ◆ Si është i organizuar trajnimi i mësuesve në shërbim në vendin tuaj? Cilat janë institucionet përgjegjëse ose ato që përfshihen në të? Cila është efektshmëria e tyre në përcaktimin e nevojave të shkollës?
- ◆ Sa janë në gjëndje shkollat t'u kërkojnë ndihmë të veçantë institucioneve ose sistemit? Cilat janë idetë e ndryshme për shkallën e realizimit të këtyre kërkesave? A ka të dhëna për vështirësitë institucionale ose procedurale
- ◆ A ka rregullime për kushtet e trajnimit dhe mbështetje për drejtuesit e shkollave që mund të përdoret për të mbështetur metodën e sigurimit të cilësisë?
- ◆ A ka përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë tek ata që ofrojnë trajnimin e mësuesve?
- ◆ A ka ndonjë përvojë në EQD tek ofruesit e trajnimeve të mësuesve?
- ◆ Si financohen ofruesit e trajnimit të mësuesve aktualisht?

Planifikimi i zhvillimit të shkollës

- ◆ A ka të dhëna që dëshmojnë se në sistemin shkollor ekziston një sistem i njohur zyrtarisht i planifikimit të zhvillimit të shkollës? Nëse po, kush është përgjegjës për planin e shkollës? Si duhet të realizohet ai? Cili i aprovon? Cilat janë burimet që e mbështetin? Si

mbështetet procesi? A njihen lidhjet e mundshme të sigurimit të cilësisë?

- ◆ Nëse mungon një sistem i njohur zyrtarisht, a jeni në gjendje të dalloni shenjë të një sistemi më pak zyrtar, më pak të zhvilluar ose shenjë të një interesi të përgjithshëm në këtë metodë?
- ◆ A ka të dhëna që dëshmojnë për ekzistencën e një instrumenti vlerësimi të punës së shkollës të zhvilluar në nivel kombëtar ose lokal që mund të mbështesë një metodë të tillë?
- ◆ Çfarë mbështetje mund t'i ofrohet shkollës në detyrën e saj për të fituar aftësitë e duhura për të zhvilluar këtë metodë?
- ◆ A ka të dhëna për shkolla të veçanta ose rrjete shkollash që përdorin një metodë të tillë? Si është mundësuar kjo dhe sa e përhapur është?

Kritere kombëtare/ndërkombëtare dhe proceset e vlerësimit

- ◆ A bëhen në vendin tuaj përpjekje për të vlerësime kombëtare dhe proces certifikimi? A bëhen përpjekje për ndonjë formë testimi në nivel kombëtar?
- ◆ Cilat fusha kurrikulare mbulojnë këto përpjekje? A përfshihet EQD ose fusha që lidhen me të? Cilat faza të shkollimit janë përfshirë në këtë proces?
- ◆ A vihen rezultatet e testimit në dorë të shkollave, në mënyrë që këto të mund të ndihmojnë vlerësimin e cilësisë së punës së tyre dhe të planifikimit të zhvillimit?
- ◆ A ekziston rreziku që vlerësimi vetëm i një nëngrupi të objektivave të kurrikulës të prishë barazpeshën e objektivave të kurrikulës në praktikë?

Inspektorati kombëtar

- ◆ A ekziston inspektorati kombëtar në vendin tuaj? Cilli është roli i tij aktual? Cilat funksionet të tij vlerësohen si të forta nga të intervistuarit dhe cilat si të dobëta?
- ◆ A ndihet besim profesional dhe publik në aftësitë, në metodën, dhe në pavarësinë e inspektoratit?

-
- ◆ A është ai i pavarur? A boton ai ndonjë raport vjetor ose dyvjetor etj.,?
 - ◆ A është inspektorati i vetëdijëshëm ose i përfshirë në çështjet e sigurimit të cilësisë në nivel kombëtar?
 - ◆ A ka ndonjë dokument zyrtar për treguesit e cilësisë të përdorur nga inspektorët? A lidhen ato me synimet kombëtare të arsimit, me standardet dhe përkufizimet e cilësisë? Cili është statusi i tyre? (në kuadrin e ndonjë ligji për arsimin, në ndonjë dokument qeveritar apo në formën e udhëzimeve të ofruara për shkollat dhe mësuesit?)
 - ◆ Sa janë të njohura për publikun proceset e inspektimit?
 - ◆ A e përfshinë proceset e inspektimit EQD?

Kurrikula dhe përkufizimi i “cilësisë”

- ◆ A ka ndonjë organizëm kombëtar përgjegjës për kurrikulën kombëtare? Si është e ndërtuar kurrikula dhe si e përdorin mësuesit atë?
- ◆ A ekzistojnë standarde ose tregues të cilësisë të përfshirë në kurrikulën kombëtare?
- ◆ A ka objektiva shtetërore që bazohen në standardet shkollore? Këta objektiva ekzistojnë në nivel kombëtar apo në nivel shkolle?
- ◆ A ekzistojnë standarde të tillë në fushën e EQD?

Përgjegjshmëria

- ◆ A ekzistojnë masa ose përpjekje për përgjegjshmërinë e shkollave në sistemin aktual? Sa njihet ai nga pikëpamja zyrtare? A është i njohur nga publiku?
- ◆ Cilat janë çështjet për të cilat shkolla është përgjegjëse? A bën pjesë këtu cilësia?
- ◆ Deri ku shtrihet përgjegjshmëria e shkollës?
- ◆ Cilët janë nxitësit ose sanksionet që ekzistojnë në sistemin aktual? /Cila është shkalle e efektshmërisë së tyre?
- ◆ Cili është ndikimi i ekzistencës ose i mungesës së përgjegjshmërisë në funksionimin e sistemit?

-
- ◆ A shtrihet përgjegjshmëria deri tek aktorë të tillë si drejtoritë arsimore lokale, ministrinë, politikanët. Cilat janë mekanizmat që e sigurojnë atë?

Drejt së ardhmes

Analiza ka identifikuar përfitimet aktuale që vendi në shqyrtim i ka sjellë zhvillimit të një sistemi të cilësisë në EQD. Në të njëjtën kohë ajo ka nxjerrë në pah edhe disa boshllëqe ekzistojnë në sigurimin e elementëve të domosdoshëm. Paragrafet në vijim janë hartuar për të identifikuar detyrat kryesore dhe ndryshimet organizative që duhet të realizohen përpara se metoda e sigurimit të cilësisë të pilotohet në një vend të caktuar.

Çështja që vijon në këto paragrafe të fundit shërben si mbështetje për këtë proces kërkimi. Megjithatë, kjo pjesë e këtij instrumenti kërkimor shqetësohet më pak me mbledhjen dhe analizën e të dhënave sesa me idetë që lidhen me hapat që do të vijojnë/ Për këtë arsye, studjuesit duhet të ndihen të lirë të zhvillojnë analizën e tyre, për të vënë theksin në aspekte të veçanta të kësaj detyre, sa të rëndësishme aq dhe sfiduese.

- ◆ Cilat janë institucionet dhe proceset jashtë shkollës që duhet të krijohen?
- ◆ Cilat janë drejtimet kryesore në të cilat duhet të ecin reformat në institucionet ekzistuese jashtë shkollës?
- ◆ A duhet të zhvillohet ndonjë dokument i ri kurrikular (me standarde dhe objektiva)? Çfarë lloj dokumenti duhet të jetë ky dhe në ç'fazë duhet të krijohet?
- ◆ Cilat duhet të jenë institucionet ose procedurat më të rëndësishme që duhet të krijohen për funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në sistemin tuaj shkollor?
- ◆ Cilat janë mangësitë kryesore në fushën e aftësive tek aktorët kryesorë, të cilat duhet të kapërcehen nëse ministria vendos të zhvillojë dhe të zbatojë një metodë të tillë?
- ◆ Kush duhet të jetë përgjegjës për eliminimin e këtyre mangësive?
- ◆ Çfarë duhet të bëhet përpara se shkolla të zhvillojë planin e saj të zhvillimit? A mund të pilotohet kjo procedurë në fushën e EQD?

-
- ◆ Cila është mbështetja e nevojshme që duhet të sigurohet për këtë qëllim? Si do të sigurohet ajo?

Përfundime dhe hapa të mëtejshme

Analiza duhet të përfundojë me një tablo të përgjithme që synon të vendosë të gjithë përbërësit në kuadrin e një vlerësimi tërësor të të gjithë sfidave me të cilat duhet të përballemi dhe që përvijojnë elementet thelbësorë të një strategjie që do të realizojë hapat e sugjeruar